



FAQE 2



FAQE 3



FAQE 4



FAQE 5

Koha

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3200 • E enjte 19 tetor 2017 15 DEN

Çelësi për të kuptuar shqiptarët

FAQE 12-13



Zyrtarizohet koalicioni ASH-BESA

Shkup, 18 tetor - Koalicioni ASH-BESA parashikon mbështetje të ndërsjellë në ato komuna ku kandidatë të tyre janë në balotazh me kandidatët e Bashkimit Demokratik për Integrim. Koncretisht, mbështetja e BESËS ndaj Aleancës për Shqiptarët të bëhet në pesë komuna,

ndërsa partia e Selës do ta mbështetë partinë e Bilall Kasamit në shtatë komuna. Dy shefat e Shtabeve qendrore zgjedhore, Elmi Aziri i ASH-së dhe Afrim Gashi i BESËS kanë sqaruar në detaje marrëveshjen për koalicionim, ndërsa kanë ftuar elektoratin e dy partive për

mbështetje masive më 29 nëntor, në rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale. "Pas ndërhyrjes së thellë që e bëri VMRO-ja në kampin shqiptar në vitin 2006, kur PDSH-ja hyri në Qeveri pa e pasur verdiktin e qytetarëve shqiptarë, për herë të parë në..."

FAQE 3

Moti keq ul rendimentet

Perimet e shtrenjta, sivjet më pak turshi



Krahas shtrenjtimit të perimeve të nevojshme për përgatitjen e turshive dimërore, vite me radhë shënohet edhe ulja e fuqisë blerëse të qytetarëve, andaj edhe qytetarët përgatisin ajvar apo turshi tjetër në varësi prej mundësive financiare, por edhe duke ruajtur traditën e vjetër

FAQE 2

RAJON

Dështon marrëveshja për drejtësinë në veri të Kosovës



Ka dështuar dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, që do të punonin në gjykatat në veri të Kosovës, marrëveshje kjo e dakorduar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Kjo për faktin që...

FAQE 14

RAJON

Britania para kërcënimit më alarmant terrorist

FAQE 15

SPORT

"Liria" për herë të tretë shpallet Kampione e Maqedonisë

FAQE 19

Gjashtë agjentë thirren si dëshmitarë për "Sopotin"



Shkup, 18 tetor - Lënda gjyqësore për rastin e "Sopotit", ndonëse gjatë 15 viteve të kaluara paraprakisht i kaloi të gjitha fazat e gjyqësorit në vend, ai të mërkurën nën përfaqësimin e Prokurorisë Speciale Publike, përsëri filloi të procedohet nga e para. Megjithatë, pritjet e të akuzuarve dhe opinionit më të

gjerë, se PSP-ja përfundimisht do ta tërheqë aktakuzën për këtë rast, të mërkurën nuk ndodhi. Sidoqoftë, edhe pse në këtë seancë ishte e paraparë të jep deklaraten e ti, dëshmitari kyç në këtë lëndë, Ramadan Bajrami, me propozim të përfaqësuesit të PSP-së, Burim Rustemit, rrëfimin e tij ky dëshmitar do

ta japë në seancat që do të mbahen në të ardhmen. Në arsyetimin e dhënë para trupit gjykues, prokurori special, Burim Rustemi, theksoi se ekipi i PSP-së disponon me dëshmi shtesë materiale dhe verbale për këtë lëndë, me çka të gjitha i parashtrori para trupit gjykues. "Ne vlerësojmë..."

FAQE 5

RAJON

Drogë në shkolla



FAQE 14



Krahas shtrenjtimit të perimeve të nevojshme për përgatitjen e turshive dimërore, vite me radhë shënohet edhe ulja e fuqisë blerëse të qytetarëve, andaj edhe qytetarët përgatisin ajvar apo turshi tjetër në varësi prej mundësive financiare, por edhe duke ruajtur traditën e vjetër

Moti keq ul rendimentet

Perimet e shtrenjta, sivjet më pak turshi

Koha **Fisnik PASHOLLI**

Shkup, 18 tetor - Temperatura e larta dhe mungesa e shiut kanë ulur rendimentet e pemë-perimeve si dhe kanë shkaktuar rritjen e çmimit të tyre jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rajonin moti i lig ka dëmtuar dukshëm bujqit, duke ju shkatërruar një pjesë të konsiderueshme të të mbjellave. Oferta më e ulët në treg nga prodhuesit vendor ka ndikuar edhe shtrenjtimit të prodhimeve bujqësore, të cilat në muajin tetor janë më të shtrenjta se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Statistika zyrtare që analizon çmimet mesatare në tregjet e gjelbra në qytetet më të mëdha në Maqedoni, por edhe rajonet prodhuese të perimeve, tregon se shtrenjtimi më i madh sivjet në raport me vitin e kaluar është shënuar tek feferonat me 62 për qind, karotat me 30 për qind, lulelakra me 27 për qind, specat e kuqe me 25 për qind dhe trangujt me 37



për qind. Më pak janë shtrenjtuar lakra dhe specat e buta. Gjithashtu, më shtrenjtë gjatë këtij muaji i paguajmë edhe pemët. Çmime më të larta ka te të gjitha llojet e mollëve që nuk shiten nën 40 denarë dhe dardhave që arrijnë 60 denarë, ndërsa dukshëm është rritur edhe çmimi i rrushit që tani kushton së paku 60 denarë për kilogram.

Nga ana tjetër, krahas shtrenjtimit të perimeve të nevojshme për përgatitjen e turshive dimërore, vite me radhë shënohet edhe ulja e fuqisë blerëse të qytetarëve, andaj edhe

qytetarët përgatisin ajvar apo turshi tjetër në varësi prej mundësive financiare, por edhe duke ruajtur traditën e vjetër.

Njëkohësisht, edhe ndryshimi i mënyrës së jetesës dhe ulja graduale e numrit të familjarëve që jetojnë në bashkësi orienton një pjesë të amvisave që të blejnë edhe ajvarin dhe turshinë e përgatitur në kapacitetet industriale në Maqedoni.

Në ndërkohë, përllogaritjet tregojnë se në mesatare blihen 50 kilogram specat për të cilat nevojitet së paku 1500 denarë, nëse kësaj i shtohen edhe afër

ÇMIMET KRAHASUESE TË ZARZAVATEVE PËR MUAJIN TETOR 2016 DHE 2017 NË TREGJET E GJELBRA		
	tetor 2016	tetor 2017
specat e kuqe	22 denarë	28 denarë
trangujt	25.5 denarë	35 denarë
lulelakra	46 denarë	58 denarë
grosha	120 denarë	136 denarë

300 denarë për domatet e zeza, pesë litra vaj për të cilat nevojitet 300 denarë, si dhe harxhimi i drurit apo rrymës prej disa qindra denarë, del se për përgatitjen e 28-30 kavanozave të ajvarit nevojiten së paku 2400 denarë. Këtu nuk e kemi llogaritur kohën, por edhe mundin e familjarëve që janë të angazhuar për përgatitjen e turshive.

Nga ana tjetër, në shitoret e ndryshme ofrohet ajvar industrial me çmime që në mesatare kushtojnë prej 100 deri në 180 denarë për një kavanoz, që do të thotë se shpaguehet përgatitja e ajvarit në shtëpi, nëse keni kushte minimale për të pjekur dhe

pastruar specat, vendin ku do të zieni atë e kështu me radhë. Gjithashtu, harxhimeve për ushqimet e ndryshme që konservohen për stinën e gjatë të dimrit, mund t'i shtohen edhe 1000 deri 2000 denarë që nevojitet për përgatitjen e turshive prej specave, trangujve apo edhe të ndonjë marmelate apo reçeli shtëpiak.

Tregtarët në tregjet e gjelbra thonë se edhe kërkesa për perime për përgatitjen e turshive shënon rënie nga viti në vit si rrjedhojë e uljes së fuqisë blerëse së qytetarëve. Një pjesë e qytetarëve kanë bërë turshinë, ndërsa të tjerët janë në përgatitje e sipër të saj.

“Pemët dhe perimet sivjet janë më të shtrenjta se vitin e kaluar. Vitin e kaluar një kilogram mollë e paguam edhe me 20 deri 25 denarë, ndërsa tani edhe mollët janë shtrenjtuar. Rrushi po ashtu është i shtrenjtë, e të mos flasim për specat. Çdo kush, në varësi prej thellësisë së xhepit, do të përgatis më pak apo më shumë ajvar apo turshi tjetër për shkak se dimri është i gjatë. Ushqimet për periudhën e dimrit janë më të lira dhe më të shijshme kur përgatiten në shtëpi, në vend se të blihen të gatshme në dyqan”, thotë Bujari një qytetar nga Shkupi.

Konsumatorët e tjerë thonë se përkundër çmimeve të larta, megjithatë do të përgatisin turshi për sezonin e dimrit.

“Patjetër se do të përgatisim si ajvar ashtu edhe turshi të gjallë, specat të kuqe pak të pjekura, tranguj, domate të gjelbra, por në sasi më të vogla. Do të përgatisim si për ne ashtu edhe për familjet e fëmijëve, pasi ato nuk kanë kohë dhe mundësi që të merren me përgatitjen e turshive në banesën ku jetojnë, ndërsa ne në shtëpinë në fshat mund t'i përgatisim turshinë e ndryshme”, thotë Aleksandri, një banues i rrethinës së Shkupit.

Ndryshe në dyqanet e ndryshme në Shkup dhe tërë Maqedoninë, por edhe shitoret e specializuara të fabrikave vendore të zarzavateve ofrohen lloje nga më të ndryshmet të turshive nga ajvari, specat, trangujt, turshinë e përziera e kështu me radhë.

Aplikimet deri në datën 30 tetor

Studentët dhe programi për tutorë

Nisur edhe nga mungesa e traditës, Programi për tutorë të nxënësve të mesme në Maqedoni, nuk është aspak popullor në mesin e studentëve. Shumë pak prej tyre kanë njohuri se duke u angazhuar si tutorë, i sigurojnë vetes nga 10 pikë në vit, të cilat mund t'i përdorin si kredi në marrjen e bursave të ndryshme, sidomos atyre që ndahen nga MASH-i



Koha **Laura PAPANIKU**

Shkup, 18 tetor - Kanë mbetur vetëm edhe dy javë deri në skadimin e afatit për paraqitjen e tutorëve të nxënësve të mesëm për vitin shkollor 2017/2018. Sipas ndryshimeve që ka pësuar ky Program, afati i aplikimeve nga muaji shtator është spostuar në muajin tetor, që do të

thotë se të interesuarit kanë kohë të paraqiten në programin përkatës deri në datën 30 tetor. I përpiluar në vitin 2015 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Programi për tutorim është konceptuar të shërbejë si një paketë sociale, në të cilën do të përfshihen studentët dhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Këta të fundit do të përfitojnë

mundësinë që të marrin orë mësimi falas nga tutorët e tyre, ndërsa studentët, përveç që do të kenë një shans të fitojnë eksperiencë nga puna me nxënës, do të grumbullojnë nga 10 pikë, të cilat do t'ju shërbejnë si kredi në konkurset e ndarjes së bursave të ndryshme. Qëllimi është që të vihet në pah përgjegjësia sociale e studentëve, duke i

motivuar me grumbullim e pikësh të cilat bëjnë më të lehtë përfitimi sidomos të bursave që ndan MASH-i.

Në bazë të rregullores së Programit për tutorë të nxënësve të shkollave të mesme, një student nuk mund të jetë tutor në më tepër se katër lëndë mësimore brenda një viti, ndërsa nota minimale e studimeve në atë lëndë,

nuk guxon të jetë më e ulët se 8-ta. Gjithashtu, kërkohet që kandidati për tutor të posedojë edhe rekomandimin nga profesori, i cili përmes deklaratës me shkrim duhet të tregojë për kualitetet dhe vlerat që i posedon studenti i propozuar për këtë qëllim. Dekada e parë e nëntorit, është periudha kur një Komision i posaçëm pranë MASH bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur paraprakisht nga kandidatët, kurse nga 10 deri në 17 nëntor do të jetë faza e marrjes së tyre në intervistë. Është interesante fakti se përzgjedhja e tutorëve nga ana e komisionit nuk nënkupton angazhimin e tyre me çdo kusht, pasi Programi ka të paraparë edhe një nivel tjetër seleksionimi, respektivisht zgjedhjen e tyre ose jo nga ana e prindërve. Kjo do të vendoset jo më larg se data 25 nëntor, kur prindërit dhe kandidatët tutor kanë kohën të dakordohen ose jo për realizimin e Programit, i cili mund të nis nga dita e nesërme për të vazhduar deri në përfundimin e vitit shkollor, pra deri datën 10 qershor.

Në Maqedoni, nisur edhe nga mungesa e traditës, nuk është edhe aq popullor programi i tutorimit. Në të kaluarën kanë munguar thuajse tërësisht tutorët e angazhuar nëpër shkollat të mesme, pasi studentët janë thuajse të painformuar për këtë program dhe të pa sensibilizuar me dobitë që sjell ai në grumbullimin e pikëve, respektivisht kredive. Përfitues nga angazhimi i tyre, do të ishin në të njëjtën kohë edhe shkollat pasi qëllimi i tutorëve është të ndihmojnë nxënësit në kapërcimin e boshllëqeve që krijon mos përvetësimi i lëndës gjatë orëve të rregullta që realizojnë mësimdhënësit e tyre. Shumë shkolla, të cilat janë kontaktuar për këtë çështje, pohojnë se nuk kanë kaluar përmes praktikave të këtilla të paktën viteve të shkuara. Se çfarë ndryshimesh mund të sjell ky vit, mbetet të presim rrjedhën dhe përfundimin e afateve për sigurimin e tutorëve për shkollat e mesme.



Shefi i Shtabit zgjedhor i Aleancës për Shqiptarët, Elmi Aziri, deklaroi se në bazë të rezultateve të raundit të parë konstatuan se Aleanca për Shqiptarët dhe BESA kanë nevojë për bashkëpunim, i cili do të jetë frytdhënës. "Ju bëj thirrje të gjithë përkrahësve që më 29 tetor të jenë aktivë po aq sa kanë qenë aktiv më 15 tetor dhe ta mbështetin fuqishëm koalicionin tonë. Gjithandej ku ka kandidatë të përkrahët maksimalisht dhe koalicioni të jetë i suksesshëm", ka thënë Aziri

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 18 tetor - Koalicioni ASH-BESA parashikon mbështetje të ndërsjellë në ato komuna ku kandidatë të tyre janë në balotazh me kandidatët e Bashkimit Demokratik për Integrim. Konkretisht, mbështetja e BESËS ndaj Aleancës për Shqiptarët të bëhet në pesë komuna, ndërsa partia e Selës do ta mbështet partinë e Billa Kasamit në shtatë komuna. Dy shefat e Shtabeve qendrore zgjedhore, Elmi Aziri i ASH-së dhe Afrim Gashi i BESËS kanë sqaruar në detaje marrëveshjen për koalicionim, ndërsa kanë ftuar elektoratin e dy partive për mbështetje masive më 29 nëntor, në rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale. "Pas ndërhyrjes së thellë që e bëri VMRO-ja në kampin shqiptar në vitin 2006, kur PDSH-ja hyri në Qeveri pa e pasur verdiktin e qytetarëve shqiptarë, për herë të parë në zgjedhjet lokale ndodh që një parti maqedonase, LSDM-ja, tenton në mënyrën më radikale që të ndikojë vullnetin poli-

Një ditë pas takimit të krerëve partiak

Zyrtarizohet koalicioni ASH-BESA



tik të shqiptarëve se cilët janë kandidatët që do të duhej të menazonin ato komuna", ka thënë Gashi, duke vlerësuar se ky është momentum i ri "dhe mendoj se shqiptarët duhet që ta kishin të njëjtën ndjenjë se dikush u është futur thellë për t'ua ndryshuar vullnetin". "Kjo ndërhyrje nuk është e dobishme as për shqiptarët e as për shtetin. Prandaj, duart larg prej vullnetit të shqiptarëve", ka thënë Gashi. Shefi i shtabit zgjedhor të Lëvizjes BESA, Afrim Gashi tha se një kohë të gjatë opinioni e pret bashkëpunimin mes Lëvizjes BESA dhe Aleancës për shqiptarët. Ai u bëri thirrje gjithë aktivistëve të BESËS të votojnë Aleancën për Shqiptarët në komunat ku ata garojnë kundër BDI-së, por jo vetëm të votojnë, por të jenë edhe aktiv. "I fitoj gjithë aktivistët simpa-

tizantët e BESËS që në komunat ku garon Aleanca përveç votës të jenë aktiv dhe të bëjnë çmos që në skenën politik të menaxhojnë një strukturë e re politike. Shpresoj që kjo frymë që tash po ndërtohet të jetë frytdhënës dhe në të ardhmen të jetë një koalicion për të ardhmen. Është një test për ne dhe shpresoj që edhe në të ardhmen të sjell ndryshime", ka thënë Afrim Gashi. Ai ka shtuar se shpresa është që ky koalicion t'i sjell të mira shqiptarëve dhe Maqedonisë. Në anën tjetër, Elmi Aziri i Aleancës ka deklaruar se presin që kryeministri Zoran Zaev në raundin e dytë të jetë së paku neutral. Në ndërkohë, shefi i Shtabit zgjedhor i Aleancës për Shqiptarët, Elmi Aziri, deklaroi se në bazë të rezultateve të raundit të parë konstatuan se Alean-

ca për Shqiptarët dhe BESA kanë nevojë për bashkëpunim, i cili do të jetë frytdhënës. "Ju bëj thirrje të gjithë përkrahësve që më 29 tetor të jenë aktivë po aq sa kanë qenë aktiv më 15 tetor dhe ta mbështetin fuqishëm koalicionin tonë. Gjithandej ku ka kandidatë të përkrahët maksimalisht dhe koalicioni të jetë i suksesshëm", ka thënë Aziri. "Duhet të fokusohemi nga e ardhja. Vota duhet të shkojë te koalicioni ynë. Shpeshherë ndodhë që e kaluara të bëhet pengesë për të ardhmen. Opinioni e di që kemi bërë përpjekje edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve të bëhemi bashkë, por nuk ndodhi, por edhe atëherë kemi lënë të hapur mundësinë e bashkëpunimit. Tash kjo ndodhi dhe besoj se do të funksionojë", ka thënë Aziri.



Osmani: BDI do të jetë fitues absolut

Shkup, 18 tetor - Koalicionet bëhen në bazë të komplementaritetit të ideve, e jo në marrëveshje për vota kontigjente. Koalicioni i BDI-së dhe LSDM-së në Çair dhe Shkup bazohet në bazë të përpjekjeve të përbashkëta programore dhe ishte publike, ndërsa nga ana tjetër kishte koalicione dhe kontigjente të fshehta të votave të cilat jepen mes partive që ideologjikisht nuk lidhen, deklaroi shefi i Shtabit zgjedhor komunal në Çair i BDI-së, Bujar Osmani. "BDI është fitues absolut i këtyre zgjedhjeve mes partive shqiptare dhe u tregua si mbrojtjes autentike i shqiptarëve. BDI është partia e parë fituese në Çair për këshilltarë, atje ku nuk ka koalicione. E pranuar porosinë e zg-

jedhjeve paraprake dhe ofruam fytirë të re. Çair-it nuk i duhet kandidat që do të jetë nga ana tjetër e Qeverisë. Çfarëdo marrëveshje e tregimit të votave si kontigjente janë të papranueshme për votuesit dhe atë do ta tregojnë më 29 tetor", deklaroi Osmani. I pyetur për koment për paralajmërimet për koalicion mes Selës dhe Kasamit, në një situatë kur Sela është partner qeveritar, Osmani u përgjigj se bëhet fjalë për koalicion mes partnerëve opozitarë dhe se ka spekulime për koalicionim edhe me partitë maqedonase, për gjithë këtë do të vendoset së bashku me partnerët e koalicionit të cilët duhet të ulen dhe të dakordohen.

Ambienti politik premtion ndryshime pozitive

Shkup, 18 tetor - Ambienti politik në Maqedoni premtion ndryshime pozitive. Reformat e filluara nga ana e Qeverisë japin orientim për lëvizjet e ekonomisë, tha ambasadori i Mbretërisë së Spanjës, Emilio Lorenzo Sera në takimim e sotëm me zëvendëskryeministrin e çështjeve

ekonomike Koço Angjushev. Angjushev i uroi emërimin e ambasadorit të ri spanjoll dhe shprehu pritje se bashkëpunimi midis dy vendeve do të vazhdojë. "Qeveria krijon ambient politik dhe ekonomik me të cilin Maqedonia do të jetë mik i mirë dhe partner i të

gjitha vendeve, ndërsa mbështetja nga Spanja, si anëtare e Bashkimit Evropian është veçanërisht e rëndësishme. Investitorët e huaj, duke i përfshirë edhe ata nga Mbretëria e Spanjës janë të mirëseardhur për të investuar në Republikën e Maqedonisë", nënvizoi zëvendëskryeministrin .

Bashkëbiseduesit u angazhuan për intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike, veçanërisht në sektorin e bujqësisë, energjetikës - përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe në mbrojtjen e mjedisit jetësor përmes projekteve për menaxhim të duhur me mbeturinat.

KSHZ pranoi 46 ankesa, më së shumti nga VMRO

Shkup, 18 tetor - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) i korrigjoi rezultatet e publikuara fillimisht për 48 ankesa për procedurën e votimit, përmblendhjes dhe përcaktimit të rezultateve nga raundi i parë i zgjedhjeve lokale që u mbajtën më 15 tetor. Në afatin e paraparë që skadoi mbrëmë në orën 2 janë parashtruar gjithsej 46 ankesa. Më shumë ankesa ka parashtruar VMRO-DPMNE 43, nga një TMRO dhe Aleanca për Shqiptarët dhe E majta. KSHZ obligohet që t'i zgjidhë ankesat e kandi-

datëve për procedurën e votimit, përmblendhjes dhe përcaktimit të rezultateve të votimit, në afat prej 48 orësh nga pranimi i tyre. Kundër vendimit të KSHZ-së, mund të shtrohet padi në Gjykatën Administrative, në afat prej 24 orësh nga pranimi i vendimit. Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë, nga ana tjetër, pas ankesës obligohet të sjellë vendim në afat prej 48 orësh pas pranimit të saj. Raundi i dytë i zgjedhjeve lokale do të mbahet më 29 tetor.

Kjo është përbërja e këshillave komunale në Pollog

Tetovë, 18 tetor - Sipas të dhënave që ka publikuar Komisioni Shtetëror Zgjedhor, në Këshillin e Komunës së Tetovës, BDI ka marrë 9 vende të këshilltarëve, Aleanca për Shqiptarët 4, Lëvizja Besa 6, VMRO-DPMNE 5, LSDM tre vende, Partia e Turqve 1 dhe PDSH-ja 3. Sipas të dhënave që i publikoi Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në Këshillin e Komunës së

Gostivarit më shumë mandate do të ketë BDI-ja, nëntë. I dyti sipas numrit do të jetë grupi i këshilltarëve të Aleancës për Shqiptarët me tetë anëtarë. Nga katër mandate fituan koalicionet e udhëhequra nga LSDM-ja dhe VMRO-DPMNE. Tre parti politike në përbërjen e re të këshillit të Gostivarit do të përfaqësohen me nga dy përfaqësues. Koalicioni i Rilind-

jes Demokratike Kom-bëtare (RDK) dhe Unitetit i fituan dy mandate. Po aq kanë edhe Lëvizja Besa dhe Partia Demokratike e Turqve. Në Komunën e Tearcës, Bashkimi Demokratik për Integrim ka fituar 7 vende të këshilltarëve, Aleanca për Shqiptarët 3 këshilltarë, VMRO-DPMNE 1, Lëvizja Besa 4, Partia Demokratike Shqiptare 3 dhe LSDM-ja 1. Në Ko-

munën e Bogovinës, Bashkimi Demokratik për Integrim ka marrë 7 këshilltarë, Aleanca për Shqiptarët 5, Lëvizja Besa 5 dhe Partia Demokratike Shqiptare dy këshilltarë. Në Komunën e Vrapçishtit Bashkimi Demokratik për Integrim ka marrë 7 këshilltarë, Aleanca për Shqiptarët 6, Partia e Turqve 3, Lëvizja Besa 2 dhe LSDM-ja 1. Në Ko-

munën e Jegunocit, Bashkimi Demokratik për Integrim 3, Partia Popullore e Maqedonisë 1, VMRO-DPMNE-ja 5 dhe 6 këshilltarë ka marrë LSDM-ja. Në Zhelinë, Bashkimi Demokratik për Integrim 8 këshilltarë, Aleanca për Shqiptarët 1, Lëvizja Besa 9 dhe PDSH-ja 1. Në Bërvenicë, Bashkimi Demokratik për Integrim ka marrë 2 këshilltarë,

Aleanca për Shqiptarët 2, VMRO-DPMNE 4, LSDM-ja 4, Besa 2 dhe Partia Demokratike Shqiptare 1 këshilltar. Në bazë të përllogaritjeve gjithsej në 7 komunat e Pollogut, BDI ka 43 këshilltarë, Aleanca për Shqiptarët 21, Lëvizja Besa 25, PDSH-ja 10, VMRO-DPMNE 15, LSDM-ja 14, Partia e Turqve 4 këshilltarë dhe një Partia Popullore e Maqedonisë. (U.H)



Biznesi kërkon stabilitet politik

Shkup, 18 tetor - Turbulencat politike në shtet gjatë dy viteve të fundit ndikuan në sigurinë e investimeve. Çdoherë do të ketë rënie të prodhimit dhe eksportit kur sektori privat përmbahet nga investimi. Që sektori privat të mund të investojë, nevojitet gjendje stabile politike në vend dhe zvogëlim të cikleve zgjedhore, tha kryetarja e Lidhjes së Odave Ekonomike (LOE) Danella Arsovska. Në konferencën për shtyp në të cilën LOE e promovoi projektin "Rrjeti botëror për biznese të vogla", Arsovska, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve, theksoi se sektori privat duhet të dijë dhe të jetë i sigurt se sërish nuk do të ketë turbulencia që të vazhdojë me ciklet dhe prodhimtarinë dhe eksportin. Lidhur me pagën minimale, Arsovska theksoi se pritet që nga muaji i ardhshëm Qeveria të fillojë me pagesën e subvencioneve për kompanitë. "Nuk duam të ballafaqohemi me probleme në likuiditet për shkak të rritjes së shpenzimeve të cilat kompanitë realisht nuk kanë mundësi t'i durojnë sepse u rriten, krahas të gjithë tatimeve të tjera parafiskale, edhe këto tatime të tjera siç janë rritja e pagës minimale. Nuk do të donim të ballafaqohemi me situatë në të cilën sektori privat do të fillojë ta zvogëlojë numrin e vendeve të punës që ta përmbushë kuotën për pagesë të pagës minimale, posaçërisht në veprimtarive intensive të punës", potencoi kryetarja e LOE-së. Sipas Arsovskës, fillimisht duhet të veprohet në rritjen e produktivitetit të kompanive, t'u mundësohet të rriten dhe të rritet fuqia e tyre që të mundën vetë, pa subvencione nga shteti, të paguajnë pagë minimale nga 12.000 denarë. Arsovska edhe një herë theksoi se biznes bashkësisë i nevojitet administratë efikase shtetërore e cila, siç tha, do t'i përmbushë detyrat e saj të punës në afatet e parapara, ndërsa me këtë edhe do t'u mundësojë kompanive që normalisht të funksionojnë, pa ngecje dhe t'i realizojnë aktivitetet e tyre të parapara. Për propozimin qeveritar që një pjesë nga administrata që të kalojë në sektorin privat, Arsovska nënvizoi se paraprakisht duhet të bëhet analizë e mirë me çfarë kuadro disponon administrata që të shohin kompanitë se çka nga ajo u nevojitet.

Kohëve të fundit është rritur numri i fëmijëve që përdorin substanca të ndryshme narkotike që janë të moshës nën 12 vjeç si dhe është rritur numri i fëmijëve nëntëvjeçar që thithin "ngjitëse". "Nuk kemi program konkret për punën me këta fëmijë, por në bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe institucionet përkatëse shtetërore, i këshillojmë prindërit e tyre se si të përballen në situata të këtilla, ndërsa ata të moshave më të mëdha i dërgojmë për mjekim në Klinikën psikiatrike për fëmijë", deklaroi Ivica Cekovski nga organizata qytetare "HOPS"

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 18 tetor - Më se e nevojshme është të përgatitet një program për punë me fëmijë të moshave të mitura dhe të rinjtë që të hapet Qendër ditore për fëmijë përdorues të drogave, sepse angazhimi i deritanishëm i shoqatave jo qeveritare si dhe institucioneve shtetërore, shumë pak kanë pasur sukses në punën me fëmijët e grupmoshave të mitura që të heqin dorë nga përdorimi i drogave, sepse nuk ekzistojnë standarde konkrete apo procedura si të punohet me këta fëmijë. "Asnjë institucion në rajon nuk ka regjistër të saktë të të dhënave për fëmijët dhe të rinjtë që përdorin substanca narkotike të ndaluara ose të dhënat që i posedojnë, nuk korrespondojnë me realitetin që ndodhë në teren me fëmijët të grupmoshave të mitura", deklaroi Tamara Martinovska nga Qendra për punë sociale pranë qytetit të Shkupit, para fillimit të punës tre ditore nën organizim të Shoqatës

Ulet kufiri i moshës së atyre që përdorin drogë Zgjidhje e qëndrueshme për të mbrojtur fëmijët



"HOPS", së bashku me partnerët nga vendet e rajonit dhe Evropës, punëtorit në të cilën marrin pjesë ekspertë nga institucionet shtetërore dhe organizatat qytetare nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Punëtorja sipas Martinovska ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve punuese të organizatave qytetare dhe institucioneve shtetërore me fëmijët dhe të rinjtë që rrezikohet nga drogat, promovimi dhe gjetja e një zgjidhje më të mirë të një sistemi të qëndrueshëm për kategorinë e këtyre njerëzve jo vetëm në Maqedoni, por edhe në Ballkan. "Të gjitha vendet e rajonit duhet t'ju ofrojnë përkujdesje të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të këtyre fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve cilësorë se si të veprohet me këta fëmijë që janë përdorues të drogave, që janë në konflikt me ligjet, fëmijë që vijnë

nga familjet që janë përdorues të drogave, që jetojnë rrugëve pa përkujdesje prindërore", deklaroi Martinovska. Ndërkohë Ivica Cekovski nga Shoqata "HOPS", informoi se vitin e kaluar është bërë hulumtim në teren dhe rezultoi se të gjithë fëmijët e vendeve të rajonit që janë përdorues të substancave të ndryshme narkotike, institucionet shtetërore nuk kanë aspak të dhëna të sakta për numrin e këtyre fëmijëve që janë të varur nga droga, që e bënë të pamundshëm të përcillen politikat të cilat janë paraparë në strategjitë nacionale apa planeve aksionare, që i sjellin ministritë apo institucionet e tjera përkatëse. "Do vazhdojmë të punojmë në këto tema. Shpresojmë se deri në fund të projektit katërvjeçar, së bashku me institucionet shtetërore të vendeve të rajonit, do të arrijmë të gje-

jmë zgjidhje të qëndrueshme për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë nga drogat", deklaroi Cekovski. Njëherit u shpreh se në punëtorinë tre ditore që po mbahen në Shkup, në fokus do të jetë gjetja e zgjidhjes më të mira për të mbrojtur të rinjtë nga drogat e në veçanti fëmijët e mitur. "HOPS" vetëm në Shkup deri në fund të vitit të kaluar në teren ka kontaktuar mbi 85 fëmijë që janë përdorues të rregullt të drogave, ndërsa për çdo vit ky numër rritet për 30 fëmijë. Asnjërin nga këta fëmijë shteti nuk i ka nën përkujdesje, nuk është filluar asnjë trajtim apo u është mundësuar ndonjë shërbim nga ana e shtetit që do të kontribuonte në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të këtyre fëmijëve që janë të varur nga droga", thotë Cekovski. Kohëve të fundit Cekovski u shpreh se është rritur numri i fëmijëve që përdorin substanca të ndryshme narkotike që janë të moshës nën 12 vite si dhe është rritur numri i fëmijëve nëntëvjeçar që thithin "ngjitëse". "Nuk kemi program konkret për punë me këta fëmijë, por në bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe institucionet përkatëse shtetërore, i këshillojmë prindërit e tyre se si të përballen në situata të këtilla, ndërsa ata të moshave më të mëdha i dërgojmë për mjekim në Klinikën psikiatrike për fëmijë", deklaroi Ivica Cekovski nga organizata qytetare "HOPS".

Ministria e Kulturës mbyll debatin

"Strategjia..." kalon me pak propozime e kritika

Numri më i madh i propozimeve ka qenë për pjesën e parë, të përgjithshme të tekstit dhe një numër shumë i vogël sugjerimesh për të ndryshime dhe plotësime kanë arritur në pjesët më të specifikuar, që lidhen me synimet për zhvillimin e kulturës në sfera të veçanta. Kjo mungesë propozimesh, kritikash apo edhe sugjerimesh për Zllatko Teodosievskin, këshilltarin e posaçëm në Ministrinë e Kulturës, mund të interpretohet edhe si një konfirmim se ky dokument është i patëmetë

Koha Evis HALILI

Shkup, 18 tetor - Versioni jo zyrtar i Strategjisë për zhvillimin e kulturës për

periudhën 2018-2022, që Ministria e Kulturës prej më shumë se një muaji e ka lënë të hapur për opinionin, ka marrë shumë pak propozime për ndryshime. Kështu kanë deklaruar nga ky institucion gjatë zhvillimit të debatit të dytë publik, të mërkurën. Numri më i madh i propozimeve ka qenë për pjesën e parë, të përgjithshme të tekstit dhe një numër shumë i vogël sugjerimesh për të ndryshime dhe plotësime kanë arritur në pjesët më të specifikuar, që lidhen me synimet për zhvillimin e kulturës në sfera të veçanta. Kjo mungesë propozimesh, kritikash apo edhe sugjerimesh për Zllatko Teodosievskin, këshilltarin e posaçëm në Ministrinë e Kulturës, mund të interpretohet edhe si një konfirmim se



ky dokument është i patëmetë. "Mund të kuptohet edhe si një kualifikim se kemi bërë një punë të mirë. Por ne nuk mund të jemi kaq të vetëkënaqur dhe të mendojmë se kemi bërë një punë të shkëlqyer. E dimë se teksti mund të përmirësohet akoma,

sidomos në pjesën që lidhet me institucionet. Të gjitha prioritetet strategjike të parashtrura në pjesën e përgjithshme duam që të pasqyrohen në punën e institucioneve. ...Ky version në fakt kushtimisht duhet të jetë Bibla e Kulturës maqedonase, që e

presim gjatë pesë viteve të ardhshme", ka thënë Teodosievski. Debati i dytë, i organizuar në Muzeun e Artit Bashkëkohor u zhvillua në katër sfera, në trashëgiminë dhe muzetë, të drejtat autoriale, literatura dhe botimet, si edhe muzika, teatri, multimediale dhe artet vizuale. Qëllimet e kësaj strategjie e cila do të duhet që të jetë gati në fund të këtij vitit janë demokratizimi, inkluziviteti, decentralizimi i kulturës. Zëvendësministri i Kulturës, Vladimir Llazovski i ka apeluar institucioneve të kulturës që të marrin pjesë aktive për të krijuar kushte për një të ardhme më të mirë dhe të qëndrueshme të kulturës. "Kultura jonë ka nevojë për ndryshime rrënjësore dhe angazhimet tona

kryesore janë - kulturë për të gjithë, kulturë për të gjithë. Vizioni për kulturën dhe artin tek ne për një afat të mesëm, por edhe më të gjatë nuk guxon që të imponohet dhe të vijë nga lart, por të përfshijë të gjithë në formësimin e saj. Deri në fund të vitit kemi përparë një punë intensive për të përpiluar sa më mirë Strategjinë 2018-2022", ka thënë Teodosievski. Propozimet nga opinioni do të mund të parashtrohen edhe gjatë muajit të ardhshëm, ndërsa në muajin dhjetor Ministria e Kulturës do të organizojë një forum më të gjerë, ndërsa në qytete të tjera do të vijohet me debate në tetë qytete në Maqedoni, me qëllim që të evidentohen edhe nevojat që kanë komunitetet lokale për kulturën.



Gjatë elaborimit të shkaqeve se pse këta dëshmitar janë të rëndësishëm të paraqitën para Trupit gjyqësor, prokurori speciale Burim Rustemi, në një sqarim për gazetën KOHA, tha se një pjesë e dëshmitarëve të propozuar ende punojnë në DSK, ndërsa supozimet e tyre janë se pikërisht këta janë personat të cilët e kanë marrë në pyetje dëshmitarin kyç Ramadan Bajramin

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 18 tetor - Lënda gjyqësore për rastin e "Sopotit", ndonëse gjatë 15 viteve të kaluara paraprakisht i kaloi të gjitha fazat e gjyqësorit në vend, ai të mërkurën nën përfaqësimin e Prokurorisë Speciale Publike, përsëri filloi të procedohet nga e para. Megjithatë, pritjet e të akuzuarve dhe opinionit më të gjerë, se PSP-ja përfundimisht do ta tërheq aktakuzën për këtë rast, të mërkurën nuk ndodhi. Sidoqoftë, edhe pse në këtë seancë ishte e paraparë të jep deklaratën e ti, dëshmitari kyç në këtë lëndë, Ramadan Bajrami, me propozim të përfaqësuesit të PSP-së, Burim Rustemit, rrëfimin e tij ky dëshmitar do ta japë në seancat që do të mbahen në të ardhmen. Në arsyetimin e dhënë para trupit gjyqësor, prokurori special, Burim Rustemi, theksoi se ekipi i PSP-së disponon me dëshmi shtesë materiale dhe verbale për këtë lëndë, me çka të gjitha i parashtrij para trupit gjyqësor.

"Ne vlerësojmë se duhet të prezantohet prova shtesë materiale dhe verbale për këtë lëndë gjyqësor. Kështu që para jush e propozoi një CD, në të cilin qëndron biseda telefonike publike mes dy ish funksionarëve të lartë shtetit Gordana Jankulovska dhe Sasho Mijaljkov. Pastaj në shkresat e dësh-

Rasti "Sopoti" fillon nga e para Gjashtë agjentë thirren si dëshmitarë për "Sopotin"



mive materiale janë edhe vlerësimet profesional të psikiatërve lidhur me dëshminë e dhënë nga Ramadan Bajrami. Ndërkohë, si dëshmitar shtesë në këtë procedurë gjyqësore i propozojmë personat Robert Jovanovskin, Boban Stojanovskin, Ilija Smilevskin, Mile Vellkovin, Marjan Nikolovskin dhe Mile Andonovskin. Të gjithë këta persona janë pjesëtarë të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, detyrë e të cilëve në ato kohë ka qenë procedura para hetimorë për rastin "Sopoti", tha prokurori special Rustemi. Gjatë elaborimit të shkaqeve se pse këta dëshmitar janë të rëndësishëm të paraqitën para Trupit gjyqësor, prokurori speciale Burim Rustemi, në një sqarim për gazetën KOHA, tha se një pjesë e dëshmitarëve të propozuar ende punojnë në

DSK, ndërsa supozimet e tyre janë se pikërisht këta janë personat të cilët e kanë marrë në pyetje dëshmitarin kyç Ramadan Bajramin. Këtë propozim të PSP-së, e komentoi edhe vetë dëshmitari i apostrofuara Ramadan Bajrami, i cili në disa deklarata të dhëna më herët për mediat, potencoi se marrja në pyetje nga ana e policisë është zhvilluar në mënyrën më brutale dhe çnjerëzore që mundet të ekzistoj.

"Sinqerisht ka kaluar shumë kohë prej asaj periudhe dhe unë asnjëherë nuk i kam njohur me emra personat të cilët duke ushtuar dhunë fizike ndaj meje më detyruan që unë ta nënshkruaj atë deklaratë. Por, besoj se nëse më paraqite para syve, ka gjasa t'i gjoja. Procesin e marrjes në pyetje e kujtoj se e kanë zhvilluar rreth tetë anëtar

të policisë", tha dëshmitari Ramadan Bajrami. Nga ana tjetër pala mbrojtëse e të akuzuarve në rastin e "Sopotit", me qëllim se bëhet fjalë për dëshmi shtesë, kërkoi nga Trupi gjyqësor disa ditë kohë që t'i shfletojnë dhe shqyrtojnë propozimet e PSP-së dhe më pas të prononcohet. Kërkesën e avokatëve Vullnet Paçuku dhe Naser Raufi, e pranoi trupi gjyqësor dhe seancën e ardhshme e caktoi për datë 23 nëntor. Ndryshe, përfaqësuesit ligjore të të akuzuarve për rastin "Sopot", nënvizuan se "lëshimin" të cilën e bëri PSP-ja me mos thirrjen e Gordana Jankulovskës dhe Sasho Mijaljkovit për dëshmitarin, do ta korrigjojnë ata dhe në fazën e gjykimit kur atyre do t'ju jepet mundësia do t'i propozojnë si dëshmitar këta dy ish funksionar të lartë të shtetit.

Kronikë

Vëllai përdhunon motrën 26-vjeçare

Njëzet e gjashtë vjeçarja P.N. nga një fshat i Shkupit, dje në ora 13:30 në stacionin e policisë ka denoncuar se është përdhunuar nga ana e vëllait të saj, kumtoi MPB. "P.N. rreth mesditës së 16.10.2017, derisa ka qenë vetë në shtëpi, nga prapa i është afuar vëllai i saj R.N. (27), ia ka mbyllur gojën me dorë, e ka zhveshur dhe e ka përdhunuar. Pas kësaj i është kërcënuar se do ta vrasë nëse i tregon dikujt. Në orën e mbrëmjes është shkaktuar një zënkë mes denoncueses, vëllait të saj dhe nënës së tyre. Pas debatit vëllai i saj e ka sulmuar edhe fizikisht, e pastaj ka marrë një thikë dhe i ka shkaktuar plagë në gishtat e dorës", theksojnë nga MPB. Ndërmerren masa për zbardhjen e rastit.

I dehuri shkrep 30 plumba në ajër

58 vjeçari A.K nga fshati Balindoll, të martën pasdite, rreth orës 18.00, nga taverna e shtëpisë së tij ku ka jetuar vetë, ka shkrepur rreth 30 plumba në ajër. Pistoletën e ka poseduar me leje, informon policia e Tetovës. Në gjendje të alkoolizuar, 58 vjeçari është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor në Gostivar, ndërsa pistoletat e tipit Cërvena Zastava, dhe një pushkë me vërtetim janë marrë. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Arrestohet tetovari, kapet me marihuanë

Pjesëtarë të Policisë së Tetovës, të martën mbrëma, rreth orës 22, në Tetovë kanë ndaluar dhe më pas kanë arrestuar 25 vjeçar SH.R., i cili në dorë ka pasur dy qese me marihuanë.

Pasi që e kanë vërejtur pjesëtarët e policisë tetovarin, ai i ka hedhur qeset e plastikës dhe ka filluar të ikë, por është kapur dhe arrestuar.

Të dy qeset me marihuanë, njëra 54 gramë dhe tjetra 3 gramë, janë marrë dhe do të analizohen, ndërsa pas arrestimit në konsultim me prokurorin publik Sh.R. është mbajtur në Stacionin Policor në Tetovë dhe pas zbardhjes së plotë do të ketë padi adekuate. (u.h.)

Paraburgim për katër persona për sulmin ndaj Zijadin Selës

Shkup, 18 tetor - Me propozimin të Prokurorisë së Shkupit, gjykatësi i procedurës paraprake, të mërkurën ju ka caktuar masë paraburgim me kohëzgjatje prej 30 ditëve, katër personave të cilët dyshohen për sulmin brutal ndaj deputeti Zijadin Sela, që ndodhi me 27 prill të këtij viti. Ndërkohë shqiptimi i kësaj mase parandaluese për personin e pestë i cili u arrestua të martë, i cili po ashtu dyshohet për kryerjen e veprës penale "tentativë për vrasje të kryer në bashkëpunim", për shkaqe shëndetësore do të prolongohet për disa ditë. Ndërkohë, pasi që Ministria për Punë të Brendshme, të martën apeloj për ndihmën e qytetarëve lidhur me zbulimin e tre të dyshuarve tjerë për sulmin ndaj Zijadin Selës, brenda kohës Prokuroria e Shkupit, njoftoj se edhe këta persona janë arrestuar nga policia. Numri i plotë i të dyshuarve për sulmin ndaj Zijadin Selës deri më tani ka shkuar në 10 personat, respektivisht në maj të këtij viti, disa javë pas dhunës së ushtruar në Parlament me 27 prill, policia e Shkupit i arrestoi dy persona, babë e birë, të cilët në videot e publikuara shihen qartë se si e ngrehin zvarrë deputetin Sela nëpër korridorët e Parlamentit.



VMRO kërkon amnisti për huliganët e 27 prillit

Shkup, 18 tetor - Komiteti Ekzekutiv (KE) i VMRO-DPMNE-së në seancën e tij të fundit debatoi për më shumë çështje dhe solli disa konkluzione. KE siç thuhet në kumtesë, konstatoi se në 5 muajt e fundit është dukshme politika e pushtetit për lirim masiv të kriminelëve nga burgjet dhe repartet e paraburgimit rreth bazave të ndryshme juridike të fabrikua emërtues i përbashkët i të cilave është intervenimi politik nga pushteti. "Kështu, menjëherë pas ardhjes në pushtet LSD e cila në këtë moment ka kontroll të plotë mbi prokuroritë dhe gjyqësinë në Maqedoni i liroi nga burgu Agim Krasniqin nga Kondova, Bajrush Sejdiun nga Kumanova i dënau edhe për një numër krimesh të rënda, Velija Ramkovskin nga Shkupi gjithashtu i dënau për krime të shumta, nga paraburgimi i liroi edhe i mundësoi gjoja burg shtëpiak Seat Rahiqit i dyshuar për shpërndarje dhe shitje të

drogës, të cilin opinionin vetëm para tre ditëve e pa në rolin e sulmuesit të kryetarit të partisë GROM", theksohet në kumtesën e KE-së të VMRO-DPMNE-së. Krahas kësaj LSD, në pajtim me premtimet ndaj partnerit të koalicionit BDI, ndërsa të cilët ishin pjesë e a.q. Platforma e Tiranës, vepruan që prokuroria të kërkojë pezullim të aktvendimit të kryer gjyqësor kundër personave të cilët e kryen vrasjen makabre të 5 personave të rinj. Pak para fillimit të fushatës zgjedhore, qeveria publikoi se ka miratuar ligj për amnisti për të burgosurit, të cilat do të amnistohen nga rreth 1,050 të burgosur për vepra të kryera penale. Prej këtu, KE i VMRO-DPMNE-së informon se nis iniciativë për lirim të menjëhershëm dhe amnisti për të gjithë personat që kanë kryer disa shkelje ligjore në incidentet para dhe në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill 2017.



Numri më i madh i aksidenteve ka ndodhur në rrugët e qytetit të Tetovës, më pas në autostradën Gostivar-Tetovë-Shkup si dhe në rrugët rajonale Tetovë-Pirok, dhe Tetovë-Vollkoviçë. Si shkak më i shpeshtë i këtyre aksidenteve dhe veçanërisht i atyre që kanë përfunduar me pasoja më të rënda, sërish ka qenë mos përshtatja e shpejtësisë, gjegjësisht vozitja e shpejtë, thonë nga Policia e Tetovës.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 18 tetor - Në 9 muajt e kaluar të këtij viti, në rajonin më të gjerë të Tetovës gjithsej janë regjistruar 593 aksidente komunikacioni ose 17 më pak në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar.

"Gjashtë nga këto aksidente kanë përfunduar me 7 viktima, prej tyre dy kanë qenë vozitës, tre bashkudhëtarë, një këmbësorë si dhe një motoçiklist, kundrejt 10 viktimave të vitit të kaluar. Në 42 aksidente të tjera, lëndime të rënda trupore kanë marrë 44 persona, në 244 aksidente me lëndime të lehta kanë përfunduar 477 persona, përdërisa në 301 aksidente të tjera është shkaktuar vetëm dëm material, i cili vlerësohet të jetë rreth 24 milionë denarë", thuhet në raportin e Policisë së Tetovës. Por, gjendja aspak nuk është më e mirë në rrugët rajonale. Vite me radhë rruga rajonale Tetovë-Jazhincë, së bashku me rrugët e qytetit të Tetovës, autostradën Tetovë-Shkup dhe rrugët rajonale Tetovë-Pirok dhe Tetovë-Vollkoviçë, vazhdojnë që edhe më tutje të jenë në mesin e rrugëve më të rrezikshme në rrethinën e Tetovës, për shkak se në këto rrugë, në veçanti në rrugën Tetovë-Jazhincë, janë regjistruar shumë aksidente, në disa raste edhe me pasoja tragjike, gjegjësisht me të vdekur. "Numri më i madh i aksidenteve kanë

Aksidentet në Tetovë

Rrugët e qytetit më të rrezikshme se ato rajonale



ndodhur në rrugët e qytetit të Tetovës, më pas në autostradën Gostivar-Tetovë-Shkup, si dhe në rrugët rajonale Tetovë-Pirok dhe Tetovë-Vollkoviçë. Si shkak më i shpeshtë i këtyre aksidenteve dhe veçanërisht i atyre që kanë përfunduar me pasoja më të rënda, sërish ka qenë mos përshtatja e shpejtësisë, gjegjësisht vozitja e shpejtë", thonë nga Policia e Tetovës. Pjesa më e madhe e aksidenteve kanë ndodhur gjatë ditës së mërkurë.

"Më shumë aksidente kanë ndodhur të mërkurën, edhe atë në periudhën kohore mes orës 16.00 dhe orës 20.00. Në nëntëdhjetë prej aksidenteve automjetet kanë dalë nga rruga, 46 të tjera janë shkaktuar nga kafshët, në të shumtën e rasteve nga qentë endacak, ndërsa në 57 aksidente pjesëmarrës kanë qenë këmbësorët", qëndron në raportin nëntë mu-

jor të Policisë së Tetovës.

Arsyet më të shpeshta për numrin më të madh të aksidenteve në këto rrugë janë mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës, gjegjësisht vozitja e shpejtë, mosrespektimi i sinjalistikës rrugore, stërnarkimi i rrugës për shkak të rritjes së fluksit të automjeteve që qarkullojnë në këto rrugë, sidomos në muajt e verës, por edhe për shkak të dëmtimit të rrugëve në shumë pjesë të saj. Si rezultat i kësaj në këto rrugë rajonale janë regjistruar shumë dalje nga rruga, të cilat jo rrallë herë janë shoqëruar edhe me rrokullisjen e automjeteve, ndeshje, por ka pasur raste kur kanë pësuar edhe këmbësorët, ciklistët dhe motoçiklistët. Përveç kësaj, aksidentet në këtë periudhë kohore kanë ndodhur edhe për shkak të veprimeve jo të ndërgjegjshme, gjegjësisht të

pahijshme, si parakalimet jo të rregullta, mos mbajtja e distancës dhe të ngjashme. Policia kërkon që vozitësit të përshtatin shpejtësinë e me kushtet në rrugë si dhe të mos drejtojnë automjetin nëse kanë konsumuar alkool.

"Nëse nuk respektohen këto rregulla, atëherë vozitësit do të përballen me dënime të cilët varësisht nga kundërvajtja sillen pre 35 deri në 400 euro. Krahas kësaj, po ashtu parashihet edhe marrja e lejes së vozitjes nga tre muaj deri në një vit, sidomos nëse bëhet fjalë për shpejtësi të madhe, mos pasje të lejes së vozitjes dhe vozitje nën ndikim të alkoolit. Këto rregulla vlejnjë për të gjithë edhe për vozitësit vendas, por edhe ata që do të kthehen", thotë Marijan Josifovski, zëdhënës i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë.

Skupi Festival 2017



Medea, një grua e lënë anash

Shkup, 18 tetor - Festival Ndërkombëtar i Tetatrit, Skupi Festival, në çdo edicion të saj sjell shfaqje interesante. E tillë ishte edhe shfaqja "Fol Medea", me tekst dhe regji të Mehdi Sheikhvand, realizim ky i Kompanisë Teatrorë Jirjirak nga Tehrani. Në fakt, bëhet fjalë për një shfaqje, përplot me simbolikë dhe që në qendër të vëmendjes ka gruan, përkatësisht vuajtjen e saj, shtypjet që i bën dhe mos-shprehja e respektit të merituar. Medea, një figurë mitologjike, në këtë rast vjen e mishëruar në fatin e një grua të lënë anash.

Autori dhe regjisor Mehdi Sheikhvand ka zgjedhur një koncept interesant, duke na ofruar një shfaqje shumë të mirë dhe njëherit edhe aktualitetin e teatrit iranian. Të mërkurën në mbrëmje në skenën e Qendrës Kulturore të të Rinjve u ngjiti Teatri Kombëtar Bullgar "Ivan Vazov" me shfaqjen "Shërbëtorët" të Jena Genet dhe në regji të Diana Dobrev. (sh.h.)

UT në simpoziumin shkencor për bimët mjekësore

Prania e specieve ekonomikisht të rëndësishme e bimëve mjekësore dhe aromatike që gjenden rastësisht në rajone të caktuara, konfirmojnë mundësinë e kultivimit të llojeve të njëjta, sepse ato mbillen në të njëjtën strukturë toke dhe në kushte identike mikro - klimatike

Tetovë, 18 tetor - Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit i Universitetit të Tetovës në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë të Inony Universitetit nga Malatija e Republikës së Turqisë, organizuan simpoziumin shkencor ndërkombëtar për bimët mjekësore, aromatike dhe ngjyruese. Simpoziumi u mbajt në Universitetin Inony, më 5-7 tetor 2017, ku tuboi së bashku shkencëtarë, hulumtues dhe delegatë të kësaj fushe. Në këtë tubim shkencor u shpalosën për-




parimet e kohëve të fundit në teknologjinë e bimëve mjekësore, aromatike dhe ngjyruese dhe u përcaktuan prioritetet e veprimit për të ardhmen. Simpoziumi u përqendrua në informimin dhe mbrojtjen e bimëve mjekësore dhe aromatike që rriten në Turqi, si shtëpi e llojeve të shumta endemike; zhvillimet e fundit teknologjike në lidhje me përpunimin dhe qasjet rreth zgjidhjes së problemeve të indus-

trisë. Nga simpoziumi u ndërmorën veprime në lidhje me të ardhmen e bimëve mjekësore, aromatike dhe ngjyruese me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në lidhje me këtë çështje. Në emër të Universitetit të Tetovës dhe Dekanit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Xhezair Idrizi, pjesëmarrësve në këtë simpozium ju drejtua profesori i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore

dhe të Ushqyerit, Erhan Sulejmani, i cili foli për studimin e parametrave bio-morfologjike të disa bimëve mjekësore dhe aromatike të Malit Sharr në Maqedoni. Ai tha se, "tendenca globale për promovimin e stilit të jetesës dhe të ushqyerit të shëndetshëm ka krijuar një industri të fuqishme për bimët mjekësore dhe aromatike që sot në tregun botëror ka një të ardhur vjetore mbi 25 miliardë

euro". Gjithashtu, potencoi se përshtatshmëria e faktorëve të klimës dhe tokës në vend krijojnë ekskluzivisht biodiversitetin e pasur në Maqedoni. Prania e specieve ekonomikisht të rëndësishme e bimëve mjekësore dhe aromatike që gjenden rastësisht në rajone të caktuara, konfirmojnë mundësinë e kultivimit të llojeve të njëjta, sepse ato mbillen në të njëjtën strukturë toke dhe në kushte identike mikro - klimatike. Në emër të Inony Universitetit, me fjalë përshëndetëse ju drejtua Rektori Ahmet Kizilaj. Në fjalimin e tij potencoi që kampusi i Inony Universitetit është një nga kampuset më të bukura të Turqisë dhe shtoi: "Ne jemi një universitet i përparuar në lëmin e mjekësisë. Ne jemi universiteti i 14-të i renditur në Turqi. Spitali ynë është ndërtuar nga presidenti i 8-të i Turqisë, Turgut Ozal. Qendra jonë mjekësore është e para në Evropë dhe Turqi dhe e dyta në botë, në transplantimin e

mëlçisë në organizmat e gjallë. Ka qenë një sukses i vazhdueshëm për nëntë vite dhe projekti më i rëndësishëm i epokës sime është Spitali Onkologjik si qendër regjionale". Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Ali Adnan Hajaloglu, në këtë solemnitet theksoi se përdorimi i bimëve mjekësore dhe aromatike është aq i vjetër sa edhe historia e njerëzimit. Ai tha se në këtë simpozium janë paraqitur mbi 500 punime shkencore, nga të cilat 308 punime janë përzgjedhur nga komisioni shkencor, edhe atë, 84 prezantime me gojë dhe 224 punime posteriale, që vërtetojnë rëndësinë dhe suksesin e këtij simpoziumi. Gjatë këtij simpoziumi u shpreh interesimi i madh në potencialin e biodiversitetit të bimëve mjekësore dhe aromatike të Malit Sharr në Republikën e Maqedonisë dhe u diskutua mundësia e zhvillimit të projekteve rreth identifikimit, sistematizimit dhe industrializimit të tyre. (U.H.)

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullatore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NPK VRAPÇISHTË Vrapçisht, me datë 15.09.2017 deri te Komisioni Rregullator për energjetikë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë për periudhën e rregulluar 2018-2020, të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-133/17 të datës 15.09.2017, dhe Kërkesë për përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-134/17 të datës 15.09.2017.

Me Kërkesat e dorëzuara, NPK VRAPÇISHTË Vrapçisht, kërkon të hyrat maksimale të rregulluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:

1. Për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rregulluara	denar	5.034.463	7.541.511	10.166.309
Sasia e porositur e ujit	nm3	450.386	454.271	456.229
Tarifa mesatare	den/nm3	11,50	13,44	13,57


2. Për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rregulluara	denar	4.335.065	4.360.351	4.954.279
Sasia e grumbulluar dhe larguar e ujërave të zeza urbane	nm3	75.985	82.273	93.686
Tarifa mesatare	den/nm3	33,85	31,57	34,06

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mkKOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullatore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NP KOMUNALEC Kavadarë, me datë 15.09.2017 deri te Komisioni Rregullator për energjetikë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë për periudhën e rregulluar 2018-2020, të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-118/17 të datës 15.09.2017 dhe Kërkesë për përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-117/17 të datës 15.09.2017.

Me Kërkesat e dorëzuara, NP KOMUNALEC Kavadarë kërkon të hyrat maksimale të rregulluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:

1. Për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rregulluara	denar	70.278.631	71.459.500	72.895.389
Sasia e porositur e ujit	nm3	2.924.449	2.928.497	2.932.554
Tarifa mesatare	den/nm3	22,54	22,96	23,48


2. Për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rregulluara	denar	11.142.934	12.546.157	13.923.908
Sasia e grumbulluar dhe larguar e ujërave të zeza urbane	nm3	2.550.643	2.554.551	2.558.466
Tarifa mesatare	den/nm3	4,13	4,56	4,97

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mkKOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullatore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NP NISKOGRADBA Ohër, me datë 18.09. deri te Komisioni Rregullator për energjetikë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-153/17 të datës 18.09.2017.

Me Kërkesën e dorëzuar, NP NISKOGRADBA Ohër kërkon të hyrat maksimale të rregulluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:


1. Për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rregulluara	denar	35.581.075	39.138.802	41.052.736
Sasia e grumbulluar dhe larguar e ujërave të zeza urbane	nm3	2.855.077	2.827.030	2.798.934
Tarifa mesatare	den/nm3	10,75	11,80	12,48

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mkKOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullatore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NP PROAKVA Strugë, me datë 18.09.2017 deri te Komisioni Rregullator për energjetikë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë për periudhën e rregulluar 2018-2020, të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-152/17 të datës 18.09.2017 dhe Kërkesë për përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-154/17 të datës 18.09.2017.

Me Kërkesat e dorëzuara, NP PROAKVA Strugë kërkon të hyrat maksimale të rregulluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:

1. Për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rregulluara	denar	80.312.432	82.928.403	87.246.715
Sasia e porositur e ujit	nm3	1.684.817	1.689.116	1.693.436
Tarifa mesatare	den/nm3	37,67	38,98	41,12

2. Për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane:


		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rregulluara	denar	15.526.675	21.343.030	21.880.891
Sasia e grumbulluar dhe larguar e ujërave të zeza urbane	nm3	1.068.490	1.205.242	1.354.191
Tarifa mesatare	den/nm3	13,00	14,43	13,22

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati Llazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NKP TETOVË Tetovë me datë 18.09.2017 deri te Komisioni Rregullator për energjetikë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë për periudhën e rregulluar 2018-2020, të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-155/17 të datës 18.09.2017 dhe Kërkesë për përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-156/17 të datës 18.09.2017.

Me Kërkesat e dorëzuara, NKP TETOVË Tetovë kërkon të hyrat maksimale të rreguluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:

1. Për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	59.153.377	61.881.041	64.459.872
Sasia e porositur e ujit	nm3	3.176.144	3.181.315	3.186.497
Tarifa mesatare	den/nm3	17,54	18,31	19,03


2. Për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	8.486.948	9.771.977	11.099.211
Sasia e grumbulluar dhe larguar e ujërave të zeza urbane	nm3	2.208.105	2.211.418	2.214.737
Tarifa mesatare	den/nm3	3,53	3,95	4,38

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mkKOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NP UJËSJELLËSI DHE KANALIZIME Shkup me datë 15.09.2017 deri te Komisioni Rregullator për energjetikë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë për periudhën e rregulluar 2018-2020, të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-111/17 të datës 15.09.2017, Kërkesë për përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-112/17 të datës 15.09.2017 dhe Kërkesë për përcaktimin e tarifës për pastrimin e ujërave të zeza të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-113/17 të datës 15.09.2017.

Me Kërkesat e dorëzuara, NP UJËSJELLËSI DHE KANALIZIME Shkup kërkon të hyrat maksimale të rreguluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:

1. Për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	930.999.700	990.218.894	1.044.184.077
Sasia e porositur e ujit	nm3	41.071.759	41.132.704	41.193.771
Tarifa mesatare	den/nm3	21,50	22,79	23,98

2. Për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	424.241.961	437.040.507	448.981.161
Sasia e grumbulluar dhe larguar e ujërave të zeza urbane	nm3	35.588.484	35.639.228	35.690.074
Tarifa mesatare	den/nm3	11,21	11,55	11,87


3. Për pastrimin e ujërave të zeza:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	88.854.027	88.280.308	87.487.254
Sasia e ujit të pastruar	nm3	35.499.112	35.549.726	35.600.442
Tarifa mesatare	den/nm3	2,27	2,27	2,26

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mkKOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NPN PROAKVA Strugë NJ.R. Vodovod Ohër, me datë 11.09.2017 deri te Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë për periudhën e rregulluar 2018-2020, të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08- 102/17 të datës 11.09.2017.

Me Kërkesën e dorëzuar, NPN PROAKVA Strugë NJ.R. Vodovod Ohër, kërkon të hyrat maksimale të rreguluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:


1. Për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	125.570.905	127.096.046	130.283.376
Sasia e porositur e ujit	nm3	2.863.276	2.835.041	2.806.745
Tarifa mesatare	den/nm3	42,36	43,33	44,84

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË
MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mkKOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 nga Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e vërtetimit të tarifës për shërbime ujësjellësi dhe të tarifës rregullore për shërbime ujësjellësi ("Gazeta zyrtare e RM" nr.63/17), Komisioni Rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se NPK VARDAR Brvenicë me datë 15.09.2017 deri te Komisioni Rregullator për energjetikë dorëzoi Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë për periudhën e rregulluar 2018-2020, të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-137/17 të datës 15.09.2017 dhe Kërkesë për përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane të regjistruar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr.08-138/17 të datës 15.09.2017.

Me Kërkesat e dorëzuara, NPK VARDAR Brvenicë, kërkon të hyrat maksimale të rreguluara për çdo vit të periudhës së rregulluar dhe tarifave përkatëse për çdo shërbim të ujit të arrijnë:

1. Për furnizimin me ujë pijshëm apo furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	8.194.580	8.491.556	8.847.156
Sasia e porositur e ujit	nm3	454.394	455.114	455.834
Tarifa mesatare	den/nm3	17,88	18,47	19,19

2. Për grumbullimin dhe largimin e ujërave të zeza urbane:

		2018	2019	2020
Të hyrat maksimale të rreguluara	denar	1.634.118	3.026.874	3.410.115
Sasia e grumbulluar dhe larguar e ujërave të zeza urbane	nm3	158.418	236.263	330.863
Tarifa mesatare	den/nm3	10,29	11,24	9,18

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 25.10.2017, deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: Rr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 19.10.2017

KOMISIONI RREGULLATOR
PËR ENERGJETIKË I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISËRr. Makedonija nr. 25, Pallati L Lazar Pop – Trajkov – kati 6 • 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 / 02 3233-586 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk

Zgjedhjet grisën "Tigrin" prej letre të Maqedonisë



Mero BAZE

Zaev pati mençurinë dhe vizionin që për herë të parë në Maqedoni, jo vetëm bashkëpunoi me shqiptarët, por bëri shqiptarë deputetë në listën e tij, duke marrë rreth 70 mijë vota shqiptarësh. Rezultati është i dukshëm

Zgjedhjet lokale në Maqedoni dëshmuar se partia e Nikolla Gruevskit, u shkatërrua në gjithë bastionet e saj dhe se nacionalizmi me të cilin ajo ju kundërvu perëndimit dhe shqiptarëve, ishte një farsë. Rezultatet e raundit të parë tregojnë se LSMD e Zoran Zevit, i cili qeveris së bashku me shqiptarët, ka fituar dukshëm në gjithë bastionet që më parë mbaheshin prej Gruevskit, ndërsa nga partitë shqiptare ka përparuar Aleanca Shqiptare e Ziadin Selës, i cili u bë simbol i goditjes nga dhuna e Gruevskit ditën e parë që u çel parlamenti i Maqedonisë, pas gjashtë muaj krizë.

Të gjithë ata që mbronin Gruevskin në procesin e bllokimit të dorëzimit të pushtetit në Maqedoni, nën të arsyesonin se ai ka shumicën e Maqedonisë me vete dhe se aleanca e Zaevit me shqiptarët do të jetë një dështim, pasi do të konsiderohet kolaboracionizëm me shqiptarët. Këtë ide e ka pasur dhe opozita e sotme shqiptare, e cila u rreshtua thuasht hapur në anën e Gruevskit. Lulzim Basha biles dhe përshëndeti formimin e qeverisë mes Gruevskit e Ahmetit, edhe pse ata nuk e shpallën. Ilir Meta po ashtu i qëndroi deri në fund linjës pro Gruevskit.

Dhe nuk ishin vetëm opozitarët e Tiranës. Një linjë e tërë, kryesisht lindore, dhe lobistë të paguar nga Gruevski, përsëritën gjithë marrëzitë e Saliut në Tiranë, duke shpikur komplotet Soros në Ballkan, duke shpresuar tek Trumpi e broçkulla të tilla. Gjithë "fuqia" e Gruevskit ishte tek fakti që ai kishte unifikuar maqedonasit kundër shqiptarëve dhe se çdo bashkëpunim me shqiptarët do kthente një parti maqedonase në pakicë.

Zaev pati mençurinë dhe vizionin që për herë të parë në Maqedoni, jo vetëm bashkëpunoi me shqiptarët, por bëri shqiptarë deputetë në listën e tij, duke marrë rreth 70 mijë vota shqiptarësh. Rezultati është i dukshëm.

Testi i parë elektoral pas dy vitesh krizë dhe ngërç në kalimin e pushtetit, dëshmoi se Gruevski ishte një tigër prej letre që tentonte të trembte Perëndimin me nacionalizmin e tij, i cili nuk funksionoi. Bashkë me të, ranë gjithë teoritë kërcënuese ndaj Perëndimit në Maqedoni, dhe sidomos ideja e destabilizimit, duke ndarë më keq shqiptarët me maqedonasit.

Partia më e madhe e shqiptarëve, duket se është plasaritur pak, por mbahet ende në këmbë e para, ndërsa Ziadin Sela po përparon drejt një partie të rëndësishme, duke përqendruar votën në Strugë dhe Gostivar dhe po barazohet me Besën, një parti që duket se ka një shfryrje nga zgjedhjet e shkuara. Retorika pro-islamike e saj duket se për fat nuk ka funksionuar.

Por në tërësinë e vet, rezultati i këtyre zgjedhjeve, dëshmon se ata që donin të frikësonin Perëndimin me një "Tigër prej letre" në Maqedoni, dështuan. Gruevski dhe humbja e tij e thellë, janë një mesazh i qartë për këdo që sa herë rrezikon pushtetin, tenton t'i vërë zjarren vendit, për të trembur Perëndimin me destabilizim. (tiranaobserver)

Si e zhgënjyen njëra-tjetrën Kosova dhe BE-ja



Augustin PALOKAJ

Vërtet diplomatë nga BE-ja në raportet me lidhshin politik të Kosovës kanë përdorur taktikën e premtimeve dhe të kërcënimeve, sa herë që kanë dashur të nxjerrin kompromise të rënda për Kosovën, qoftë në favor të Gjykatës Speciale apo në dialog me Serbinë. Prandaj, edhe u ka konvencuar që në pushtet të jenë njerëz që janë të ndjeshëm ndaj një taktike të tillë. Por për këtë nuk kanë lënë gjurmë

Stabilizim Asociimit".

Dhe siç ndodh tash e shumë vite në raportet e Kosovës me BE-në, nëse Kosova nuk zbaton diçka atëherë pason dënimi përmes ngecjes në proces. Por nëse Kosova zbaton atëherë kjo nuk çon automatikisht në realizimin e premtimeve. Vërtet diplomatë nga BE-ja në raportet me lidhshin politik të Kosovës kanë përdorur taktikën e premtimeve dhe të kërcënimeve, sa herë që

kanë dashur të nxjerrin kompromise të rënda për Kosovën, qoftë në favor të Gjykatës Speciale apo në dialog me Serbinë. Prandaj edhe u ka konvencuar që në pushtet të jenë njerëz që nuk kanë lënë gjurmë. Problemi ka qenë tek liderët kosovarë që premtimet taktike, shpesh nga ata që nuk kanë fuqi të marrin vendime për t'i realizuar të njëjtat premtime, i ka konsideruar si garanci. Tash jemi në situatën në të cilën presidenti Thaçi dhe disa përfaqësues të BE-së luajnë lojën e fajësimit të njëri-tjetrit për dështime, ndërsa çmimin e paguajnë qytetarët e Kosovës.

Se Thaçi jepte premtime për të cilat nuk besohet se janë reale rreth vizave, integriteteve evropiane, anëtarësimeve në strukturat ndërkombëtare e kishim vërejtur qëmoti. Por në politikën e brendshme të Kosovës kjo ishte një metodë e mirë e tij për të përfituar mbështetje. Sepse shumë njerëz më me dëshirë i besonin premtimeve të tilla sesa vërejtjeve se ato nuk do të ndodhin dhe se janë joreale. Nuk ka nevojë tash të kthehemi dhe të analizojmë se sa herë Thaçi ka thënë se

vizat do të hiqen "në afat rekord". Keqdashësit do të thoshin se tashmë vërtet janë thyer të gjitha reko-rdet, për fat të keq për kohëzgjatje të procesit. Edhe kur ata që më së shumti në Bruksel angazhoheshin për liberalizimin e vizave, dhe për heqjen e diskriminimit poshtërues ndaj kosovarëve, siç ishte Ulrike Lunaçek, tërhiqnin vërejtjen se premtimet për liberalizim të shpejtë janë joreale, nga zyrtarë të Kosovës dëgjonim se ata kanë "garanci direkte nga Brukseli se kjo do të ndodhë".

Sikurse Thaçi premtonte "liberalizim të shpejtë vizash" ashtu Edita Tahiri, si kryenegociatore në një dialog që Kosovës më shumë i solli komplikime sesa zgjidhje problemesh, fliste për "Pako dhuratash" nga BE-ja. Në tërë këtë proces, Serbia, e cila tashmë e kishte liberalizimin e vizave, ka marrë statusin e kandidatit, ka nisur negociatat e anëtarësimit dhe po hap dhe mbyll kapitujt negociues duke u shkëputur, së bashku me Malin e Zi, nga vendet e tjera të rajonit të cilat tashmë kanë një status të kandidatit të dorës së dytë. Prandaj tash vetëm për Serbinë dhe për Malin e Zi flitet për një perspektivë të

Skenarë apokaliptikë, por jo shumë...



Gwynne DYER

Të paktën një ushtarak me gradë shumë të lartë duhet të gjendet gjithmonë në vend, për të monitoruar urdhrat që vijnë nga Shtëpia e Bardhë, dhe t'i revokojnë nëse është e nevojshme

mi, që do të ulet diku në oqean, dhe jo një sulm).

Trump keqkuptohet dhe mendon se Peniani është gati për të nisur një raketë kundër Shteteve të Bashkuara. Në fund të fundit, kronika kishte dhe një

grafikë, ku shihej trajektorja e raketave të Koresë së Veriut që mbërrijnë në Shtetet e Bashkuara, dhe Trump ka shumë më tepër besim tek Fox Neës, se sa tek shërbimet e fshehtë. Kështu që u jep urdhrë të gjitha forcave strategjike të SHBA që të hyjnë në Defcon 1, Gatishmëri Nr. 1 e Mbrojtjes: lufta bërthamore është pranë.

Koreanoveriorët pikasin veprimtarinë e pazakontë të forcave amerikane - Lejet e dhëna Komandës Ajrore Strategjike, nëndetëse bërthamore amerikane në porte, që nisin të lundrojnë pa paralajmërim, duke lënë një pjesë të ekuipazheve në tokë e kështu me radhë -

dhe janë të bindur se po ndodh një sulm parandalues amerikan.

E frikshme

Koreanoveriorët hyjnë në ekuivalentin e tyre të Defcon 1: mobilizojnë dhe caktojnë forcat e tyre të armatosura, evakulojnë drejtuesit nga kryeqyteti dhe i shpien në bunkerë, diku në fshat, e kështu me radhë. Shërbimet e fshehtë amerikane e referojnë këtë aktivitet dhe këtë herë Trumpi i dëgjon. Prandaj urdhëron një sulm për të neutralizuar të gjitha armët dhe strukturat bërthamore të Koresë së Veriut. Natyrisht me armët bërthamore

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

parashikueshme reale të anëtarësimit në BE.

Kosova, ndërkohë, ka përfutur vetëm një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit, e cila vërtet është jetike për Kosovën dhe raportet me BE-në, por ka mbetur si një prej rezultateve të vetme të dukshme në këto raporte. Kosova nuk ka liberalizim vizash, nuk ka mbështetje të BE-së në asnjë tentim të integritetit në strukturat ndërkombëtare (sepse BE-ja duke qenë neutrale ndaj statusit nuk mund të mbështesë anëtarësimin e Kosovës në to) dhe nuk ka asnjë lëvizje as në njohjet nga 5 vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën.

E çka ka bërë Kosova: Ka pranuar fusnotën në emrin e saj që në një mënyrë, qoftë edhe simbolike, mund të shihet si heqje dorë nga shtetësia dhe pranim që të trajtohet ndryshe nga shtetet sovranë. Ka pranuar vazhdimin e mandatit të EULEX-it ashtu siç ka kërkuar BE-ja. Ka pranuar krijimin e Gjykatës Speciale, e cila do të merret me krimet e supozuara të disa prej ish-liderëve të UÇK-së. Është fituar përshtypja sikur Kosova duhet të marrë vendime për t'iu përshtatur nevojave të BE-së e jo anasjelltas. Pra është shndërruar në një hapësirë ku BE-ja bën eksperimente të tipit EULEX. Gjykata Speciale e të tjera. Dhe kjo Gjykatë Speciale, me mërinë e çuditshme "dhome" e specializuara të Kosovës" thuhet gjithmonë se është krejtësisht e Kosovës edhe pse vetë përfaqësuesit e Kosovës e kritikojnë atë se po bashkëpunon me Serbinë, por jo me Kosovën. Pra kemi edhe një paradoks; një Gjykatë të Kosovës, e cila nuk po bashkëpunon me Kosovën e po bashkëpunon me Serbinë!

Mund të besojmë se qëllimi i krijimit të kësaj Gjykate nuk është që të njolloset as lufta e UÇK-së e as Kosova. Por përkundër kësaj Kosovës kjo Gjykatë që tash i ka bërë dëm historik, pa marrë parasysh se kë dhe kur do ta akuzojë dhe çfarë verdiktesh do të nxjerrë në fund. Qëkur është krijuar "Task force" speciale kemi mbetur në pozicionet e kohës kur Dick Marty kishte nxjerrë raportin e tij me akuzat për nxjerrje të dhunshme dhe shitje organesh. E ato pozicione janë se "nuk ka dëshmi, por besohet se ka ndodhur". Në këso rrethanash kemi njollosjen e Kosovës, shantazhimin e disa liderëve politikë të Kosovës që si pasojë mund të bëjnë kompromise në dëm të shtetit, dhe kemi një krijim të hapësirës së lidershit politik të Serbisë që të ketë ofensiva propagandistike kundër Kosovës.

Pa marrë parasysh qëllimin e krijimit të Gjykatës, ajo në histori do të përdoret si dëshmi se Kosova ka qenë i vetmi shtet në territorin e ish-Jugosllavisë për të cilin nuk ka mjaftuar Gjykata e Hagës për krime lufte, as Gjykatat vendore të Kosovës e as ato të EULEX-it me mandat ekzekutiv, që të procedohen krimet e rënda, por është dashur edhe një ekstra Gjykatë e Specializuar. Pra vetë krijimi i kësaj Gjykate Speciale është pranim i dështimit të sistemit të drejtësisë së Kosovës, dhe me të edhe të EULEX-it. Pranimi se në Kosovë nuk ka Gjykata të pavarura dhe profesionale për t'u marrë me krime të tilla serioze, se në Kosovë nuk mund të mbrohen dëshmitarët dhe pranim i shumë dështimeve të tjera të përbashkëta evropiane-kosovare.

e dimë se çfarë personalisht mund t'i kenë "garantuar" presidentit Thaçi kur ai e

kuante veten në fjalime në Bruksel "Kampion i krijimit të Gjykatës Speciale", duke thënë se "Kosova nuk ka çfarë të fshehtë". Por duket se tash Thaçi, ndoshta duke u besuar premtiveve ka dalë i dëshpëruar. Sepse sa më shumë që besohet në premtime aq më i madh edhe bëhet dëshpërimi kur ato nuk realizohen.

Por edhe në BE thonë se ka pasur premtime nga ana e Thaçit dhe e liderëve të tjerë kosovarë. Pohojnë se, kur ishte caktuar kushti për ratifikimin e Marrëveshjes me Malin e zi për demarkacionin e kufirit, pala kosovare ishte pajtuar me atë kusht duke thënë se "kjo është vetëm çështje teknike dhe i kemi votat e duhura". Disa prej zyrtarëve të BE-së, madje, si ilustrim të mungesës së gatishmërisë, përmendin pyetjen se si u bë që të sigurohen votat për ta bërë Thaçin president e ato për ratifikim jo. Po ashtu, thonë në BE se ekziston mungesa e evidente e palës kosovare për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivel të lartë, pa ndërhyrje politike dhe për ta dëshmuar këtë përmes vendimeve fuqiplote të gjykatave. Pra, kemi tash një situatë në të cilën edhe BE-ja e edhe Kosova janë të zhgënjyera në një mënyrë me njëra-tjetrën. Problemi me "garancitë" e BE-së është se ato nuk kanë ekzistuar asnjëherë në formën e garancive. Sepse në diskursin e institucioneve të BE-së nuk përdoret fjala "garanci" ndonëse mund të jepen premtime. Edhe nëse disa zyrtarë të BE-së për nevojë të përfitimeve të momentit, kanë dhënë premtime, atë e kanë bërë personat të cilët nuk kanë pasur ndikim të madh. Besohet se shumë premtime, në takime kryesisht private janë dhënë

nga zyrtarë të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), përfshirë edhe për vizat. Por ky shërbim, edhe pse mund të ndihmojë në aspektin politik, nuk vendos për një gjë të tillë, sepse vizat janë kompetencë e Këshillit të Ministrave të Brendshëm të BE-së.

Në kohën e dëshpërimit me BE-në, presidenti i Kosovës Thaçi ka përmendur, madje sikur në formë kërcënuese, se kosovarët do të pajisen me pasaporta të Shqipërisë. Shqipëria nuk do ta bëjë këtë, së paku jo në mënyrë masive, sepse me këtë do të rrezikonte edhe më shumë që Shqipërisë t'i ktheheshin vizat. Edhe ashtu ky kërcënim përmendet për shkak të numrit relativisht të madh të azilkërkuësve nga Shqipëria në vendet e BE-së. Gjëja e fundit që i duhet Shqipërisë është që ajo të akuzohet se po ndihmon largimin masiv të kosovarëve drejt BE-së, duke i pasur ata me pasaporta. Të rikujtojmë se as Serbia nuk mund t'i pajisë serbët e Kosovës me pasaporta me të cilët mund të udhëtojnë pa viza në BE. Serbëve të Kosovës u lëshohen pasaportat në një zyre të veçantë në Beograd, me shifra të dallueshme, për të cilat pasaporta nuk vlen liberalizimi i vizave. Natyrisht se ka raste kur kjo tejkalohet përmes dhënies ilegale të pasaportave me adresa fiktive në territorin e Serbisë. Në BE pohojnë se ka të dhëna se këtë e bëjnë edhe për shqiptarë të Kosovës si një skemë mashtruese. Si pasojë e lojërave dhe e mungesës së transparencës e sinqeritetit të dënuar dhe të izoluar mbeten qytetarët e Kosovës, shqiptarë e serbë, ndërsa politikanët janë të njohur që të kalojnë nga dëshpërimi në kënaqësi dhe anasjelltas. (koha.net)

Armë dhe naftë

Komuniste dhe ateiste, Rusia ka qenë prej kohësh "dega" tokësore e ferrit për Riadin. Rënia e Murit të Berlinit nuk i ndryshoi gjërat, sepse lidhjet ndërmjet amerikanëve dhe sauditëve ishin të thella



Bernard GUETTA

Mbreti Salman i Arabisë Saudite ishte për një vizitë në Moskë, ku bleu armë ruse, firmosi kontrata në seri u përpoq të gjejë mënyra për të rregulluar, së bashku me Vladimir Putinin, çmimin e naftës. Udhëtimi i Salman tregon shumë për gjendjen e botës.

Komuniste dhe ateiste, Rusia ka qenë prej kohësh "dega" tokësore e ferrit për Riadin. Rënia e Murit të Berlinit nuk i ndryshoi gjërat, sepse lidhjet ndërmjet amerikanëve dhe sauditëve ishin të thella.

Por pastaj Amerika e Bushit vendosi të përmbyste Sadam Huseinin në Irak, duke ia besuar komandën e vendit shumicë shiite, e njëjta rrymë islamike si iranianët, të cilët janë armiq të betuar të sauditëve. Pavarësisht kundërshtimit të Riadit, Barack Obama bëri një kompromis për çështjen bërthamore, i cili i mundësoi Iranit të shpëtojë nga kthetrat e sanksioneve ndërkombëtare, të cilët po e asfiksonin ekonominë e tij. Me abstenim e tyre nga konflikti sirian, Shtetet e Bashkuara kanë rihapur dyert e Lindjes së Mesme edhe për Rusinë, dhe kështu, pavarësisht vardisjes së Donald Trumpit ndaj Riadit, sauditët kanë vendosur të bëjnë ujdi me Moskën.

Situata rajonale i shtyu ata në këtë drejtim, duke filluar me naftën, burimi kryesor i rusëve dhe sauditëve, të cilët në një fazë të vështirë ekonomike ndajnë interesin për të kontrolluar çmimet për fuçi. Ata e kishin bërë këtë në dhjetor 2016, duke gjetur një marrëveshje që parashikonte një ulje të prodhimit nga vendet eksportuese. Sot, Putini përpiqet të zgjasë marrëveshjen, e cila duhet të përfundojë vitin e ardhshëm. Kjo është arsyeja pse ai ka takuar një herë Presidentin e Venezuelës dhe tani priti Mbretin Salman. Por në kundërshtim me atë që konspiratorët besojnë, nuk është vetëm nafta.

Në skenën e Lindjes së Mesme, rusët dhe sauditët janë në përplasje, sepse Moska është aleate e Iranit dhe regjimit sirian, dy armiq të Arabisë Saudite. Riadi dhe Moska nuk janë front i përbashkët në rajon, por referendumi për pavarësinë e kurdëve irakenë ndryshon shumë gjëra në Lindjen e Mesme.

Shtetet e rajonit po zbulojnë me shpejtësi se, përtë rivaliteteve të tyre dhe përplasjes mes shiitëve dhe sunitëve, duhet të gjejnë mënyrën për të bashkëjetuar, me qëllim pengimin e një ndryshimi të kufijve të tyre kombëtarë. Ka kurdë në katër prej këtyre vendeve, sunitë në Irakun me shumicë shiite dhe shiitë në Arabi Saudite, ku janë të përqendruar në zonat më të pasura me naftë.

Raison d'État bën të pashmangshme një aleancë mes fuqive në Lindjen e Mesme dhe kështu, në Rusi, sovranitë saudit e gjen veten duke bërë ujdi me një aleat të Iranit. (France Inter)

amerikane. Asgjë tjetër nuk do të mjaftonte.

Kështu nis Lufta e dytë e Koresë. Amerikanët e vrarë nuk janë shumë, dhe ndoshta nuk do të ketë as edhe një civil, sepse në fakt Korea e Veriut ende nuk ka raketa me rreze të gjatë veprimi, në gjendje për të goditur me saktësi SHBA. Por në të dy Koretë do të vdisnin miliona njerëz. Me pakëz fat kinezët do të rrinin e vështronin, ndërkohë që aleatët e tyre koreanoveriorë bëhen pluhur e

hi, po kush mund ta thotë?

Eshtë vetëm një skenar, që megjithatë nuk lë të mbyllin sy shumë njerëz, mes të cilëve shumë funksionarë të lartë të ushtrisë amerikane. Për këtë arsye, kohët e fundit janë shfaqur zëra për një pakt të fshehtë mes Sekretarit të Mbrojtjes, James Mattis, këshilltarit për sigurinë, gjeneralit H. R. McMaster dhe shefit të shtabit të Trumpit, gjeneralit John Kelly: të tre janë betuar që të mos lejojnë të ndodhen njëko-

hesisht jashtë vendit.

Pse jo? Sepse të paktën një ushtarak me gradë shumë të lartë duhet të gjendet gjithmonë në vend, për të monitoruar urdhrat që vijnë nga Shtëpia e Bardhë, dhe t'i revokojnë nëse është e nevojshme.

Mbikëqyrja e një të rrituri

Unë nuk mund të garantoj saktësinë e këtyre lajmeve, por i besoj. Në fakt, kisha spekuluar tashmë për ekzis-

tencën e një marrëveshjeje të tillë. Mattis, McMaster dhe Kelly janë oficerë të lartë ushtarakë, ekspertë dhe profesionistë, dhe do të ishte për ta një shkelje e rëndë, po të mos garantonin praninë e të paktën një të rrituri të përgjegjshëm, mes Trumpit dhe butonit bërthamor.

Nëse një nga këto gjeneralë do të gjendeshin vërtetë në pozitën ku u duhej të ndalnin Trumpin, me siguri do u duhej të merrnin një vendim shpirtcopëtues. Gjithë stërvitja që ka bërë dhe trainimi që kanë marrë, u thotë se duhet t'i binden autoritetit civil, dhe me siguri do të gjykohen përpara një gjykate ushtarake, nëse do të kundërshtojnë një urdhrë të presidentit. Nga ana tjetër, nuk duhet të lejojë që miliona genie njerëzore të vdesin, për shkak të një gabimi trashanik.

Unë jam i sigurt se e mendojmë dhe nuk mendoj se ndonjë prej tyre mund të dijë paraprakisht se cili do të jetë vendimi i tij, nëse vërtetë duhet të gjendet në një situatë të këtij lloji. Për një të rritur gjithmonë është shumë e komplikuar të bësh supervisorin, veçanërisht kur fëmija në fjalë është teknikisht eprori juaj. (Bota.al)



Në shiritin e kohës

SHQIPTARËT, ÇELËSAT PËR TË KUPTUAR JETËN DHE NATYRËN E TYRE

Standardi etik i shqiptarëve është besa, pra, fjala e dhënë. Pavarësisht nga rrethanat, kur një shqiptar jep fjalën, ajo nuk mund të shkelet dhe nuk ka nevojë për asnjë lloj marrëveshjeje të shkruar

Faik KONICA

Për të kuptuar historinë e një populli është e nevojshme të studiohet natyra e tij, por një studim i paanshëm është i vështirë, për shkak se dëshmitari mund të ketë ose një qëndrim të keq, ose një simpati të pambështetur, sipas përvojës vetjake që ka. Prandaj unë do të përpiqem të jap një vështrim të shkurtër për këtë çështje të veçantë, duke e parë nga disa kënde.



Së pari, ka shumë rëndësi të dihet se fyerja më e rëndë në Shqipëri është ta quash dikë të pabesë, pra që nuk është besnik. Shumë nga rastet e gjakmarrjeve kanë pasur si pikënisje akuzën për pabesë. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se në Shqipëri nuk ka njerëz që tradhetojnë, por na tregon pa u gabuar cila është kërkesa themelore për sjelljen, idealin që synohet. Anasjelltas, ka interes të vëmë në dukje se në Greqinë e sotme fyerja më e rëndë për një njeri është ta quash analfabet dhe të trashë, pra ideali i fqinjëve jugorë të Shqipërisë është zgjuarsia në vend të karakterit të fortë. Siç e thotë një fjalë e urtë, që përmendet shpesh kudo në Shqipëri, shqiptari për një plesht djeg jorganin, që do të thotë se është i padurueshëm dhe i krisur. Fjala e urtë ndoshta e ka prejardhjen nga ndonjë këshillë e pamenduar që e ka dhënë ndonjë prijës, për të mos u ngutur që të fillohet një përleshje e kushtueshme për ndonjë gjë fare të kotë. Një rregull tjetër shumë i bukur për sjelljen është thënia se “koka e falur nuk pritët”, që do të thotë se kur armiku kapet ose nënshtrohet, nuk ka pse të vritet. Historiani bizantin Nikifor Gregoras, për të cilin mund të thuhet pa dyshim se nuk ka qenë proshqiptar, na pohon faktin se shqiptarët as nuk i vrasin e as nuk i kthejnë në skllëvër armiq të mundur. Është e vërtetë që Gregorasi shton edhe emrat e disa popujve të tjerë të Perandorisë Bizantine që kanë po këtë etikë të luftës, por në kronikat bizantine mund të gjenden

shumë shembuj të kundërt me këtë. Sidoqoftë, në kohët e reja ndër të gjitha kombësitë e Evropës Juglindore vetëm shqiptarët njihen se i kanë mbetur besnikë traditës kalorësiake për ta kursyer armikun e mundur. Ka një rregull shqiptar të njohur botërisht e të provuar në jetë: gruaja është e paprekshme. Edhe në gjakmarrjen dhe në luftërat më të egra gratë nuk janë qëlluar. Kur dikush ka armiq që i gjuajnë për t'i marrë hakun dhe e ka ngushtuar nevoja për të bërë një rrugëtim, ndodh që ai, për ta bërë rrugën i sigurt, merr me vete një grua, ndonëse një veprim i tillë quhet paburrëri. Madje edhe cubat e rrugës së madhe e respektojnë këtë rregull.

Nja dyzet vjet më parë gjithë shtypi i botës u mbush një ditë me lajmin për një bëmë trimërore: një tren ndërkombëtar që shkonte nga Parisi në Stamboll, u ndal nga banditët në Traki. Të gjithë udhëtarët burra i detyruan të zbrinin nga treni me plaçkat në dorë dhe ua rropën të gjitha gjërat e çmueshme, kurse kryetari i bandës u tha grave të qëndronin nëpër vende dhe disa herë u kërkoi të falur për shqetësimin që u shkaktuan. Nga urdhrat që ai u jepte shokëve të vet në gjuhën shqipe, u bë e njohur kombësia e banditëve. Kur flasin me vetëdije për veten e tyre, shqiptarët krenohen se kanë shumë veti e virtyte. Kjo është një dobësi e gjithë popujve dhe mendime të tilla nuk kanë ndonjë vlerë. Përkundrazi, shprehjet e

thëniet popullore janë gjykime të vetvetishme, si të thuash, në to një popull është kapur në çastin kur flet pa e pasur mendjen. Ne do të vazhdojmë gjurmimin në këtë drejtim dhe do të përpiqemi të zbulojmë mendimet e popujve të tjerë për shqiptarët. Veçanërisht me interes është mendimi i turqve, sepse ata kanë qenë me shqiptarët për pesë shekuj. Të gjithë historianët turq flasin për kokëfortësinë e shqiptarëve. Arnaud-inud (shqiptarët kokëngjeshur), është një shprehje e ngulitur në kronikat e vjetra. Veç kësaj turqit mendojnë se shqiptarët janë kokëshkretë.

“Ka një damar shqiptari” është një thënie e zakonshme e turqve. Zoti Xhejms Redhauz (James Redhouse), i cili e ka përfshirë këtë thënie në Fjalorin e tij monumental turqisht-anglisht, jep këtë përkufizim në botimin e ri, të vitit 1921: “Arnautligi tuttu” i kërceu damari shqiptarit, ka folur ose ka vepruar siç bën zakonisht një shqiptar, me dhunë impulsive”. Sipas mendimit të komandantëve të vjetër turq të ushtrisë, shqiptari është një luftëtar shumë trim dhe i shkëlqyer për të sulmuar armikun ose për të marrë një vend me sulm, por është indiferent kur vjen puna që rrethanat kërkojnë një taktikë mbrojtëse. Sipas vlerësimit të turqve, shqiptari është i zgjuar. Megjithatë, një historian turk i shekullit të shtatëmbëdhjetë, Ibrahim Peçevi, nuk është i këtij mendimi. Duke folur për

vezirin e madh, Peçevi thotë se “Ajaz Pasha i përkiste kombësisë shqiptare, e megjithatë ishte jashtëzakonisht i zgjuar”.

Sipas turqve, një tipar tjetër karakteristik i shqiptarëve është dashuria për paratë; ata janë gjithnjë të gatshëm t’u hyjnë aventurave më të rrezikshme, po të jetë se e shohin që del fitim. Në kohët e Perandorisë Turke të vjetër, ata tregonin një histori: “E pyetën shqiptarin: a do të shkosh në ferr?” Ai u përgjigj: “Sa të paguajnë atje?”. Në gjuhën e sotme greke ka dy shprehje të lidhura me shqiptarët: kokëshqiptari që do të thotë njeri kokëngjeshur, i patundur; kur dikush ka halle dhe miqtë duan ta ngushëllojnë, ata i kujtojnë se zoti nuk është shqiptar, pra zoti është i mëshirshëm. Nënkuptimi i mosmëshirës është i shpjgueshëm në dritën e historisë. Për mjaft shekuj grekët e kanë njohur shqiptarin vetëm si sulmues, si pirat që grabit qytetet bregdetare, si ushtar të dërguar në ishujt e Greqisë për ekspeditat ndëshkimore, si xhandar ose si tak-sambledhës. Ana fisnike e shqiptarit është e panjohur për grekun.

Hobhauzit, mikut të Bajronit e që u quajt më pas lord Brauton, i kishte bërë shumë përshtypje ndjenja kombëtare si një tipar i shqiptarëve. “Këtu ka, thotë ai, – një shpirt pavarësie dhe dashuri për atdheun nga

gjithë populli e kjo në një masë të madhe e mënjanon dallimin e thellë që vihet re në pjesët e tjera të Turqisë ndërmjet pasuesve të dy feve. Kështu, kur banorët e viseve të tjera i pyet se çfarë janë, a ta përgjigjen: “Jemi turq” ose “Jemi të krishterë”, ndërsa banori i këtij vendi përgjigjet: “Jam shqiptar”... Ndjenja kombëtare bie fort në sy në karakterin e tyre. Nëse ndonjë prej tyre largohet nga vendi dhe duke rrugëtuar merr vesh se një bashkatdhetar i tij banon në një fshat pranë të cilit mund të kalojë, ndonëse nuk e ka parë e as nuk ka dëgjuar ndonjëherë për të, ai ndërton rrugë dhe shkon për ta takuar. Disa herë kam qenë dëshmitar i gëzimit që ata shprehin kur takohen kështu rastësisht, e shfaqin më haptas sesa i tregojnë ndjenjat dy anglezë miq në këto rase. E gjithë mënyra e sjelljes së tyre është e përzemërt dhe kur, pas një mungese të shkurtër, ndodh që një shqiptar ndesh një të njohur, i jep dorën e djathtë dhe e puth në faqe dhe po kështu bëjnë kur ndahen, ndërsa po të jenë takuar në rrugë, kur largohen ca njëri nga tjetri, qëllojnë me pistoletë ose me pushkë.”

Hobhauzi vë re se shqiptarët “nuk janë me shpirt të keq dhe kur bëhen të pamëshirshëm, kjo nuk vjen aq nga parimi i hakmarrjes sesa nga pasioni i çastit. Tradhtia është një ves që zorr se e gjen ndërmjet tyre”. Por vëzhgimet më të mira në studimin e thelluar të Hobhauzit janë për dëshirën e

shqiptarëve për argëtim. Kënaqësia e tij më e madhe, – shkruan Hobhauzi, – kur nuk është i zënë me luftë, është të ngrohet në diell, të pijë duhan, të hajë, të pijë raki, të dremisë ose të vijë rrotull në kopshtin rreth kaskolles së vet, duke i rënë lahutës me një melodi të vetme. Ndonëse është i ngeshëm, përsëri ai është i padurueshëm dhe i gatshëm të rrëmbejë pushkën e të fshihet në pyll me thirrjen e parë të prijësit të vet. Siç thotë Taciti, natyra e njeriut është çuditërisht e paqëndrueshme, kur po ata njerëz janë sa përtacë, aq edhe të pakënaqur që prehen... Por ngathtësia ose mirë urrejta për punën, që vërehet te ky popull, në asnjë mënyrë nuk shoqërohet me atë pamje rëndësie e dembellëku që e sheh përgjithësisht tek turqit. Përkundrazi, shqiptarët janë të gjallë, madje edhe lozonjarë; ndonëse lojërat e tyre popullore nuk janë shumë aktive, përsëri ata kur lozin tavëll dhe lojëra të tjera ulur, e tregojnë kënaqësinë me shpërthime të forta të qeshurash ose me shenja të tjera gëzimi fëmijëror. Gjithashtu kanë shfaqje shumë të forta kur shprehin pëlqimin ose mospëlqimin e tyre dhe meqë fare pak e zotërojnë veten, si dhe gjithmonë parapëlqejnë forcën kundrejt dredhisë, ata nuk kujdesen për t'i fshehur pasionet e tyre”

Libri i Hobhauzit e bëri Bajronin që të mos shkruante shumë gjatë për Shqipërinë. Poeti na e thotë vetë kështu: “Për Shqipërinë

dhe banorët e saj nuk kam dëshirë të zgjatem shumë, sepse këtë do ta bëjë shumë mirë bashkudhëtari im në një libër, që ka shumë mundësi të dalë nga shtypi përpara këtij ("Çajld Haroldit"), e prandaj as dua ta ndjek atë, as t'i dal përpara". Pastaj Bajroni bën disa vërejtje kureshtarë për shqiptarët dhe malësorët skocezë: "Arnautët ose shqiptarët më kanë bërë përshtypje të fortë me ngjashmërinë që kanë me malësorët e Skocisë nga veshja, shtati dhe mënyra e jetesës. Edhe malet e tyre dukeshin si të Kaledonisë, vetëm me një klimë më të butë. Fustanella e tyre, ndonëse e bardhë, ndryshe nga kilti, shtati i thatë e i gjallë, e folmja e tyre që tingëllojnë si keltishtja dhe zakonet e tyre të rënda, që të gjitha më kujtonin Morvenin".

Nënës së vet Bajroni i shkruante: "Mua më pëlqejnë shqiptarët" dhe letrat e tij dërguar nënës nga Shqipëria janë plot me hollësi piktorike. Po në atë periudhë të Likut, Hobhauzit dhe Bajronit, Shqipërinë e vizitoi dhe një klerik i kishës së Anglisë, hirësia T.S.Hjuz, i cili në dy vëllimet e udhëtimeve ka këto shënime të ngjeshura për natyrën e shqiptarit. "Nga temperamentit shqiptarët janë pak grindavecë dhe rrallë ta falin goditjen; pa asnjë dyshim nuk u mungon talenti e mprehtësia dhe është një fakt i shënuar që tre burrat më të mëdhenj që ka nxjerrë Turqia në këtë shekull, që të gjithë e kanë prejardhjen nga Shqipëria."

II

E vlen të vihet në pah se askush në këtë galeri vëzhguesish, me sa duket, nuk e ka gjetur karakteristikën më kryesore të shqiptarëve e pikërisht atë, pa njohjen e së cilës historia e tyre do të mbetet një mister, pra individualizmin e tyre. Një studiues gjerman, dr. Herbert Luis, i cili, siç e kemi thënë tashmë, u ngarkua nga qeveria shqiptare për të studiuar topografinë e vendit, pohon se në Shqipëri nuk ekziston një dukuri e tillë si turma.

"Një nga përshtypjet më të forta, – thotë dr. Luisi, – që më ka lënë kontakti i gjatë me popullsinë shqiptare, është me siguri kjo: që të çdo shqiptar ka një njeri me vetëbesim. Çdo individ, qoftë i zgjuar ose budalla, ka një aftësi të habitshme për të vendosur vetë dhe e vë në kartë pasurinë e gjakun e tij në një mënyrë prej biznesmeni. Në një situatë të paqartë, kushdo pa asnjë kufizim, qoftë i madh ose i vogël gjykimi i tij, merr pjesë në mënyrë të ndjeshme e ndërkaq secili është gati të marrë një nisim të fuqishme. Shkurt, nuk ka masa indiferente në Shqipëri."

Mungesa e kësaj fryme të kopesë mund të jetë interesante, po ajo ka pasur pasoja fatale për unitetin e Shqipërisë. Për shkakun se shqiptari gjithmonë ka dashur të marrë pjesë personalisht, drejtpërdrejt, madje edhe pa ndërmjetësinë e delegatëve, për diskutimin e çështjeve të gjithë



shoqërisë, ideja e tij për qeverinë nuk i ka kapërcyer kufijtë e qytetit ose të malit të tij. Ashtu si për grekët e lashtë dhe italianët e mesjetës, ideali i shqiptarit ka qenë qyteti-shtet. Dhe kur një nevojë kombëtare kërkonte unitetin e veprimi, vetëm pas bisedimesh pa fund arrihej të vendoseshin masat e përbashkëta që do të merrshin ndonjëherë tepër vonë. Sa herë që në të kaluarën është pushtuar Shqipëria, gjithmonë kjo ka ndodhur për shkak se ka munguar një qëndresë e bashkërenduar. Jo shumë larg, në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë autorët anglezë e francezë flasin për Shqipërinë si konglomerat i një numri të madh republikash të vockla dhe njësisish gjysmëfeudale, nganjëherë të lidhura në grupe, nganjëherë krejt të veçuara e të mënjanuara, që e njihnin sultanin si një sundimtar të largët e të papërcaktuar, i cili nuk ndërhynte në qeverisjen lokale. Është interesante të krahasohen dy sundimtarë të Shqipërisë në vitet e fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë: Ali Pashë Tepelena në Jug dhe Karamahmud Pashë Bushatlliu në Veri. Që të dy kanë qenë shqiptarë dhe që të dy kanë pasur sukses. Por Ali Pashën e urrenin, sepse me gjithë padijen dhe krimet e tij, ai e kishte nocionin e një bashkimi të disiplinuar dhe me dorë të përgjakur i shtrëngoi t'i bindeshin një autoriteti qendror, duke i shpartalluar pa mëshirë ata që do të kundërshtonin, ndërsa Karamahmudin e donin, sepse ai kishte konceptin tradicional për një qeveri që nuk ndërhynte dhe ruan tolerancën patriarkale kundrejt mosmarrëveshjeve lokale.

Një veçanti tjetër e shqiptarëve është neveria e përgjithshme ndaj dënimit. Meqë ndërhyrja e një autoriteti qendror në liritë lokale e individuale ndihet si uzurpim i pushtetit, ligjet e vëna nga një autoritet i tillë quhen në thelb të padrejta dhe zbatimi i tyre, sado e rëndë që të ketë qenë shkelja, vështrohet thjesht si një veprim i paligjshëm. Për më tepër, njëfarë ndjenje patriarkale bën që të shmangen

masat e rënda ndëshkuese. Dënimi me vdekje përgjithësisht quhet diçka e tmerrshme, ndërsa është një fakt i shënuar që sot, ashtu si dhe në shekujt e kaluar, nuk mund të gjesh njeri në Shqipëri që të pranojë detyrën e xhelatit për të varur. Për të ekzekutuar vendimet me vdekje të dhëna nga gjyqet, policia është e detyruar të gjejë evgjitë, të cilët kundërshtojnë me të madhe e megjithatë e kryejnë këtë ceremoni të tmerrshme dhe, natyrisht, në një mënyrë amatorësh, që ia zgjat vuajtjet viktimës.

Një tipar pa dyshim fatkeq i shqiptarëve dhe tipar mjaft i dukshëm është mungesa e plotë e idealizmit. Në një vend ku njerëzit vdesin aq kollaj për hiçgjë, nuk është dëgjuar që të vdesë dikush për një ideal ose çështje. Do të kërkonte shumë kohë të shpjegohej përse Shqipëria nuk e ka fituar lirinë më herët dhe ka një listë të shkurtër të dëshmorëve për lirinë kombëtare. Akte të trimërisë e të devotshmërisë, që kanë shkaktuar vdekjen e mijëra njerëzve, mund ta bënin të dukej i rremë pretendimi im për mungesën e idealizmit. Por besnikëria e verbër ndaj traditave të ngulitura dhe kanuni qibar për nderin janë pothuaj akte mekanike, që nuk nënkuptojnë se dikush e rrezikon jetën për një ideal të zgjedhur lirisht. Është folur shumë për mikpritjen e shqiptarëve dhe kjo është fare e vërtetë. Kjo frymë mikpritjeje deri në njëfarë shkalle kufizohet nga një prirje për të pasur

dyshime tek të huajt. Nuk ka njeri më të druajtur dhe më të rrudhur sesa një shqiptar që ballafaqohet me të porsaardhurit. Në breznitë e mëparshme vizitorët e huaj, me përjashtim të rasteve kur paraqiteshin si duhet prej dikujt, dyshoheshin se ishin spiunë, që kishin ardhur për të bërë hartat e vendit dhe për të mbajtur shënime e nevojshme për ndonjë pushtim të planifikuar. Tozeri na rrëfen për vështirësitë që ndeshi njëherë, kur u përpoq të vizitonte një kullë të vjetër. Ai dhe bashkudhëtari me të "... e nisën sulmin kundër kullës duke përdorur një gur të madh, meqë mungonte trakullorja, sepse derën e kishin shuluar fort dhe ne dëgjonim të zotin që lëvizte lart në katin e sipërm. Në fillim ai bëri sikur nuk na dëgjonte dhe, kur më në fund zbriti, nisi një dërdëllisje para se të na pranonin brenda; siç i tha përkthyesit tonë fshehurazi, ai nuk mund ta kuptonte pse nuk donim ta shihnim këtë vend, nëse nuk kishim ndër mend që të vinim me pas si pushtues". Sot dihet fare mirë se ndjenjat e dyshimit kundër të huajve janë zhdukur krejtësisht lidhur me vizitorët që nuk vijnë nga Evropa Juglindore, Zonjusha Durham, që ka shëtitur gjithandej në Shqipërinë e Veriut në fillim të këtij shekulli, na jep si shembull të mikpritjes shqiptare një vizitë që ka bërë në një kasolle prej balte, ku i zoti i rreckosur me një mirësjellje të zgjedhur i ftoi të rrinin: "Ne jemi të varfër, – u tha ai. – Bukë kripë e zemër, kjo

është gjithçka që mund t'ju ofrojmë, por ju jeni të mirëpritur dhe mund të qëndroni sa të doni."

Një tipar tjetër i karakterit të shqiptarëve, që është vënë në dukje shpesh nga vëzhguesit, është ndershmëria e tyre e rreptë. Standardi etik i shqiptarëve është besa, pra, fjala e dhënë. Pavarësisht nga rrethanat, kur një shqiptar jep fjalën, ajo nuk mund të shkelet dhe nuk ka nevojë për asnjë lojë marrëveshjeje të shkruar. Si pasojë, kuptimi i fjalës "i pabesë" është shkelja e fjalës së dhënë dhe pabesia, për të cilën tashmë kemi folur. Në një varg hartash tregtare shoqëruar me tekst, të botuara më 1886 nga ministria franceze e Tregtisë, fashikulli kush-tuar Shqipërisë i njofton eksportuesit se nuk ka nevojë për marrëveshje të shkruara për shqiptarët, sepse fjala e tyre e thënë ka mjaft peshë dhe nuk njihet asnjë rast që ta kenë shkelur."

Henri N. Breilsford, në librin e tij të njohur për Maqedoninë, ka këtë anekdotë: "Gjëja më kuptimplotë nga të gjitha ishte pyetja lakonike me të cilën iu përgjigj kërkesës sime një peshkop bullgar. "A i besoni atij?" – e pyeta unë. – "Ai është shqiptar. Apo nuk është?" – ishte përgjigjja. – Për shekuj me radhë sllavët dhe shqiptarët kanë qenë në armiqësi të pandërprerë për vdekje. Dhe ja, ky është komenti i një armiku për karakterin e tjetrit". Madje, edhe pas ankthit të Luftës Botërore, kur Shqipëria u bë kundër dëshirës fushë betejje për disa kombe dhe dësh-

mitare e shfaqjeve të përditshme të pandershmërisë lakuriqe (ushtarët e huaj i paraqisnin kuponat për cigare si kartëmonedha dhe ua jepnin bujqve të paditur, që nuk dyshonin se për t'u blerë mallra oficerët mashtronin popullin dhe njëri-tjetrin ose shisnin mallrat e vjedhura nga depot ushtarake e kështu me radhë), përgjithësisht me sa duket, ndershmëria shqiptare doli e paprekur, ndonëse pak e tronditur.

III

Le të vazhdojmë ende në disa drejtime të tjera për të parë çelësat e tjerë që kanë të bëjnë me karakterin e popullit shqiptar. Shqiptarët nuk janë aq të prirur për fjalë të shumta. Autori francez, Hiasint Hekar (Hyacinthe Hecquard), i cili ka qenë konsull i Francës në Shqipëri për shumë vjet dhe e njihje mirë Shqipërinë e Veriut, vë në dukje shkurtësinë me dinjitet të fjalimeve në kuvendet popullore. Megjithatë kjo heshtje me dinjitet nuk është e dukshme për brezin më të ri të shqiptarëve, që kanë studiuar në universitetet e Italisë, Francës, Austrisë dhe të vendeve të tjera.

Në një komb që ka shpirtin e aventurës, do të ketë edhe ca vend për bixhoz. Shqiptarët janë humbës të mirë. Kur kam qenë fëmijë, kam dëgjuar për një hanxhi, i cili u ul me disa klientë për një lojë bixhozi, i humbi të gjitha paratë dhe pasuritë e luajtshme dhe më në fund e vuri në bixhoz edhe hanin dhe e humbi. Atëherë thirri një noter, ia kaloi pasurinë fituesit, u përshëndos me të gjithë dhe çau e iku pa asnjë ankesë. Të burgosurit shqiptarë kanë shpikur një tip me të vërtetë original për bixhozin. Meqë nuk u lejohej të mbanin as letra dhe as zare, atëherë një ditë filluan këtë lojë: gjatë kohës së pushimit ulen rreth dhe presin mizat, atij që i vjen të parit një mizë, fiton një pikë. Kjo shpikje gjeniale i përket kohës së sundimit osman.

Një e metë që zakonisht nuk gjendet në karakterin e shqiptarit, është provokimi. Megjithatë në të kaluarën ka pasur një tip ngaci të përbuzur, i cili kishte kënaqësi të provokonte përlëshje vetëm për hir të qejfit. Tipa të tillë hynin në kafene ose në ndonjë vend tjetër me shumë njerëz dhe e lëshonin një cep të brezit që të zvarritej për tokë pas tyre. Dhe sapo dikush pa e parë e shkelte cepin e brezit (dhe kjo ishte një gjë që doemos do të ndodhte), ata ktheheshin, nxirrnin jataganin dhe i kërkonin shkelësit që të nxirrte edhe ai jataganin e të ndesheshin. Mbetërimin të këtyre provokimeve i dha fund më shumë hyrja e pistoletës sesa trysnia e policisë. Unë besoj se dihet gjithkund që shqiptarët janë tolerantë për besimet e tjera dhe, ndoshta, ky është i vetmi vend në Evropë, ku nuk ka pasur luftëra fetare. Për këtë arsye disa kanë folur shpesh për "skepticismin" shqiptar.

(Shkëputur nga nga libri "Faik Konica Vepra 2", zgjedhur e përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi (botimet DUDAJ 2001)





Gjyqtarët dhe prokurorët serbë pa asnjë shpjegim nuk shkuan për t'u dekretuar te Presidenti i Kosovës. Ky i fundit akuzon Beogradin për pengim të procesit, ndërsa BE për paaftësi

Ka dështuar dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, që do të punonin në gjykatat në veri të Kosovës, marrëveshje kjo e dakorduar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Kjo për faktin që gjyqtarët dhe prokurorët shumica nga ata serbë, pa ndonjë shpjegim nuk erdhën në ceremoninë e dekretimit në zyrën e Presidentit të Kosovës, ku të pranishëm ishin edhe shumë ambasadorë dhe shëfja e zyrës së BE-së, Natalya Apostollova. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me këtë rast e akuzoi Beogradin zyrtar për pengimin e dekretimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë që do të punonin në gjykatat e Veriut të Kosovës. Presidenti po ashtu tha se, "ky është dështim dhe paaftësi" edhe i Bashkimit Evropian si ndërmjetësues në dialogun Kosovë-Serbi dhe ndërmjetësues në zbatimin e marrëveshjes për sistemin e drejtësisë që duhej të fillonte së zbatuari sot (17.10). Në një komunikatë për media, zyra e Presidencës sqaron se dekretimi nuk

Dështon marrëveshja për drejtësinë në veri të Kosovës



ndodhi, sepse kandidatët nuk erdhën në zyrën e Presidentit.

THAÇI AKUZON PËR PENGIM SERBINË

"Ata nuk erdhën nga që u penguan nga Republika e Serbisë, me qëllimin e vetëm që të mos lejojë integrimin e tyre në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Është ky edhe një hap nga hapat e shumë që Republika e Serbisë ndërmerr

kundër qytetarëve tanë, nga se inkuadrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, ka rol të madh në jetën e komuniteteve, në realizimin e të drejtave të tyre dhe në sigurinë e qasjes së barabartë në drejtësi", thuhet në njoftimin e Presidencës. Më tej në njoftim, Presidenti Thaçi mosdekretimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve e cilëson dështim edhe të BE-së.

"Njëkohësisht, veprimi i sotëm i pengimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë që të vinë për dekretim tek Presidenti, është edhe një dështim dhe paaftësi tjetër e BE-së si ndërmjetësuese në këtë proces të zbatimit të Marrëveshjes për Drejtësi. Pavarësisht këtij dështimi të qëllimshëm të orkestruar nga Serbia, Republika e Kosovës do të vazhdojë të funksionojë, bazuar në parimet kushtetuese të gjithëpërfshirjes, prandaj

ftojmë edhe një herë palët e Marrëveshjes për Drejtësi që të kryejnë obligimet e tyre. Republika e Kosovës i ka përmbytur obligimet e saj në çdo aspekt", thuhet në njoftimin e Presidencës.

KEQARDHJE NGA BE, MESAZHE QETËSIMI NGA SERBIA

Zyrtarë të Bashkimit Evropian nga ana e tyre, shprehen keqardhje pse sot nuk u bë dekretimi i gjyqtarëve dhe

prokurorëve serb, ashtu siç ishin dakorduar në Bruksel. Megjithatë, Maja Kocijançiq, zëdhënëse e shëfës së politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini thotë se "BE pret që kjo çështje të përmbyllet sa më shpejt". Nga ana tjetër mediat serbe citojnë shëfin e Zyrës për Kosovën në qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç të ketë thënë se procesi i dekretimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë do të përfundojë deri të premtën e kësaj jave. "Kjo është hera e parë që nga viti 1999 që do të kemi gjykatë me shumicë serbe dhe me kryetarë serbë në Mitrovicë dhe prokurori me shumicë serbe. Pres që kjo punë e madhe dhe e rëndësishme për popullin tonë serb në Kosovë të përmbyllet deri të premtën", citohet të ketë thënë Marko Gjuriç. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq në gusht të këtij viti në praninë e shëfës për politikë të jashtme të BE-së, Federica Mogherini, u pajtuan që më 17 tetor të hyjë në fuqi marrëveshja për drejtësinë në veri të Kosovës. Kjo marrëveshje ishte nënshkruar në shkurt të vitit 2015, me të cilën parashihej shuarja e strukturave paralele serbe të drejtësisë. Të dy presidentët janë dakorduar që Kosova dhe Serbia të hyjnë në një fazë të re të dialogut, me të cilën parashihet përfundimisht përmirësimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

Drogë në shkolla

Bazuar në të dhënat statistikore dhe aktivitetet në terren, vërehet se numri më i madh i rasteve është iniciuar në perimetrin e sigurisë prej 300 metrave rreth shkollave, si në parqe, rrugë e hapësira të tjera. Ka rezultuar se prej 27 rasteve, 3 raste kanë qenë brenda oborreve të shkollave, 3 raste afër oborreve dhe 21 në largësi prej 300 metrash



në bashkëpunim me Qendrën e Mjekësisë Familjare, janë mbajtur ligjëratat si dhe janë angazhuar zyrtarë policorë për patrullime përreth shkollave. Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Daut Hoxha, tha për Radion Evropë e Lirë se aksioni ka përfshirë patrullimet përreth shkollave dhe hapësirave afër, si parqe e të ngjashme. "Bazuar në të dhënat statistikore dhe aktivitetet në terren, vërehet se numri më i madh i rasteve është iniciuar në perimetrin e sigurisë prej 300 metrave rreth shkollave, si në parqe, rrugë e hapësira të tjera. Ka rezultuar se prej 27 rasteve, 3 raste kanë qenë brenda oborreve të shkollave, 3 raste afër oborreve dhe 21 në largësi prej 300 metrash", tha Hoxha. Ndërkaq, Safet Blakaj drejtues i Qendrës Mediko-Psikoterapeutike "Labirint", tha për Radion

Evropa e Lirë se ka tendencë të rinjtë prej moshës 16 vjeçare që të konsumojnë në masë më të madhe drogën e tipit marihuanë. Sipas tij, numri i personave të kësaj moshe që kërkojnë ndihmë në këtë qendër, megjithatë, mbetet i vogël. "Vitet e fundit droga e llojit, marihuanë, është e përhapur te nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Moshja e konsumimit, sipas të dhënave tona, ka rënë në 16 vjeç. Shkollat po hezitojnë të raportojnë për këtë problematikë, pasi po mendojnë se si shkollë mund të stigmatizohen", thotë Blakaj. "Mesatarja e nxënësve që kërkojnë ndihmë brenda javës (në Qendrën Mediko-Psikoterapeutike 'Labirint') është rreth 6 fëmijë", tha Blakaj. Pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të rendit që të parandalohet përdorimi

dhe shitja e drogave, organizatat joqeveritare konsiderojnë se qasja e të rinjve deri te shitësit e drogave nuk është e vështirë, gjë që, sipas tyre, është shumë shqetësuese. Ato konsiderojnë se mungesa e një koordinimi të duhur të shumë mekanizmave institucionalë bën që kjo çështje të mos parandalohet. Edhe vet të rinjtë thonë se qasja deri tek drogat e ndryshme në Kosovë është e lehtë. Shpresa 23-vjeçare, studente e Fakultetit të Arteve tha se përdorimi i substancave narkotike është tejet shqetësues, e sidomos fakti që ato përdoren edhe nëpër shkolla. "Duke marrë parasysh që fëmijët në shkolla kanë qasje në droga dhe i përdorin ato, kjo tregon mjaft se blerja e saj nuk është problematike. Në shkolla kryesisht përdoret marihuana, që njihet si drogë e lehtë, por fëmijët e moshave nga 12 deri në 16 vjeç, megjithatë mendojnë se nuk do duhej të kishin qasje", tregon Shpresa. Ndryshe, përdorimi i substancës narkotike të llojit heroinë, kohët e fundit, ka shënuar rënie të përdorimit nga të rinjtë e Kosovës, për dallim nga vendet e tjera të botës, ku thuhet të ketë pasur rritje të përdorimit të saj.



Kosova e 50 zëvendësministrave!

Katër apo pesë zëvendësministra pritet t'i ketë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e cila udhëhiqet nga ministri Shyqiri Bytyqi. Në këtë dikaster qeveritar karrigen e zëvendësministrave tashmë e kanë zënë Muharrem Nitaj nga AAK-ja dhe Arbër Geci nga AKR-ja. Nga një post të zëvendësministrit në këtë Ministri pritet ta kenë edhe partneri i madh i koalicionit qeverisës (PDK) dhe minoritetet, shkruan "Zëri". Qeveria "Haradinaj", përpos numrit të madh të ministrave, përkatësisht 22 sosh, pritet t'i ketë edhe rreth 50 zëvendësministra. Gjatë ditës së djeshme kryeministri Ra-

mush Haradinaj ka emëruar Burbuqe Bakija - Devan zëvendësministre në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Edhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dje e ka zyrtarizuar Isni Kilajn zëvendësministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë e Zhvillimit Rural, ndërsa AKR-ja e Behgjet Pacollit ia ka besuar postin e zëvendësministrit të Shëndetësisë Granit Abdullahut. Javë më parë zëvendësministër i Sigurisë është emëruar përfaqësuesi i PDK-së, Agim Çeku, Mustafë Grainca zëvendësministër i Financave, si dhe Izmi Zeka zëvendësministër i Punëve të Brendshme, të gjithë këta zyrtarë të PDK-së.



“Ky kërcënim është multidimensional. Zhvillohen shpejtë vëllimi dhe ritmi të cilat më parë nuk i kemi parë. Ritëm aq të lartë nuk kam parë në karrierën time 34 vjeçare”, tha Parker

Britania e Madhe gjendet para një kërcënimi më alarmant nga terrorizmi dhe sulmet e reja në vend janë të pashmangshme, deklaroi drejtori i përgjithshëm i shërbimit britanik të inteligjencës MI5, Andrew Parker. “Ky kërcënim është multidimensional. Zhvillohen shpejtë vëllimi dhe ritmi të cilat më parë nuk i kemi parë. Ritëm aq të lartë nuk kam parë në karrierën time 34 vjeçare”, tha Parker. Ai theksoi sot se gjithnjë e më shumë aktivitete terroriste janë afër dhe vështirë të zbulohen. “Kërcënimi është i ndryshëm si kurrë më parë: komplotet bëhen këtu në Britani, por mbërrin edhe nga jashtë. Kemi edhe on-line komplete. Andaj janë sulme sulme të planifikuara komplekse, por edhe sulme spontane. Ekstremistët janë të gjitha grupmoshave, gjininë dhe origjinës, të bashkuar në idologjinë toksike të fitores së dhunshme që i shpie”, theksoi Parker. Ai shtoi se sulmet terroriste ndonjëherë mund të përshpejtohen dhe zbatohen në vepër në afat prej vetëm disa ditëve. Shërbimi britanik i inteligjencës është në goditje të opinionit pas pesë sulmeve terroriste këtë vit në të cilat humbën jetën 36 persona. Parker, megjithatë, pohon se

Britania para kërcënimit më alarmant terrorist



MI5 deri tani parandaloj më shumë sulme terroriste dhe se gjatë katër viteve të fundit ka zbuluar 20 sulme të planifikuara. Në ndërkohë, koordinatori i Bashkimit Evropian (BE) për luftën kundër terrorizmit, Gilles de Kerchove, tha se në vendet Evropës janë kthyer 1.500 persona që kanë luftuar në radhët e DEASH-it, në Irak dhe Siri. Kerchove i cili ka vizituar Tunizinë në kuadër të

takimeve zyrtare, në një takim me ministrat e Punëve të Brendshme, Mbrojtjes dhe Drejtësisë të Tunizisë, ka diskutuar për forcimin e bashkëpunimit në çështjen e luftës kundër terrorizmit. Pas takimeve, në një konferencë për shtyp në zyrën e BE-së në Tunis, Kerchove tha se, “Sipas të dhënave të BE-së, në vendet Evropës janë kthyer 1500 persona që kanë luftuar në radhët e ISIS-it, në Irak dhe

Siri”. “Me qëllim për tu përballur me problemet që rriten për shkak të kthimeve të luftëtarëve evropianë të lidhur me DEASH-in, Evropa duhet të mbrojë kufirin e saj dhe të marrë masat e duhura”, ka theksuar Kerchove, duke shtuar se marrëdhëniet mes BE-së dhe Tunizisë janë të forta. Ai është shprehur se është i nevojshëm një bashkëpunim i fortë për shkak të problemeve si ekstremizmi dhe trafikimi.

Evropa Lindore po vlon nga SIDA

OKB-ja u ka bërë thirrje shteteve evropiane që t'i kundërvihet bashkërisht përhapjes së sëmundjes së dobësisë të imunitetit Sida dhe virusit HIV. Evropa ndodhet sot para një sfide më të madhe se Afrika, kur është fjala për luftimin e HIV dhe të Sida-s, tha zëvendës-drejtori i Programit të OKB-së për Sida-n (UNAIDS), Luiz Loures, në Berlin. Në këtë kontekst ai iu referua rritjes së jashtëzakonshme të infeksioneve të reja në Evropën Lindore dhe në Azinë Qendrore, veçanërisht në Rusi. Eksperti u shpreh në hapje të konferencës së ekspertëve, që po zhvillohet në Berlin. Veprimet e mëvetsishme në nivel kombëtar në sfondin e valës së migracionit brenda Evropës nuk mund ta kufizojnë këtë problem, theksoi Loures. Sylvia Urban, nga kryesia e Aleancës së Aksionit kundër Sida-s në Gjermani, shtoi “po përjetojmë në rajon ndërkohë një katastrofë”. Në Rusi, vendi më i prekur i rajonit, vitin e kaluar numri i infeksioneve e tejkaloi shifrën e 100.000. Krahasuar me këtë - në Gjermani vitin e kaluar numri i rasteve të reja me infeksionin HIV është 3200. Rritja e infeksioneve të reja dhe e rasteve të vdekjeve nga Sida në Evropën Lindore dhe në Azinë qendrore është përkundër tendencës mbarëbotërore. “Qeveria gjermane duhet të kujdeset që Evropa Lindore të mund të përfitojë nga përvoja e Gjermanisë”, theksoi Urban. Duhet gjithashtu të punohet, që diskriminimi të mos vazhdojë të pengojë aksesin e grupeve më të prekura tek masat e profilaksisë dhe trajtimit. “Përndjekja e homoseksualëve, e konsumatorëve të drogës dhe të tjera pakica është një katastrofë njerëzore dhe e bën të pamundur parandalimin e HIV”, tërhoqi vëmendjen Urban.

Turqia, lider evropian në punësim

Me arritjen e numrit të të punësuarve në 27 milionë e 205 mijë persona në vitin 2016, Turqia brenda pesë viteve prodhoi dy milionë e 384 mijë vende pune shtesë



kishte të punësuar 24 milionë e 821 mijë persona, ndërsa vazhdimisht e ka rritur këtë shifër. Ndërkaq, me arritjen e numrit të të punësuarve në 27 milionë e 205 mijë persona në vitin 2016, Turqia brenda pesë viteve prodhoi dy milionë e 384

mijë vende pune shtesë. Teksa Turqia radhitet mbi vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) për sa i përket prodhimit të vendeve të punës, ajo po ashtu ka prodhuar vende pune më shumë se 24 shtete të BE-së së bashku, pa përfshirë Gjerman-

inë, Britaninë, Poloninë dhe Spanjën. Nga ana tjetër, Rumania, Greqia, Finlanda dhe Qiproja Greke kanë tërhequr vëmendjen si shtete me numër të zvogëluar të vendeve të punës gjatë periudhës në fjalë. Punësimi në Turqi fitoi intensitet në ndikimin e thirrjes së presidentit Recep Tayyip Erdoan për “mobilizim në punësim” në fillim të këtij viti. Sipas të dhënave në fund të muajit korrik të këtij viti, Turqia ka shtuar një milion e 122 mijë vende pune në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke arritur në 28 milionë e 758 mijë vende pune. Nëse shtohet edhe kjo shifër, atëherë rezultoni që Turqia të ketë prodhuar gjithsej tre milionë e 937 mijë vende pune.

Palestina refuzon kushtet e Izraelit për rifillimin e negociatave

“Asnjë mendim i Izraelit nuk do ta ndryshojë qëndrimin zyrtar për sa i përket vazhdimin të këtij procesi. Pajtimi mes lëvizjeve Hamas dhe Fatah është në interes të madh për Palestinën”, tha Redine



Palestina ka refuzuar kushtet e parashtruara nga Izraeli për rifillimin e negociatave të paqes. Lajmi është bërë i ditur nga agjencia palestineze e lajmeve Wafa, e cila ka cituar zëdhënësin presidencial Nebul Ebu Redine të ketë thënë se nuk kanë

pranuar kushtet e Izraelit për fillimin e negociatave për paqe me qeverinë palestineze. Ebu Redine ka theksuar se komuniteti ndërkombëtar ndihet i

gëzuar që qeveria kombëtare palestineze është kthyer në Gaza dhe që qeveria e pajtimit ka marrë detyrën në këtë vend. “Marrëveshja e arritur në

Kajro nën mbikëqyrjen e Egjiptit po shkon në drejtimin e duhur. Asnjë mendim i Izraelit nuk do ta ndryshojë qëndrimin zyrtar për sa i përket

vazhdimin të këtij procesi. Pajtimi mes lëvizjeve Hamas dhe Fatah është në interes të madh për Palestinën”, ka thënë Ebu Redine. Ndryshe, Izraeli ka parashtruar shtatë parakushte, përfshirë “çarmatosjen e Hamasit”, në mënyrë që të rifillojë negociatat për paqe me qeverinë palestineze. Në deklaratën ku Izraeli shpallti kërkesat e tij, kërkohej që “Hamas të çarmatohet, të njohë Izraelin dhe të braktisë terrorin, të kthejë trupat e pajetë të ushtarëve izraelitë dhe civilët e burgosur, qeveria palestineze të marrë kontrollin e plotë të sigurisë në Gaza dhe atë të vendkalimeve ku-

fitare dhe ta parandalojë kontrabandën. Qeveria palestineze t'i vazhdojë operacionet kundrejt strukturës terroriste të Hamasit në Bregun Perëndimor, t'i ndërpresë marrëdhëniet me Iranin ndërsa hyrja e parave dhe pajisjeve humanitare në Gaza të vazhdojë mbi mekanizmin e krijuar për këtë qëllim me qeverinë palestineze”. Në kuadër të bisedimeve në Kajro të Egjiptit, fraksionet palestineze Hamas dhe Fatah javën e kaluar nënshkruan “marrëveshjen e pajtimit” për t'i dhënë fund mospajtimeve. Negociatat për paqe mes Izraelit dhe qeverisë palestineze u ndërpre në vitin 2014.



Një jetëshkrim si i Xha Ramadan Çilku është një aventurë e gjatë jetësore, përplot sfida të kohës, ku individit s'është gjë tjetër pos një pendël që e hedh era andej këndeje

Daut DAUTI

Me keqardhje mora lajmin se ka ndërruar jetë Ramadan Çilku (sa kupto-va, më 15 tetor). Ndoshta ky emër për publikun e gjerë nuk thotë gjë në shikim të parë, përveçse për ata që do ta kenë lexuar librin "Shqiptarët e Ukrainës" ose të kenë parë ndonjë nga reportazhet e Sefer Musliut dhe Afet Miftarit, ku ai ka qenë personazh. Më 15 tetor arriti në cakun e fundit jeta e tij aventurë, siç e kishim quajtur në librin e përmendur, sepse një jetëshkrim si i Xha Ramadan Çilku është pikërisht I tillë, një aventurë e gjatë jetësore, përplot sfida të kohës, ku individit s'është gjë tjetër pos një pendël që e hedh era andej këndeje. Të jetosh tri kohë (ideologjike, historike), të shtetgosh nga një Dibrë e vogël e të arrish në selinë e carëve të Rusisë, të kishe përjetuar kohën e kralit të Serbisë, të kishe luftuar në Fushën e Sremit, të kishe arritur epokën e Titos dhe të gjendesh në Bashkimin Sovjetik në flakën e konfliktit Tito-Stalin..., s'kund të jetë tjetër pos një ëndërr e gjatë dhe më shumë se një furtunë që jetën e Ramadan Çilku e bënë një aventurë pa fund, kurse si autor ku ai paraqitet si personazh shkrimesh, më bën me fat dhe të privilegjuar që e kam njohur.

Para 25 vjetësh, me kolegët (e ndërjerë) Sefer Musliu dhe Afet Miftari, bëmë udhëtimin më sfidues të karrierës (gazetareske) për të tretë. Pas një lajmi agjencie të TASS-it (mbetur nga epoka sovjetike) se në Odesë shqiptarët e Ukrainës kanë themeluar një shoqatë, u nisëm për t'i kërkuar. As dinim saktë gjeografinë E Ukrainës, as fakte të tjera për shqiptarët që nuk kishim dëgjuar më herët që (ende) jetojnë në ato hapësira. "Kallauzi" që do të na shpinte atje, përveç shkrimtarit Thoma Kacori në Sofje, të cilit Seferi ia kishte vënë nofkën "Rilindasi i fundit", do të ishte Ramadan Çilku, për të cilin Seferi dhe Afeti do të kishin dëgjuar nga dibranët, ndonëse jetonte në Sankt Peterburg (Leningrad) dhe komunikimi me të në atë udhëtim do të jetë vetëm përmes telefonit. Vetëm kur u gjetëm në mesin e shqiptarëve të Ukrainës do të kuptojmë se ai ishte pjesë e kujtesës së tyre, sepse për një kohë të gjatë ai kishte qenë i vetmi shqiptar nga trojet etnike që i kishte vizituar rregullisht, se ai u kishte dërguar "n i s h a n e t" shqiptare (kostume...) për

Shuhet dibrani nga Sankt Peterburgu, Ramadan Çilku

Njeriu që bëri shqiptarët e Ukrainës të mos ndjehen të vetmuar!



t'ua përkujtuar pjesë të identitetit të tyre të harruar.

Me Ramadan Çilkun, më vonë, pasi u bënë emisionet televizive dhe libri, do të kemi rast të takohemi edhe në Sankt Peterburg, saherë që ishim ftuar për pjesëmarrje në konferencat shkencore që mbaheshin nga katedra e gjuhës shqipe (e themeluar nga koha e miqësisë shqiptare-sovjetike), prej nga kishin dalë dhe dalin shumë albanologë të njohur (Agnija Desnickaja, Irina Voronina, Gertruda Entrej, Sasha Rusakov, Aleksandar Novik (ky sivjet promovoi në Prishtinë një libër për shqiptarët e Ukrainës)...). Xha Ramadanin do ta vizitojmë edhe në shtëpinë e tij ku do të njihemi edhe me djalin e tij Edipin dhe të mbesën Janën, së cilës ia kishte futur dashurinë për kulturën shqiptare dhe ajo pastaj do ta studiojë albanologjinë.

Ramadan Çilku u lind më 1924 në familjen dibrane Çilku, e cila është në faretin e drejtpërdrejtë me patriotin Sait Najdeni (Hoxhë Voka). Gjatë Luftës së Dytë Botërore si i ri kishte punuar për disa firma italiane në Shqipëri, kurse më 1943 hyn në Batalionin e Dibrës, i cili kur u formua Brigada e njohur e Shtatë, do të shkojë në Frontin e Sremit. Pas çlirimit, si kuadër premtes, dërgohet në Bashkimin Sovjetik për t'u specializuar në lëmin e xhenios ushtarake, por për fat të keq të tij, s'vanoi shumë kohë dhe do të ndodhë konflikti në kuadër të Kominternit midis Titos dhe Stalinit dhe pas një hamendje a të kthehet (si të kthehet, si do të trajtohet...), apo të mbetet (si të mbetet, gjer kur do të zgjasë sherri midis udhëheqësve të dy vendeve), ai vendos të mbetet. Kur pas vdekjes së Stalinit qenë rregulluar marrëdhëniet midis dy vendeve, Ramadan Çilku tashmë kishte krijuar familje dhe vazhdoi jetën e tij atje, duke shërbyer gjer në vitin

Me gruan e tij, Anastasija Zinovjeva ishte njohur në qytetin Sahatov. Nuk thonë kot se jeta shkruan romane, sepse që të dytë ishin lindur të njëjtin vit, të njëjtin muaj dhe i vetmi dallim në moshë midis tyre është që ai është lindur më 4 e ajo më 5 janar. Ndoshta edhe ky dallim mund të mos ishte, sikur të mos jenë dallimet midis zonave kohore midis Ballkanit dhe Bashkimit Sovjetik, kështu që mund të kenë lindur të njëjtin ditë! Përkundër të gjitha tramvajeve jetësore, ky shqiptar nga Dibra dhe gruaja e tij ruse kishin bërë një jetë të lumtur gjer në fund të jetës. Gjurmëve të Ramadanit sot ecën e mbesa Jana që në Sankt Peterburg studioi gjuhën shqipe.

1971 si oficer armate. Për shkak se ishte në moshë relativisht të re për një pensionist, ai punësohet në një ndërmarrje ("Eelktrosilla") duke qenë përfaqësues për kontakte me firma nga ish-Jugosllavia. Pas bredhjeve të shumta nëpër vise të ndryshme të BRSS-së, në fund vendoset në Sankt Peterburg, ku e gjeti vdekjen këto ditë. Sa ishte i fortë më shëndet shpesh vinte në Dibrë të familjarët e tij, kurse ishte vizitues i rregullt edhe i shqiptarëve të Ukrainës. Me të kohë pas kohe do të dëgjoheja përmes telefonit, duke m'u drejtuar përherë me "hë be djale, ç'kemi të re nga ju", dhe herën e fundit kjo ndodhi para një viti, kur më tregonte se po përcillte përmes internetit këngë dhe valle shqiptare.

Në librin "Shqiptarët e Ukrainës" (autorë: Sefer

Musliu dhe Daut Dauti), sqaron se si u njoh me shqiptarët e Ukrainës: "Në vitin 1983 pata një mundësi që si turist në jug të Ukrainës dhe kisha marrë vesh se ka një fshat shqiptar midis Moldavisë dhe Ukrainës, ku pjesa dërmuese e banorëve janë shqiptarë, po ku ka edhe gagauzë, bullgarë, ukrainas etj. Takimi i parë me banorët e Karakurtit u përshkua me një habi të madhe. Kjo edhe nga shkakun se marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik nuk ishin gjithaq të mira dhe banorët na pritën disi me rezervë. Në vitin tjetër ishte hequr dhe më pritën përzemërsisht si shqiptar. Atëherë një plak i moshës reth 100 vjeç, më pat treguar se ka edhe disa fshatra të tjera afër Detit të



Ramadan Çilku me veshje

Azovit në Qarkun e Zaporozhjes dhe në Krime. Pastaj i vizitova edhe ato".

Kur në verë të vitit 1993 realizuam udhëtimin me kolegët Sfer Musliu e Afet Miftari, emri i Ramadan Çilku përmendej vazhdimisht, sepse praktikisht, pas një kohe shumë të gjatë, ai kishte qenë shqiptari i parë që i kishte vizituar dhe që ua kishte hequr mjegullën e vetmisë në ato hapësira të largëta. Me fillet e pluralizmit, po Ramadan Çilku i kishte nxitur që të formo- një një shoqatë me emrin "Rilindja" (sigurisht kumbari i saj do të kishte qenë vetë ai) gjurmë të së cilës kishin mbetur në formën e një fletushke që e gjetëm nëpër muzetë e fshatit Karakurt (fshati në rrethinë e qytetit Bollgrad). Bile, kur është bërë kërkesa për regjistrim të shoqatës, autoriteteve ukrainase u është kërkuar edhe mësimi i gjuhës shqipe gjer në klasë të katërt. (Kjo në një farë mënyre është bërë realitet viteve të fundit, prej kur janë angazhuar mësues t'i mësojnë gjuhën dhe alfabetin shqip). Sa herë që vinte në Dibrë, rrugës në të kthyer për në S. Petersburg e ndërpriste



Ramadan Çilku - Ushtar

për t'u ndalë te fshatrat shqiptare të Ukrainës, përherë duke dërguar në muzetë e tyre veshmbathje shqiptare, flamurë, libra, kasete... Kostumet kombëtare ia dhuroi ansamblit Lulja të Karakurtit dhe kur në vitin 1993 qëndruam si ekip gazetaresk, ky ansambël para kamerës doli i kompletuar me veshmbathje shqiptare.

Ndonëse me profesion oficer ushtarak, xha Ramadan Çilku patëm mundësi ta njohim edhe në një dritë tjetër, si piktor. Vetën e quante "piktor amator" por peizazhet që i patëm parë në ekspozitën që ndodhi në njërin nga vizitat tona (1994) në S. Petersburg, e përgënjë shoqatë me emrin "Rilindja" (sigurisht kumbari i saj do të kishte qenë vetë ai) gjurmë të së cilës kishin mbetur në formën e një fletushke që e gjetëm nëpër muzetë e fshatit Karakurt (fshati në rrethinë e qytetit Bollgrad). Bile, kur është bërë kërkesa për regjistrim të shoqatës, autoriteteve ukrainase u është kërkuar edhe mësimi i gjuhës shqipe gjer në klasë të katërt. (Kjo në një farë mënyre është bërë realitet viteve të fundit, prej kur janë angazhuar mësues t'i mësojnë gjuhën dhe alfabetin shqip). Sa herë që vinte në Dibrë, rrugës në të kthyer për në S. Petersburg e ndërpriste

"Meqë kam filluar të pikturoj vonë, llojet tjera të shprehur janë të vështira për mua, porse natyrën e reprodukoj më lehtë në pëlhurë. Por ka diçka tjetër të peizazhi, ai më përkujton vendlindjen, atje ku kam kaluar fëmijërinë dhe kështu disi çmalle duke kujtuar Dibranë time piktorese", ishte shprehur atëherë. Të vetmin përjashtim nga vokacioni i tij ishte kur kishte bërë dy portrete të Skënderbeut dhe i ekspozoi me rastin e një simpoziumi kushtuar kryetrimt shqiptar.

Të këtilla kanë qenë nuancat e jetës së këtij atdhetari të syrgjynosur, i cili, ndonëse erërat e historisë e hodhën në hapësira larg atdheut të vet, asnjëherë nuk e harroi identitetin kombëtar, për më tepër, u angazhua me vite dhe u ndihmoi shqiptarëve të harruar të Ukrainës që ta gjejnë veten.



San Petersburg: Çaste gëzimi nga martesja e mbesës së tijë - Yoana



Konstandini i Madh

Iliri më i shquar në histori

Me politikën e tij energjike ai arriti ta bashkonte një perandori të tronditur, paçka se në të vërtetë hendeku i thellë kulturor mes Lindjes dhe Perëndimit mbeti diçka e pashërueshme

Konstandini i Madh lindi më 27 shkurt të vitit 272, nga një familje fisnike ilire në Naissus të Dardanisë. I ati i tij Kostanti, ishte në kohën e Dioklecianit njëri prej dy Çezarëve, që mbretëronte në Galinë, Britaninë e madhe dhe Spanjën. Më 25 korrik të vitit 306 i vdes babai, Konstanti në Jork dhe Konstandini shpallet August (perandor) nga ushtria, e cila përbëhej kryesisht nga ilirë. Konstandini i Madh ishte perandori i parë i krishterë dhe themeluesi i Konstandinopojës. Vizioni i tij për Romën qytet të përjetshëm që mishërohej në Konstandinopojën jetoi për 1129 vjet. Është shpallur shenjt nga Kisha Katolike. Kisha e Lindjes e konsideron si shenjtorin më të madh.

Portret

Flav Valer Kostandini, mbiquajtur i Madhi, ishte një nga perandorët e famshëm të Romës, me origjin ilir. Përveçse si një perandor i madh, ai njihet si themelues i Konstandinopojës, kryeqendërës së perandorisë së mëvonshme të Bizantit, por mbi të gjitha ai njihet si perandori i parë i krishterë. Akti i konvertimit të Kostandinit nga pagan në të krishterë, përbën një akt historik jo vetëm pse shembulli i tij u ndoq nga një numër i madh nënshetësish të perandorisë, por dhe sepse me këtë rast, mbas tre shekujsh përndjekjeje në perandorinë romake, krishterimi nis të marrë frymë lirisht. Në epokën e sundimit të tij mori fund një herë e mirë persekutimi i të krishterëve. Ky perandor i madh ishte i biri i Kostant Klorit, që në kohën kur lindet Kostandini ishte një komandant i thjeshtë, dhe i Elenës (e cila më vonë u konsiderua shenjtore dhe përmendet si pelegrinia e parë në tokën e shenjtë të Jeruzalemit, prej ku dhe pati sjellë në Konstandinopoli Kryqin e Vërtetë). Konstandini e kaloi rininë në oborrin e perandorit Dioklecian, i cili edhe ai ishte ilir. Në vitin 305, falë sistemit të ri politik, tetrarkisë, vendosur nga Dioklecian, i cili pak vite më vonë do të abdikoje, babai i tij bëhet një nga perandorët, ndërsa Kostandini, i cili kishte treguar talent të



veçantë ushtarak në Lindje, shkon mbas të atit në Britani. Në vitin 306 i ati, Kostant Klori vdes dhe Konstandini proklamohet perandor falë mbështetjes së legjionarëve të Eburakumit, në Britani -pjesa më e madhe e të cilëve ishin gjermanë dhe keltë. Në njëzet vitet e ardhshme ai është i detyruar të luftojë kundër mëtuesve të tjerë për fron, që ishin Maksimiani, Masenci, Liçini, Galeri e Maksimilian Daia. Ai arrii të shpallet perandor vetëm në vitin 324.

Kur më 312 Galeri e Maksimiani vdesin, Konstandini ripushton Italinë, lidh aleancë me Liçinin-për më tepër duke i dhënë për grua të motrën nga babai, Kostancën-dhe i kundërvihet Masencit. Sipas legjendës, në prag të betejës së Saxa Rubra-s, Kostandini i shfaqet në ëndërr Jezusi, i cili i kërkon të shkruajë dy gërmat e para të emrit të tij, në greqisht XP, mbi shqytet e legjionarëve. Thuhet se në ditën që pasoi Konstandini pa diellin të shfaqej në formën e një kryqi, dhe në qiell pa të shkruara këto fjalë: "In hoc signo vinces" ("Me këtë shenjë ti do të fitosh"). Kjo ndodhi profetike shënoi fillimin e dilemës së tij për t'u konvertuar në të krishterë. Ditën e nesërme ai e dërrmoi Masencin në rrethinat e Romës dhe senati e njohu ligjërisht si fitimtar duke i dhënë titullin August. Kështu Konstandini hipi në fronin e perandorisë romake të Perëndimit, duke u vënë krahas Licinit, i cili tashmë qe proklamuar August dhe perandor i Lindjes qysh në vitin 308. Në vitin 313 Kostandini i Madh nënshkroi ediktin e Milanos, nëpërmjet të cilit ai i dha fund persekutimeve që i qenë bërë deri atëherë të krishterëve në perandorinë romake. Sapo Maksimilian Daia mposhtet nga rivali i tij Liçini, shumë shpejt antagonizmat me dy Augustëve, Kostandinit dhe

Liçinit shtohen, derisa shpërthen një luftë e vërtetë për pushtet. Të dy betejat që këta perandorë zhvilluan mes tyre, beteja e Adrianopolit dhe ajo e Krisopolit, përfunduan me fitoren e Kostandinit, i cili në vitin 324 bëhet i vetmi perandor për Lindjen dhe Perëndimin.

Totius orbis imperator (Perandor i vetëm)

Në vitin 293, perandori Dioklecian e kishte ndarë qeverisjen e perandorisë në katër pjesë, sistem ky që u quajt tetrarki, duke mbajtur për vete Lindjen dhe duke ua besuar pjesët e tjera Maksimianit, Galerit dhe Kostant Klorit, babait të Konstandinit. Sistemi i ri funksionoi deri në vitin 305, kohë kur Dioklecian abdikoje nga fronin, duke e detyruar edhe kolegjin e tij të bënte të njëjtën gjë. Galeri e Kostant Klori u emëruan Augustë gjatë një ekspedite në Britani, Kostant Klori vdiq më 26 qershor 306. Legjionarët e të atit shpallën August Konstandinin, por meqë ky gjest nuk u njohu zyrtarisht, ai u detyrua të qeveriste në atë vend të largët deri në vitin 311, kohë kur Galeri vdiq në Sirmio. Tashmë kishin mbetur tre persona që ndanin mes tyre pushtetin suprem: Liçini që sundonte Ilirinë, Trakinë e Provincat e Danubit, Maksimiani që kishte pjesën lindore të perandorisë, e Konstandini, por edhe Masenci, që edhe pse nuk ishte i veshur me pushtet zyrtar merrte pjesë aktivisht në luftën për pushtet.

Beteja e Saxa Rubra-s përfundoi në favor të Kostandinit, i cili bëhet zoti i plotfuqishëm i tërë Europës. Përpara se të nisej për në Romë, ai i dhuroi papa Melkiadit pallatin antik të familjes së Lateranëve dhe ndërtoi me shpenzimet e veta bazilikën e parë të Romës, Shën Gjoni i Lateranos. Në ditët e para

të janarit të vitit 313, Konstandini u largua nga Roma për t'u takuar me Liçinin. Dy perandorët përmes ediktit të Milanos shpallën: "NE, KOSTANDIN AUGUSTI, E NE, LIÇIN AUGUSTI, kemi vendosur të garantojmë respektimin e kultit hyjnor, t'u sigurojmë të krishterëve e gjithë të tjerëve që të ndjekin lirisht çdo formë besimi që t'u pëlqejë, me qëllim që çdo hyjni që banon në qiej të na ndihmojë ne e të gjithë ata që janë nën pushtetin tonë". Dy perandorët mbetën miq për një kohë të shkurtër, sepse më 314 mes tyre shpërtheu lufta, e cila do të zgjaste plot nëntë vjet, për të përfunduar në vitin 323 me betejën e famshme të Krisopolit (Uskudar) ku Liçini u kap i gjallë, u gjykua dhe u ekzekutua. Tashmë Konstandini ishte perandori i vetëm - Totius orbis imperator Gjatë luftës civile Konstandini u afrua përherë e më shumë me kristianët, duke i shtuar ligjet në dobi të tyre, por ai nuk i persekutoi asnjëherë as dhe paganët, duke i ndenjtur besnik ediktin të Milanos, të vitit 313.

Reformat e Kostandinit të Madh

Me politikën e tij energjike ai arriti ta bashkonte një perandori të tronditur, paçka se në të vërtetë hendeku i thellë kulturor mes Lindjes dhe Perëndimit mbeti diçka e pashërueshme. Përveç absolutizmit të padiskutueshëm shtetëror, Kostandini ua bën të qartë të gjithëve se personi i tij përfaqëson një gjykatës suprem pa kurrfarë mundësie apelimi në të gjitha çështjet: juridike, ushtarake, politike dhe ekonomike. Ai bëhet perandor edhe për çështjet religjioze, është zot dhe kryepriest, e në të njëjtën kohë perandor dhe papë. Konstandini i Madh bëri reforma shumë të rëndësishme administrative: ri-

organizoi ushtrinë dhe e shpalli veten komandant suprem, plotësoi edhe më ndarjen mes autoriteteve civile dhe atyre ushtarake, ide kjo e filluar nga paraardhësi i tij Dioklecian. Urdhëroi prerjen e monedhave të reja të arit, të cilat mbetën baza e këmbimit deri në rënien e perandorisë bizantine më 1453.

Roma e re në buzë të Bosforit

Kur perandori ilir i Romës, Konstandini, e pa për herë të parë Bizantin, qyteti kishte thuar një jemi-vjetë. Që në shekullin VII para Krishtit ekzistonte këtu një qytet i vogël, me akropolin në kodër, aty ku sot shtrihet Shën Sofia dhe Pallati i Sulltanëve. Në të vërtetë fillimisht Konstandini kishte në plan thjeshtë të ndërtonte një qytet, ku të përjetësonte emrin e tij, por pas vizitës së dytë në Romë, e pa se qyteti i vjetër, me tërë atë traditë republikane dhe pagane s'kishte se si të shndërrohet në zemrën e Perandorisë së re të krishterë. Prandaj në vitin 330 të erës sonë, në atmosferën e festimeve, që zgjatën katër ditë, Konstandini i Madh e transferoi rezidencën e tij perandorake në brigjet e Bosforit.

Konstandinopoja ishte e rrethuar me mure në pjesën e saj detare dhe një mur trefish në pjesën perëndimore. Për më shumë se një mijë vjet, muret e Kostandinopojës e shpëtuan Perandorinë prej humbjeve, madje edhe prej zhdukjes së plotë prej armiqëve të saj të shumtë. Në fakt, muret e Kostandinopojës mbrojnë më shumë se Perandorinë; ato mbrojnë qytetërimin romako-bizantin. Qyteti ishte bërë prej kohësh shprehje e dëshirës konstandiniane për ndërtimin e Perandorisë së Krishterë Romake, e cila duhet të ishte shteti i të gjithë të krishterëve të botës, në kufi-

jtë e mëparshëm të Perandorisë. Kisha dhe Shteti ishin bashkuar në një partneritet të pandashëm, që reflektonin rregullin hyjnor. Administruesi i këtij rregulli ishte Perandori Romak, zëvendës i zotit në tokë dhe "Apostulli i Trembëdhjetë i Krishtit", që sundonte si një autokrat i krishterë prej selisë së tij në Kostandinopojë. Konstandini e pati lënë punën e nisur në mes dhe ndër pasardhësit, Justiniani siguroi madhësitë konstandiniane. Ai shpenzoi gjithë periudhën e vet të sundimit për realizimin e madhësisë romake. Në vitin 332, i biri, Kostanci dërrmoi gotët. Ndërkohë mbreti i persisë, Shapur, ngriti pretendime për disa provinca të perandorisë. Kostandini u vu në krye të një ushtrie dhe marshoi kundër persianëve, por me të arritur pranë Nikomedisë, e kuptoi se çasti i tij i fundit kishte ardhur.

Mendime mbi Kostandinin

Ka mendime se Flav Valer Kostandini ka qenë perandori më largpamës i tërë historisë romake, përfshirë edhe atë të Lindjes. Qe një gjeneral i madh, një ushtar i madh. Ai e kuptoi se Krishterimi ishte tashmë një fe që mund të përdorej për qëllimet e veta; duke qeverisur mendjet e njerëzve ai mund të arrinte të kontrollonte drejtpërdrejt popullsinë e vet. Nuk ishte rastësi që ai i mbajti funksionet fetare në grushtin e vet. Ishte i pari perandor i krishterë, dhe i pari që ndërfuti doktrinën e re të quajtur Cezaropapizëm; e në të vërtetë ai e mbajti për sa ishte gjallë postin e kryepriest-papës. Ka qenë i pari perandor i Perandorisë Romake të Lindjes, që, duke ndërtuar një kryeqytet të ri në Bosfor, kryeqytet i cili mori emrin e tij, i dha rrugë krijimit të një perandorie të re që do jetonte shekuj të tërë, deri më 1453. John Julius Norwich thotë: "Konstandini I, perandori i Romës. Askush nuk e ka merituar titullin "i Madh", sa ky sovran që brenda pesëmbëdhjetë vitesh mori dy vendime epokale, secila e aftë për të ndryshuar historinë: përshtatja e kristianizmit si fe zyrtare e Perandorisë, dhe transferimi i kryeqytetit të Perandorisë nga Roma në një qytet të ri, ndërtuar mbi themelet e qytetit antik të Bizantit. Aq të rëndësishme qenë rrjedhojat e këtyre dy vendimeve sa Kostandini, -me përjashtim të Krishtit, Budës dhe profetit Muhamed-, mund të pretendojë në mënyrë të ligjshme që të konsiderohet njeriu më me ndikim në tërë historinë." (Tirana Observer)



"Jeto për ta treguar", libër autobiografik prej 530 faqesh, është vetëm vëllimi i parë i trilogjisë së planifikuar të nobelistit Gabriel Garcia Marquez, i cili vjen në shqip nga përkthimi i veçantë i Bashkim Shehut dhe në botim të shtëpisë "Onufri"

Bardh FRANGU

Vetë autori, përkatësisht autobiografi, në formë prologu e fillon librin me këtë tekst: "Jeta nuk është ajo që ke jetuar, është ajo që të kujtohet dhe ashtu siç të kujtohet për ta rrëfyer". Dhe në këtë vëllim Marquez rrëfen jetën e tij nga fëmijëria, përkatësisht nga vitet 30 e deri në vitet 60, për ta përmbyllur me njohjen e bashkëshortes së tij. Është ky një rrëfim që nuk përkon me klisjet e njohura të këtij lloj shkrimi, madje si i tillë edhe shtron shumë dilema, ndërsa prishë kufijtë mes tekstit autobiografik dhe tekstit të memoareve, madje mund të thuhet se është një kombinim i të gjitha këtyre.

Në këtë vëllim Marquez i kushton një hapësirë të gjerë nënës së tij, e cila, siç thotë ai, vdiq po të njëjtën ditë kur autori u kishte vënë pikë këtyre kujtimeve, përkatësisht më 9 qershor 2002, pak pa e mbushur një shekul jetë, ndërsa ajo kishte lindur në Barrankas më 25 korrik 2005. Dhe në këtë pjesë gjejmë një hapësirë të dukshme tekstore, e cila është e mbushur edhe me situata të një reflektimi gati infantil, por që gjithsesi për-



bënë shenjën më dalluese të përcaktimit të karakterit të autorit, përkatësisht talentit të tij të jashtëzakonshëm për të luajtur me fjalët dhe me situatat.

Në fakt, nga këtu ndërtojmë konstatimin se autori ka të drejtë kur dësh-

mon se: "Tek 'Ora e ligë', romani im i tretë, disa nga gjërat reale qenë më të mira se ato që trillova unë". Dhe vërtet i gjithë libri përbën një dëshmi të pakontestueshme se nuk ka më fantastik se realiteti. Në fund të fundit, letërsia

nuk është tjetër vetëm se zdrukthetari. Me të dyja ju keni punë me realitetin, me një material po aq të vështirë sa druri, do të shprehet në një rast Marquez. Mbështetur në këtë kufirin mes faktit dhe fiksonit. Zor është ta dallojmë se kur dhe ku fillon rrëfimi i faktuar dhe kur dhe ku ai i imagjinuar. Shembuj për këtë ka në gjithë librin, i cili si i tillë më shumë ngjet në një autobiografi të romanizuar.

Përtej imagjinare është përshkrimi i rastit të Xhek Zorrënxjerrësit, i cili ngatërron zemrën e kaut me zemrën e muratorit, sikundër dhe përshkrimi i marrëdhënieve me zonjën Neglomante dhe burrin e saj polic, për të cilin komshinjtë ankoreshin se ajo u prishte paqen të vdekurve me ulurima prej bushtrë të lumtur. Në një rast, për të shpërfaqur një situatë morbide, ai do të shprehet kështu: "E vetmja vështirësi për mua në kolegji ishin ca makthe kobzeza, të trashëguara nga nëna që vazhdonin në ëndrrat e të tjerëve me ulurima përtej varrit. Në makth që ndoshta mund të krahasohej me atë të nënës, e cila kishte në prehër kokën e vet dhe po e pastronte nga thënjat dhe

nga morrat që nuk e linin të flinte".

Në fakt kjo është vetëm një dëshmi për mjeshtrin e madh të prozës, një si shenjë karakterizuese për gjithë prozën e tij, të modelit të realizmit magjik. Dhe vërtet edhe në këtë libër dominon magjika, e pabesueshmja, e cila është pjesë organike e jetës së autorit në Kolumbinë e mbytur nga konfliktet, nga paragjykimet, nga besëtytnitë,,,

Marquez e pranon se ndikim të jashtëzakonshëm në formimin e tij si krijues kishin pasur përallat arabe "1001 net", të cilat veç sa kanë ndikuar t'i shoh dhe t'i njoh më mirë rrëfimet autoktone në ambientin ku është rritur. Sigurisht se dëshmitë e tij për pasionin ndaj leximit dhe përkushtimit për shkrimin janë të shumta dhe të mjaftueshme për të njohur udhën e tij drejt kulmeve të letërsisë, madje deri tek arritja e çmimit Nobel.

Ndoshta të gjitha marrëdhëniet shoqërore dhe politike të Kolumbisë së tij, Marquez do t'i përmbledhë nëpërmjet një mbishkrimi: "Në tramvaje dhe në shurrëtoret publike, kishte një mbishkrim të trishtueshëm: "Nëse nuk i druhen Perëndisë,

druaju sifilisit!" Në fakt për gjatë gjithë rrëfimeve të tij vërejmë se Marquez nuk i është frikuar asnjërës, as tjetrës, ndërsa jetën e harxhon në ngushëllim me seksin dhe në dëshpërim si komunist skeptik, ku pjesët më të bukura i ndërton nëpërmjet orës komuniste dhe njohjes me revolucionarin Fidel Kastro.

Karakteristikë e këtij libri është rrëfimi jolinear, përkatësisht kapërcimet e kohëve dhe shkrirja e tyre në mënyrën që të mos dallohet fakti nga fikcioni, përkatësisht që fakti të "fiksionalizohet", gjë kjo e cila shpesh na krijon përshtypjen sikur kemi të bëjmë me një intertekst. Në përgjithësi ky libër na shfaqet si një autobiografi e romanizuar që lexohet me kënaqësi, ndërsa në çdo faqe na e shpërfaq mjeshtrin e madh të narracionit.

Sigurisht që kapitull i veçantë i këtij libri në trajtim është puna e mrekullueshme që ka bërë në përkthim Bashkim Shehu. Në këtë kuptim ky libër duhet të na shërbej për model sesi duhet të përkthehet një libër. Bashkim Shehu është dëshmuar një liberal i madh në trajtimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe, madje një krijues i mrekullueshëm i neologjizmeve, duke e nxjerr kështu shqipën nga kornizat e ngulfatura të një standardi kurrë të rishikuar. Shprehjet si këto: Duke mëngjesuar, gjëmajat e larta kmbanojnë, gomaronjë, zogojnë, zymtare, etj, janë veç një dëshmi e vogël për shprehjet që përdorë autoi i përkthimit në këtë libër, e që në fakt ky libër meriton një vështrim të veçantë vetëm për këtë. (Zeri)

Pikturat e fundit mbi Shqipërinë nga Robert Elsie

Robert Elsie nuk është vetëm albanologu dhe studiuesi i letërsisë por dhe hulumtuesi, kërkuesi. Një meritë të veçantë kanë edhe zbulimet e tij në lidhje me Shqipërinë. Në faqen e tij në Facebook ai publikonte shpesh tablo me temë shqiptare. Ja disa

prej tyre që ai i ka publikuar kohët e fundit të jetës. Një pikturë me temë shqiptare nga Sër Dejvid Uillki. Në vitin 1840, Uillki udhëtoi në Egjipt ku kishte rast të takonte dhe të pikturonte sunduesin e vendit, Mehmet Ali Pasha, khedivin (nënmbretin) e

Egjiptit dhe të Sudanit. Mehmet Ali (1769-1849), djali i një tregtari çam të duhanit në Kavalla të Greqisë, u bashkua me një kontingjent mercenarësh shqiptarë të cilët u dërguan në Egjipt në vitin 1801, dhe mori pushtet aty. Piktura ruhet në galeri-

inë Tate Britain në Londër. Një tjetër pikturë është e piktorit skocez, Sër Dejvid Uillki (Sir David Wilkie, 1785-1841), me titullin "Zoti Kartrajt, Konsull në Kostandinopojë, me Shqiptarin e tij" dhe u realizua në tetor të vitit 1840. Në qarqet diplomatike

të Perandorisë Osmane, fjala 'shqiptar' kishte shpesh kuptimin 'dragoman, përkthyes, shërbëtor, roje.' Më pas ai publikon një tjetër pikturë me temë shqiptare nga piktori skocez Sër Dejvid Uillki. Quhet: "Sotiri, kryeshqiptari i Zotit Kolkhun, kon-

sulli i përgjithshëm britanik në Bukuresht" nga tetori i vitit 1840. Ruhet në Ashmolean Museum të Oksfordit. Më pas ai publikon një pikturë që e quan fantastike. "Zonjat e Gjirokastrës", fotografuar nga Gerhard Kiesling në vitin 1959.





Korçarët do të tentojnë deri në ndeshjen e fundit të renditen të dytët në grupin B për t'u kualifikuar në raundin tjetër, por për të realizuar këtë mision të vështirë, Skënderbeu duhet të fitojë me çdo kusht ndeshjen e kësaj të enjteje ndaj Partizanit të Beogradit, një sfidë shumë e ndërë kjo për të gjithë shqiptarët për vetë situatën politike që ekziston midis dy shteteve

Tri vjet pas duelit të "nxehtë" të ndërprerë të Beogradit, ku ishin përballur Serbia me Shqipërinë, shqiptarët dhe serbët do të vihen përballë njëri-tjetrit përsëri. Në fakt, të enjten mbrëma në "Elbasan Arena", Skënderbeu i Korçës do ta presë Partizanin e Beogradit në ndeshjen e vlefshme për fazën e grupeve të "Europa Leagues". Të dyja palët janë munduar t'i qetësojnë gjakrat, duke e vënë në plan të parë futbollin para nacionalizmit. Porosi të tillë ka dhënë edhe presidenti i Skënderbeut, Ardian Takaj. "Është vetëm një ndeshje futboll dhe si e tillë, natyrisht që nuk ka vend për nacionalizëm. Presim shumë njerëz në stadium, që do ta mbështesin ekipin dhe jam i bindur që do të zhvillohet një betejë e bukur, vetëm në aspek-



tin sportiv. Do të kërkojmë ta marrim fitoren e parë në këtë edicion të grupeve në Europa League", deklaroi presidenti i Skënderbeut. Ndaj Partizanit të Beogradit, Skënderbeu do të synojë tre pikët për t'u treguar të gjithëve se tashmë nuk është vetëm një skuadër që mjaftohet me pjesëmarrjen në grupet e Liga Evropë. Korçarët do të tentojnë deri në ndeshjen e fundit të renditen të dytët në grupin B për t'u

kualifikuar në raundin tjetër, por për të realizuar këtë mision të vështirë, Skënderbeu duhet të fitojë me çdo kusht ndeshjen e kësaj të enjteje ndaj Partizanit të Beogradit, një sfidë shumë e ndërë kjo për të gjithë shqiptarët për vetë situatën politike që ekziston midis dy shteteve. Trajneri Ilir Daja u ka kërkuar lojtarëve të tij shpejtësi në pasime dhe presing kur topin ta kenë kundërshtarët. Derisa, pa dy emra të rëndësishëm si

Liga Evropa

Skënderbeu ndaj Partizanit synon fitoren e parë

PA TIFOZË SERBË

Përmes një pakti mes klubit korçar, UEFA-s dhe Partizanit, është vendosur që në të dyja sfidat, si në Shqipëri, ashtu edhe në Serbi, të mos ketë tifozë udhëtues, në përballjet në mes Skënderbeut dhe Partizanit. Presidenti Takaj, në një intervistë, ka deklaruar se vendimi është marrë për ta shmangur çdo incident të mundshëm. Të pranishëm do të jenë vetëm delegacionet me 50 persona që zgjidhen nga klubet respektive.

Gavazaj dhe Nimaga të cilët janë të dëmtuar, korçarët gjithsesi do të zbresin në fushë me një formacion sulmues. Në skemën 4-3-3 të Ilir Dajës e cila gjatë lojës mund të kthehet edhe në 4-2-3-1 për shkak të cilësive që zotërojnë futbollistët e Skënderbeut do të luajnë këta lojtarë.

Derisa, futbollisti i Partizanit, Zoran Toshic thotë se serbët nuk kanë frikë nga Skënderbeu, në duelin e së enjtes. "Premtojmë se skuadra do të fokusohet vetëm tek loja dhe tek asgjë tjetër, duke shpresuar që kjo lojë të mos degjenerojë dhe të

dalë nga kontrolli. Jemi të vetëdijshëm për atmosferën që na pret në Elbasan, por jemi të bindur që Partizani do ta fitojë ndeshjen", deklaroi Toshic. UEFA do të dërgojë dy oficerë sigurie për këtë sfidë, pasi e konsideron një ndeshje me rrezikshmëri të lartë. Ndryshe, Policia e Shtetit në Shqipëri i ka marrë masat e duhura që të enjten çdo gjë të shkojë siç duhet, e të mos ketë incidente. Për tifozët do të kryhet një kontroll i rreptë Gjithashtu, do të kontrollohen edhe banderolat e tifo-grupeve, që të shmangët çdo mesazh politik apo racor.



Ish-trajneri i Udineses aplikon për ta drejtuar Kosovën

Rodolfo Vanoli dhe do të dëshironte të drejtonte Përfaqësuesen e Kosovës në futboll. Tekniku italian të martën ka konfirmuar për gazetën se ka aplikuar në Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK) për postin e seleksionuesit, i lënë bosh pas largimit të Albert Bunjakit, por nuk ka dashur të flasë më shumë rreth kësaj pune me arsyetimin se nuk ka diçka konkrete. Por, ajo që 54-vjeçari ka thënë është se do t'i pëlqente një përvojë në krye të përfaqësueses që sapo mbylli ciklin e parë eliminator. Nën drejtimin e Bunjakit, Kosova përfundoi e fundit në grupin e saj eliminator për Botërorin "Rusia 2018" me një barazim e nëntë humbje. "Për momentin nuk kam dëshirë të flas shumë për këtë, por them se do të isha shumë i lumtur nëse do të vija në Kosovë", është shprehur Vanoli.



Nga Greqia për t'i zënë vendin një greku. E tillë është situata e trajnerit

Nga Greqia për t'i zënë vendin një greku

Hasi drejt bankinës së skuadrës belge

Besnik Hasi. Mediat belge kanë bërë me dije se trajneri shqiptar është një nga alternativat kryesore për të marrë drejtimin e skuadrës së Kortriikut. Pas dhjetë javësh në "Julpier ligë", Kortriikut renditet në vendin e trem-

bëdhjetë me nëntë pikë. Deri më tani, numëron vetëm dy fitore, tri barazime dhe pesë humbje. Edhe golavarazhi nuk është aspak favorizues, pasi numëron 11 gola të realizuar dhe 17 të pësuar. Në javën e fundit,

ishte Standart Liezh që fitoi 3-1 përballë këtij ekipi, ndaj edhe pozitën e trajnerit grek Janis Anastasiu janë lëkundur ndjeshëm. Sipas mediave belge, emri i Besnik Hasi lakohet gjithnjë e më shumë për të çuar më tej

projektin e klubit për këtë edicion. Hasi u shkarkua nga Olimpiakos, ndërkohë që edhe vetë trajneri grek e nisi me humbje në Greqi, si dhe në Ligën e Kampionëve, ku u mund nga Juventusit me rezultatin 2-0.

Kameraj i gatshëm të luajë për Kosovën

Mbrojtësi kosovar i skuadrës së juniorëve të Juventusit, Qëndrim Kameraj, është i gatshëm ta lërë përfaqësuesen U-19 të Zvicrës për ekipin Shpresa (U21) të Kosovës. Kështu ka deklaruar vetë futbollisti kosovar i lindur në Zvicër. Ai ka theksuar se është i interesuar që të japë kontribut për ekipin e Kosovës. "Jam i interesuar të luaj për U-21 të Kosovës. E di që ka pasur interesim edhe nga ana e tyre, por mendoj se ka ardhur koha që të japë edhe unë kontributin tim për Kosovën", ka thënë Kameraj për Koha Ditore. Kameraj është transferuar në Juventus gjatë kësaj vere nga skuadra zvicerane, Luzern. Interesim për lojtarin ka shfaqur edhe trajneri i U-21 të Kosovës, Rafet Prekazi



Publicitet

"Liria" për herë të tretë shpallet Kampione e Maqedonisë

Me gjithsej 289 pikë, klubi shqiptar bindshëm u shpall më i miri, derisa pas tyre u rendit KM "Ballkanec" nga Shtipi me 201 pikë



Shkup, 18 tetor - Mundja në Maqedoni ka vetëm një emër dhe ajo është KM Liria. Klubi më i suksesshëm shqiptar për herë të tretë me radhë arriti të shpallet kampione e Maqedonisë në të gjitha grupmoshat. Me gjithsej 289 pikë, klubi shqiptar bindshëm u shpall më i miri, derisa pas tyre u rendit KM "Ballkanec" nga Shtipi me 201 pikë, ndërsa në vendin e tretë u ndal KM Tefezuz me 157 pikë. "Si nënkryetar i KM Liria jam i kënaqur që arritëm të mbrojmë titullin e kampionit, të tretin me radhë.

Uroj gjithë mundësit, trajnerët dhe gjithë ata që kontribuan në arritjen e këtij suksesi por para se gjithash ish-kryetarin e klubit Betim Vrenezi, i cili ka merita të posaçme për këtë sukses", deklaroi për gazetën Koha, nënkryetari i KM Liria, Amet Ademi. Ndërkohë, në Kampionatin e pionierëve që u mbajt në hapësirat e KM Liria, Kampion u shpall KM "Ballkanec", me 30 pikë, Liria ishte e dyta me 25 pikë,

ndërsa Tefezuzi me 21 pikë u ndal në pozitën e tretë. Në fund, Kupat për Kampionin e përgjithshëm dhe Kampionatin e pionierëve i dhanë kandidati për kryetar i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, këshilltari i ri në Qytetin e Shkupit, Besnik Ajeti, kryetari i Federatës së Mundjes së Maqedonisë, Betim Vrenezi, nënkryetari Dejan Bogdanov dhe drejtori i Federatës, Strasho Gligorov. (B.K)

Në bazë të nenit 135 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; nr. 103/2008; nr. 26/2009; nr. 83/2009 dhe nr. 99/2009; nr. 115/2010, nr. 17/2011, nr. 51/2011, nr. 123/2012, nr. 15/2013, nr. 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015 dhe 30/2016), Dekani i Fakultetit Filozofik në Shkup, publikon

KONKURS për zgjedhje të:

1. Një mësimpldhënës (në të gjitha titujt mësimplor-shkencor) në sferat shkencore (disiplinat): **pedagogji, metodik, didaktik.**

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimplor-shkencor, shkencor, mësimplor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: fletëparaqitje për pjesëmarrje në konkurs, biografi të shkurtër, dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Orari i punës së mësimpldhënës është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015; 30/2016; 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit të shkencave informatike dhe inxhinieri kompjuterike në Shkup, publikon

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor, në të gjitha sferat mësimore-shkencore nga fushat mësimore – shkencore:

- *Informatika;*
- *Teknika kompjuterike dhe informatika*

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Institutit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike në Shkup (FSHIK), rr. Rugjer Boshkoviç nr. 16, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe neni 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të dekanit të Fakultetit për arte figurativ në Shkup, shpall:

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor, në sferën e artit figurativ, në sferat mësimore - shkencore:

- *pikturim dhe teknikat e pikturimit, për lëndën vizatim dhe pikturim.*

Kushte: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet dhe kriteret të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e tjera të Universitetit.

Me lutjen kandidatët duhet ti dorëzojnë: biografi të shkurtër, dëshmi për plotësimin të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës i mësimdhënësit është caktuar në përputhje me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet të dorëzohen në Fakultetin për arte figurativ në Shkup, rr. Bitpazarska p.n., 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe neni 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të drejtorit të Institutit ekonomik në Shkup, shpall:

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat mësimore - shkencore:

- *ekonomia e agrarit dhe pylltaria.*

Kushte: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet dhe kriteret të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e tjera të Universitetit.

Me lutjen kandidatët duhet ti dorëzojnë: biografi të shkurtër, dëshmi për plotësimin të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës i mësimdhënësit është caktuar në përputhje me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet të dorëzohen në Institutin ekonomik në Shkup, rr. Prolet nr.1, F.Postal 250, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup



KRYETAR I KOMUNËS

Nr. _____ prej _____ .

Komuna e Čairit në bazë të nenit 84 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gz. Zyrtare e RM" nr. 124/15), bën dorëzimin me

SHPALLJE PUBLIKE

Me Aktvendim nr. 08-7300 nga data 27.02.2017 është asgjësuar Aktvendimi për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm me nr. 08-7300 i datës 10.12.2014 dhe i njëjti në pajtim me nenin 21 paragrafi 3 dhe neni 21-b nga ligji për trajtimin e objekteve të paligjshme nuk ka fuqi juridike.

Nga dita kur kjo shpallje bëhet publike, fillon të numërohen 15 ditët e afatit për ankesë kundër Aktvendimit me nr. 08-7300 të datës 27.02.2017.

Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e prolongon përmbartimin e tij.

Paralajmërohet pala se dorëzimi i shpalljes publike llogaritet për e rregullt dhe se pasojat negative të cilat mund të ndodhin do të bartë vetë pala.

Kryetar i Komunës
Izet Mexhiti

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesën për dhënie e Lejes për zënie dhe shfrytëzimin e ujit nga lumi Gradeshkë për prodhimin e energjisë elektrike për HCV Gradeshnica me nr. ref.227.

Ne pajtim me nenin 30 paragrafin 1 të Ligjit për Ujëra ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar Kërkesa për zënie dhe shfrytëzimin e ujit nga lumi Gradeshkë për prodhimin e energjisë elektrike për HCV Gradeshnica me nr. ref.227, Pellgu i lumit Vardar, komuna e Novacit.

Parashtrues i kërkesës :

Megavat SHPK Shkup

Bul .Serbia nr.13A

1000 Shkup

Koordinata për përfshirjen e lumit Gradeshkë prej ku zihet uji për prodhimin e energjisë elektrike dhe të ndërtesës maqinerike sipas sistemit shtetëror të koordinatave

- Lokacioni i kaptazhit nga lumi Gradeshnicë i PK 3491, PK 3492, PK 3493, PK 3869/2 KK Gradeshnicë (953.87 m.l.m) është me koordinata në vijime:

Y=7569234; X=4547823;

- Lokacioni i ndërtesës maqinerike i HCV "Gradeshnica" me nr. ref. 227 KK 2547/2, KR 3869/2 KK Gradeshnicë është me koordinata në vijim:

Y=7565065; X=4549172;

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ne e-mail d.naumoska@moepp.gov.mk

Opinion i përfshirë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të parashtrorë mendime dhe vërejtje me shkrim deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

Ministër,
Sadulla Duraki

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 e Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), dekani i Fakultetit juridik "Justinian Prvi" në Shkup pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

- Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore e drejta administrative dhe administrata publike për kohë prej 5 /pesë/ vjet _____ /1/

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara në Ligjin për arsim sipëror, Statutin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e përgjithshme të Fakultetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorë: dëshmi, gjegjësisht vendim dhe/ose diplomë për shkallën e arritur përkatëse të arsimit – doktor i shkencave, deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës, certifikatë të shtetësisë, biografi të shkurtër /CV/, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të punimeve.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është përcaktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin juridik "Justinian Prvi" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9b – Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

Informatat plotësuese në tel. 02/3117-244

Fakulteti juridik "Justinian Prvi" në Shkup

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor të Republikës së Maqedonisë

SHPALLJE

Projekt B - Leje e integruar ekologjike

Në përputhje me nenin 96 paragrafi 1 të Ligjit mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar kërkesë nr. 11-6841/1 nga 16.10. 2017 për marrjen e B- Lejes së integruar ekologjike.

Dorëzues i kërkesës:

JOKI KOMERC

Adresa:

Rr. Dubrava p.n fsh. Brvenicë 1216,

Tetovë

Kategoria e instalacionit:

6.6. Instalacione për shpeztari intensive pulari ose derrari me më tepër se :

- a). Nga 5000 deri më 40.000 vende për shpeze.

Kapaciteti i projektuar:

12 000 pula për vezë.

Lloji i aktivitetit:

Ruajtja e pulave për vezë.

Drejtoria e Mjedisit Jetësor pranë MMJPH përgatiti

Projekt B – Leje të integruar ekologjike

për Fermën e shpezeve Joki Komerc

Projekt Leja do të jetë e shpallur , në Web faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moepp.gov.mk

Informacione në lidhje me Projekt B – Leje të integruar ekologjike, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në tel: 076455073 (e-mail i.nikoloska@moepp.gov.mk)

Të interesuarit, në afat prej 14 ditëve nga dita e shpalljes në mjetet e informimit, do të mundet ti dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në këtë adresë: Bulevardi " Goce Dellçev" nr.18 (ndërtesa e MTV kati 10), 1000 Shkup.

Bëhet përcjellja e firmës TI NORMA PLUS TP Nermina Nazim Mustafi-Murati, Tetovë



13 gola të pësuar në 8 javë

Alarm i kuq për mbrojtjen e Milanit

Është e qartë që alarmi mbrojtje është ndezur në shtëpinë e Milanit, dhe duhet menjëherë të gjendet një zgjidhje në mënyrë që të mos avullojë objektivi i sezonit, kualifikimi në Çampions

Pas tre firmave të Interit në derbin e "Madonninas", shkon në 13 numri i golave të pësuar nga Milani në tetw javët e para të kampionatit. Një fakt shqetësues për skuadrën e Vincenzo Montellas, që fut ujë në fazën e mbrojtjes dhe jep sinjale se rrezikon të mbyllë një sezon të dështuar, ndryshe nga ç'pritej. Ndryshe, nën akuzë është kapiteni Leonardo Bonuçi, blerja e madhe e verës e shoqërisë kuqezi, rendimenti i të cilit deri tani është nën pritshmëritë. Bonuçi i bashkohet edhe paraqitjet negative të Musacios dhe Romanolit, ndërsa Zapatas i ka munguar vjueshmëria. Por, diskutimi zgjerohet në mesfushë, e cila nuk bën



filtrimin e duhur për prapavijën. Si rezultat shpesh mbrojtësit kuqezi gjenden një kundër një me sulmuesit kundërshtarë. Edhe ndryshimi i modulit të lojës, duke kaluar nga mbrojtja me katër në atë me tre lojtarë, duket se e ka theksuar problemin në vend që t'i japë zgjidhje. Në mbrojtjen me katër, golat e pësuar ishin pesw në katër javët e para, katër prej të cilëve në transfer-

tën shumë negative të Romës me Lacion. Është pikërisht ndryshimi taktik i dëshiruar nga Montella, që nuk ka dhënë fryte. Në pesw ndeshjet e tjera të kampionatit Milani ka pësuar tetw gola, dhe vetëm kundër SPAL në "San Siro" Donnarumma ka mundur ta mbajë të paprekur portën e tij. Në tre ndeshjet e fundit kuqezinjtë kanë pësuar shtatw gola, nntw në katër ndeshje duke

konsideruar edhe të fundit në Liga Evropw. Numra shqetësues, nëse merret parasysh se në 20 vitet e fundit vetëm Milani i Mihajloviç-t i sezonit 2015-2016 kishte pësuar më shumë gola në tetw javët e para të Serie A. Pas afrimit të Kristian Brokit në stol, skuadra në fund të sezonit e mbylli në vendin e shtatw. Të njëjtin numër golash kuqezinjtë kanë regjistruar edhe në 2013-2014, kur drejtoreshin nga Allegri. Më pas, "Djali" që ndryshoi drejtimin në janar duke marrë Sidorfin, e mbylli kampionatin në vendin e tetw.

Duke analizuar sezonet më të mira të mijëvjeçarit të ri, nga 2002-2003 dhe deri në 2010-2011, golat e pësuar nga mbrojtja kuqezi nuk ka qenë kurrë një numër dyshifror në tetw javët e para. Pra është e qartë që alarmi mbrojtje është ndezur në shtëpinë e Milanit, dhe duhet menjëherë të gjendet një zgjidhje në mënyrë që të mos avullojë objektivi i sezonit, kualifikimi në Çampions.



Siti parashikohet ti ofron dyfishimin e pagës De Brynes

Menaxheri i Kevin De Bryne konfirmoi se do të çelë bisedimet në lidhje me një kontratë të re të futbollistit të menaxhuar prej tij, me drejtuesit e klubit të Manchester Siti. Ndërkohë, këtë javë trajneri i Manchester Silit, Pep Guardiola e etiketoi yllin e Silit si futbollist më të mirë në Evropë, ndaj dhe 26-vjeçari me të drejtë mund të pretendojë për një shpërbllim më të majmë se ai aktual që vërtitet në 115,000 euro në javë. Në një deklaratë për radion italiane "Radio Crc", menaxheri i De Bryne, Patrik De Koster tha se "Në muajt e ardhshëm do të takohet me drejtuesit e Silit për të diskutuar mbi përmirësimin e kontratës dhe rinovimin e saj". "Rroga e tij? Nuk mund të them. Por nëse mendon për shumën që merr Neymar dhe Kylian Mbappe, atëherë mund ta imagjoni vetë", deklaroi menaxheri i De Bryne. Ylli i Paris Sen-Zhermenit, fiton rreth 600,000 euro në javë, ndërsa shoku i tij i skuadrës, Mbappe vlerësohet se paguhet rreth 320,000 euro në javë. "Sports-mail" zbuloi muajin e kaluar se Siti synon të shpërblejë performancën e De Bryne me një rritje të konsiderueshme të pagesës. Parashikohet që De Bryne të përfitojë një dyfishim të pagesës së tij prej 6 milionë euro në vit, ndonëse menaxheri i tij mund të pretendojë edhe më shumë se aq. Ish-futbollisti i Çellsit ka ende 4 vite kontratë me Manchester Sitin, ku u transferua në vitin 2015 nga Wolfsburg për shumë 52 milionë euro.

Kaka rikthehet te Milani?

Nigel De Jong ka dhënë shenja se Rikardo Kaka mund të bëjë rikthim senzacional në 'San Siro'. Premier Sport ka thënë të mërkurën se braziliani ka kërkuar që të rikthehet te Milani për gjashtë muaj si lojtarë, para se të marrë një rol ekzekutiv në skuadër. Këto spekulime janë rritur edhe më shumë kur ish-bashkëlojtari i Kaka-së në 'San Siro', De Jong ka lënë një koment në një postim të 35 vjeçarit në rrjetin social "Instagram", ku i ka uruar atij suksese në të ardhmen,



duke e bashkangjitur në mesazh edhe dy simbole 'kuq e zi', të cilat janë ngjyrat që e

përfaqësojnë Milanin. Sipas mediave italiane, nëse ai nuk transferohet te ekipi italian, atëherë ai mund të kalojë te ekipi i fëmijërisë, Sao Paulo, ose të pensionohet. Kaka ishte pjesë e 'Rosonerëve' gjatë viteve 2003-2009, ku kishte fituar titullin e Seriës A, Ligën e Kampionëve dhe Topin e Artë. Pas kësaj ai u transferua në Real Madrid ku luajti për katër sezona, për tu rikthyer përsëri në 'San Siro' në sezonin 2013/14, prej ku u largua në MLS, te Orlando.


Milani planifikon kthimin e Alegrit

Milani është duke i shqyrtuar mundësitë për kthimin e strategut italian, Massimiliano Allegri. Trajneri aktual i Juventusit në vitin 2011 e fitoi "Scudetton" me Rosonerët, skuadër që e kishte drejtuar gjatë viteve 2010-2014. Në vitin 2014, ai mori drejtimin e Zonjës së Vjetër dhe e ka fituar tri herë radhazi titullin dhe dy herë Kupën e Italisë. "La Repubblica" raporton se drejtorët e Milanit, Massimiliano Mirabelli dhe MarKo Fassone, mendojnë që ta ndërrojnë trajnerin në sezonin e ardhshëm dhe objektivi kryesor është

Alegri. Vincenzo Montella është nën presion të madh këtë sezon për shkak të rezultateve jo të kënaqshme nga Rosonerët. Karlo Anceloti dhe Antonio Conte janë emrat tjerë që janë përmendur në të kaluarën si zëvendësues eventuale të Montellas. Allegri ka nënshkruar me Juven deri në vitin 2020 dhe shefat e Milanit do ta kenë të vështirë ta bindin që të kthehet në "San Siro". Për më shumë, te Rosonerët ai do ta gjente Leonardo Bonuçin, me të cilin i ka prishur raportet në fund të sezonit të kaluar.



Belotti në fushë ndaj Interit



Përmirësohet ndjeshëm gjëndja e Andrea Belottit. Sulmuesi i Torinos i cili për mo-

mentin është i dëmtuar po rikuperohet shumë shpejt dhe me shumë gjasa do të jetë në

fushë për përballjen e dyfishtë të Italisë me Suedinë në Play-off, duel në të cilin është në lojë bileta e Botërorit Rusi 2018. Sipas parashikimeve të mjekëve Belotti i cili mungoi në dy sfidat e fundit të përfaqësues së kaltër, do të jetë në fushë në datën 5 nëntor në ndeshjen që Torino do të zhvillojë ndaj Interit në San Siro dhe në këtë mënyrë do të jetë plotësisht i gatshëm për sfidën e parë Play-off ndaj Suedisë që do të luhet në 10 nëntor.

Shkurt

Njukasëll me pronarë turq?

Njukasëll pritet të ketë së shpejti pronarë e rinj. Miliarderi turk, Murat Ulker, i cili zotëron firmën e famshme të Biskotave "McVitie's", është i gatshëm të paguajë 220 milionë sterlina për të blerë klubin anglez nga Majk Ashlej, i cili para pak kohësh nxori në shitje Njukasëll Junajted. Për momentin 58-vjeçari është i vetmi kandidat që ka shprehur hapur interesin për të blerë Njukasëllin.

Real në kërkim të një mbrojtësi

Real i Madridit do të ndërhyjë në merkato për të gjetur një mbrojtës. Jesus Vallejo nuk po bind as trajnerin Zinedin Zidan dhe as drejtuesit madrilenë. Për këtë motiv, mbrojtësi 20-vjeçar, i rritur te ekipi i të rinjve të Real Saragoza, nuk ka debutuar ende me fanellën "Los Blancos". "Galaktikët" po mendojnë të afrojnë një lojtar me eksperiencë, dhe do të jenë aktiv që në sesionin dimëror të merkatos.

Llorente mendon rikthimin në Itali

Në të ardhmen, Fernando Llorenten mund ta shohim sërisht të veshë fanellën e një skuadre italiane. Në një intervistë të dhënë, sulmuesi i Tottenhamit nuk i mbylli dyert për një rikthim në Serinë A. Spanjollit i cili ka luajtur me Juventusin, deklaroi se në Itali ka qenë shumë i lumtur dhe ka ende miqësi me shumë lojtarë atje. Llorente theksoi se në të ardhmen nuk i dihet asnjëherë, por për momentin është i lumtur me futbollin anglez.

Kaljari zgjedh Diego Lopezin

Pritej njëri mes Massimo Oddos dhe Xhuzeppe Iakinin por Kaljari do të drejtohet nga Diego Lopez. Presidenti i klubit sard Giulini pas shkarkimit të Massimo Rastellit ka vendosur t'ia besojë skuadrën uruguaiant Diego Lopez duke surprizuar në një farë mënyre. Trajneri amerikano-jugor ka firmosur me Kaljarin deri në fund të këtij sezoni dhe do të ketë si objektivi kryesor të shpëtojë skuadrën nga Sardegnia nga rënia në Serie B. Për Diego Lopez bëhet fjalë për një rikthim pasi ai e ka drejtuar edhe në të kaluarën Kaljarin.

Hungaria mbetet pa trajner

Përfundimi i eliminatorëve të botërorit 'Rusi 2018', ka sjellë edhe shkarkimin e disa trajnerëve në kombëtaret që nuk arritën objektivin e kualifikimit. Më e fundit është Hungaria, që ka vendosur të ndërpresë marrëdhënien e bashkëpunimit me trajnerin 54 vjeçar, Berndt Shtork. Lajmi u bë i ditur nga vetë Federata Hungareze e Futbollit, nëpërmjet një komunikate, ku thekson se shkaku i ndërprerjes së bashkëpunimit është mos-arritja e kualifikimit në botëror. Hungaria ishte në grup me Portugalinë dhe Zvicrën, ndërsa zyrtarisht e humbi betejën për kualifikim që në takimet e muajit shtator, ndërsa e mbyllën edicionin në vendin e tretë, me 13 pikë.



Më duket mua, apo Benzema është një i mbivlerësuar? Një gol ka shumë ndeshje, në një skuadër aq të fortë, si Real Madridi, nuk është asgjë e veçantë. Jo mirë

Spektakël dhe plot 31 gola dhuruan ndeshjet e së martës në fazën e grupeve të Ligës së kampionëve, ndërsa nuk munguan as rezultatet surprizë

Liga e kampionëve

Siti fiton betejën e “futbollit të bukur” ndaj Napolit

Manchester Siti ka fituar duelin e dy skuadrave që, sipas shumë kritikëve, aktualisht luajnë futbollin më të mirë në Evropë duke mundur 2-1 Napolin. Të besuarit e Guardiolas treguan edhe njëherë super formën që po kalojnë dhe arritën të triumfonin falë dy golave të shënuar brenda çerek orëve të para të ndeshjes. Skuadra e Sarrit u mundua të rikthehej por mbase penalltia e humbur mund të kishte ndryshuar gjërat. Ndryshe, trajneri i Manchester Sinit, Pep Guardiola, ka bërë këtë analizë dhe vlerësim të ndeshjes së të tijve, të luajtur në martën ndaj Napolit, në Ligën e Kampionëve. “Unë nuk pres që të kontrolloj 90 minuta lojë, aq më tepër ndaj Napolit, që ka një ekip të jashtëzakonshëm. Në pjesën e parë ishim shumë mirë, shënuam dy gola, mund të shënonim edhe të tretin e të katërtin. Pastaj nuk mundëm t'i përfundonim kundërsulmet tona. Napolit ka një aftësi të madhe për të luajtur sh-



RONALDO, SHËNUESI MË I MIRË NË HISTORI TË ÇAMPIONS

Vazhdon shkëlqimi i Kristiano Ronaldos në Ligën e Kampionëve edhe pse kësaj radhe shënoi nga pika e bardhë. Ky ishte goli i 15-të në tetë ndeshjet e fundit në këtë garë. Në këtë sezon, Ronaldo ka shënuar pesë herë, aq sa ka shënuar edhe sulmuesi i Tottenham, Harri Kin. Nëntë nga 15 golat e fundit ai i ka shënuar para tifozëve të tij në “Santiago Bernabeu”. Kjo penallti nuk ishte rasti i tij i parë në ndeshje, pasi që kishte gjuajtur disa herë në portë. Ai goditi edhe shtyllën pas harkimit të Afraf Hakimit. Ronaldo mbetet shënuesi më i mirë në histori të Ligës së Kampionëve me 110 gola.

pejt dhe thjeshtë, me një ose dy prekje. Askush nuk e humb topin dhe askush nuk i jep tri prekje. Kjo

është arsyeja pse ka qenë shumë e komplikuar ndaj Napolit. Është një nga ekipet më të mira, me të cilin jam përballur si profesionist”, deklaroi Pep. Supersfida tjetër e mbrëmjes, ajo mes Realit

të Madridit dhe Tottenhamit, përfundoi në barazim 1-1, ndërsa gjithçka u zhvillua në pjesën e parë. Tottenhami kaloi i pari në avantazh, pas një autogoli të mbrojtësit francez Varane, ndërsa Ronaldo barazoi në minutën e 41-të me 11 metërsh. Zinedin Zidane kaloi nga salla e shtypit në “Bernabeu” i mërziur me barazimin, por duke menduar për ndeshjen e “Embley”. “Si gjithmonë, ne nuk mund të jemi të lumtur, sepse në shtëpi gjithmonë duam të fitojmë. Ne kemi pasur shanse, por duhet të pranohet se Tottenhami ka një portier mjaft të mirë. Unë nuk jam i shqetësuar, më shumë i bezdisur, sidomos për lojtarët, sepse luftojnë në fushë. E vetmja gjë është që ne të vazhdojmë përpara”, u shpreh Zidane. “Është edhe një ndeshje atje (kthimi në Londër) dhe do të përpiqemi të marrim tri pikët. Në

Londër do të jetë si një finale. Atje është fusha e Tottenhamit, që nga ana e tij do të përpiqet për ta fituar ndeshjen. Ne duhet të insistojmë se nuk jemi duke bërë keq kohët e fundit. Përkundrazi, jemi duke bërë mirë, jemi lider në Ligën e Kampionëve, por mund të bëjmë më mirë, natyrisht”, përfundoi trajneri i Realit.

Monako u befusua në shtëpi, nga turqit e Beshiktash, të cilët fituan 1-2 dhe blinduan kryesimin e grupit, me 9 pikë të plota, ndërsa francezët kanë komplikuar kualifikimin, sepse kanë vetëm 1 pikë dhe mbyllin renditjen. Edhe Borussia e Dortmundit nuk shkoj më shumë se nja barazim 1-1, në transfertën qipriote ndaj Apoel. Vendasit kaluan të parët në avantazh, në fillim të pjesës së dytë, por gjermanët barazuan në minutën e 73-të me anë të Sokratis. Liverpooli mori një fitore të lehtë, në transfertën ndaj Mariborit të Valon Ahmedit. “The reds” shënuan plot 4 herë në pjesën e parë, ndërsa në të dytën shënuan edhe 3 herë të tjera dhe vulosën rezultatit final 0-7. Spartaku i Moskës mposhti 5-1 Sevillian, Laipzig triumfoi 3-2 ndaj Portos, ndërsa Fejenordi u befusua në shtëpi nga ukrainasit e Shakhtar Donetsk, me rezultatit 1-2.

Trajneri i Barcelonës vlerëson futbollistin e tij

Valverde: Të gjithë e dimë se Messi është më i miri!

Trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde, beson se Lionel Messi është lojtari më i mirë në botë, pavarësisht se kush e fiton “Topin e Artë”. Messi është një rekord, pesë herë fitues i këtij çmimi prestigjioz individual, por ai pritet të jetë i sfiduar sërish nga ylli i Real Madridit, Kristiano Ronaldo, këtë vit. Dyshja ka ndarë nëntë “Topa të Artë”. Ata konsiderohen gjerësisht si dy lojtarët më të mirë në botë. Valverde, ekipi i të cilit pret Olimpiadon në Ligën e Kampionëve, të



mërkurën, tha se nuk kishte asnjë dyshim se kush ishte më i miri. “Ne të gjithë e dimë se kush është lojtari më i

mirë në botë (Messi), – tha ai në një konferencë shtypi, të martën. – Dhënia e një ‘Topi të Artë’, ose e një çmimi tjetër nuk është diçka, që nuk më intereson. Por, kjo nuk ndryshon mendimin tonë.

Të gjithë e dimë. Messi është më i miri në botë”, deklaroi trajneri i Barcelonës. Ylli argjentinas i Barcelonës ka bërë një fillim mbresëlënës në këtë sezon, duke shënuar 14 gola në 12 ndeshje, në të gjitha garat, për katalanasit.



Zbulohet “tradhtia” e Mbappe ndaj Realit

Kylian Mbappé ishte objektivi i madh i Florentino Perez për të përforcuar skuadrën e tij, Real Madrid gjatë merkatos së verës. Presidenti i “Los Blancos” luftoi deri në momentin e fundit për të blerë talentin e ri francez dhe për ta bërë pjesë të ekipit galaktik. Gjithsesi, pavarësisht përpjekjeve të numrit 1 të klubit madrilen, PSZH fitoi garën dhe përvetësoi shërbimet e Mbappe, që u bë pjesë e treshes fantastike të sulmit, përkrah Neymar dhe Kavanit. Ndërkohë që asnjëherë nuk u bënë të ditura arsyet pse Mbappe refuzoi Real Madrid për PSG, tashmë nga ish-klubi i tij, Monako, publikohen motivet e vendimit. “Unë nuk e shihja të shkante në Paris, por dëgjova të gjitha argumentet e tij dhe u mundova ta kuptoja. Ai ka lindur në Paris, vinte nga Parisi dhe arsyetoi se sipas tij ishte shumë shpejt të largohej nga Franca”, rrëfeu Vadim Vasilyev, zëvendës-presidenti i Monako. “Është një projekt i këndshëm, më duhet ta pranoj, dhe është një klub që synon të fitojë ‘Champions League’ dhe fakti që luan me Neymar e ka bërë atë akoma më tërheqës. Ne patëm tratativa edhe me klube të tjera, por vetëm ato me Real Madrid u bë publik, ndaj ne vendosëm që nëse kushtet e ofruara nga PSG ishin më tunduese, ose të njëjta, atëherë do ta lejonim të transferohej në kryeqytetin francez”, deklaroi zv/presidenti i Monako.

I biri i Veah po shkëlqen në Botërorin e të rinjve



Kur je i biri i fituesit të “Topit të Artë”, atëherë është me gjasë se do të jesh mjaft i rrezikshëm para portës, shkruan “BBC”. Dhe duket se futbollisti legjendar i Milanit, Gjorgji Veah, ka bartur shkathhtësitë e tij edhe tek i biri Timothy. Timothy 17-vjeçar, i lindur në Nju Jork dhe lojtar i PSZH-së, shënoi të hënën tre

gola për SHBA-në në fitoren 5:0 në Botërorin U-17 kundër Paraguait në 1/8 e finales. Goli i tij i dytë në veçanti, një gjuajtje e bukur nga afro 16 metra duke dërguar topin në këndin e epërm, rikujtoi babanë e tij, i cili kishte shënuar një gol spektakolar kundër Veronas me Milanin në vitin 1996.

Kalu: Racizmi si terrorizmi

Sulmuesi i Herta Berlinit, Solomon Kalu, e ka krahasuar racizmin me terrorizëm, ndërsa ka shpjeguar pse gjithë lojtarët e skuadrës së tij janë ulur në një gju të shtunën, shkruan “BBC”. Para ndeshjes së Bundesligës kundër Shalkes, stafi i Hertas ka kopjuar protestën e nisur nga lojtari i futbollit amerikan Kolin

Kaepernik kundër trajtimit të afro-amerikanëve. “Racizmi është si terrorizmi, ose je kundër tij, ose për të”, ka thënë Kalu 32-vjeçar. Ish-sulmuesi i Çellsit, Kalu, ka mohuar se protesta e Hertas, që skuadra gjermane thotë se ishte për “tolerancë dhe përgjegjësi”, ishte vetëm për publicitet.



DASHI (20/III-20/IV)



Aktiviteti mendor nuk premtion shumë, përkundrazi duhet të lodhemi për të rregulluar corintimin, harresat gabimet dhe vlerësimet. Do të ndjeheni të pakënaqur dhe me humor jo të mirë në dashuri. Bëni mirë të jeni të hapur në gjykimet tuaja, sepse nuk jeni objektiv.

DEMI (21/IV-20/V)



Rikuperoni ekuilibrin. Sot në qëndër të cdo gjëje do të jenë çështje financiare për tu rregulluar. Në momentin që ju duhet të bëni shumë gjëra, përfitoni nga hestja e yjeve për të reflektuar. Falë takimeve të reja për ata që kanë zemrën e lirë ka premtime të shkëlqyera.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Hëna hedh hije mbi programet për fund javën. Zhgënjimi për një projekt që ju është prishur ju sjell në humor të keq. Nëse humori është në zbritje edhe toni juaj vital e ndjen këtë. Bëni mirë të buzëqeshni.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Kanalizoni energjitë tuaja drejt një objektivi dhe procedoni me qetësi. Nuk është momenti të rrezikoni në asgjë sot. Mos vazhdoni të shikoni mbrapa, duke idealizuar kujtimet e një raporti që ka kaluar tashmë.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Të realizoni dëshirat tuaja do të jetë e lehtë, sot që Hëna dhe Merkuri bashkohen për të ju mbështetur dhe për të ju dhuruar një ditë vërtetë të paharrueshme. Sot do jeni të corientuar dhe kjo mund të rrezikojë të ju vërë në provë të vështirë. Evitoni sot situatat e vështira.

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Do arrini më në fund të ndjeheni të lirë të bëni zgjedhjet tuaja, pa u mbështetur aspak tek të afërmit ose miqtë tuaj. Nuk është momenti i duhur për të bërë ndryshime, por as edhe për të marrë vendime të rëndësishme për jetën në çift.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Ekulibri dhe dëshira për mirëqenie, mbi të gjitha të brendshme, do të karakterizojnë këtë ditë. Edhe nëse partneri bën ndonjë kaprico më shumë gadishmëria juaj për dialog do ju ndihmojë të zgjidhni çfarë do lloj problemi.

AKREPI (22/X-21/XII)



Humorizmi i një miku do të jetë i nevojshëm për të kaluar disa keqkuptime që mund të keni në familje. Në vend që të sforcoheni për të mbajtur një marrëdhënie që tenton të humbë rrugë, bëni miri ta mbyllni një herë e mirë, përpara se të bëhet më shumë serioze sec duhet.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Me Hënë që ju mbështet, mund të vendosni të ftoni për darkë familjarët dhe miqtë tuaj, ose të dilni të gjithë së bashku. Yjet sot tregojnë anën e tyre më të mirë, duke ju sjellë një ndjenjë të mirë rigjeneruese. Organizmi juaj mund të fitojë shumë nga stili juaj i rregullt dhe i shëndetshëm.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Kuadrati i Merkurit vë në krizë takimet, spostimet dhe kontaktet me internet. Do ju ofrohet rasti për të shtuar kopetencat tuaja profesionale, falë një bashkpunimi me një ekspert. Nëse keni ndër mend të parashikoni pushime me partnerin, sensi praktik i Hënës tek Virgjerasha do të jetë një ndihmë e madhe për ju.

UJORI (20/I-19/II)




Dispononi vendosmërinë e nevojshme për të përballuar dhe zgjidhur keqkuptimet që Hëna në opozitë ju sjell. Nëse partneri juaj duket pak në hije, nuk është sigurisht për fajin tuaj, bëni gjithçka për ta sjellë në humor të mirë duke orgaznizuar një darkë surprizë.

PESHQIT (20/II-19/III)



I keni letrat e duhura për të qënë fitues dhe duhet të luani mirë. Përpara jush po hapen perspektiva interesante dhe ju jeni gati për të shijuar të mirat që qielli favorizues premtion të ju dhurojë. Ekuilibrin që keni arritur jo pa lodhje është kaq i dukshëm sa mund të ndikojë edhe tek ata që janë pranë jush.



NE KETE DATE

19 TETOR 1962

Mensur Mamuti	QYTETI I LO, 1983, KU E FITOI MEDALJEN E ARGJENDITË DASHI TURIBARDHË ME PIKLA	K	E BËRI COPA-COPA, E GRU	PËREMËR PRONOR	KOMEDIAN INDIAN BARIUMI				
GJENERALI ITALIAN, XHUZEPE									ARMË E FTOHTË LUFTARAKE
P									SHUMËS KOMPOZITORI HUNGAREZ, FRANÇ
ISH KAPITENI I KOMBËTARES, LORIK					IMPACT FACTOR SAHATI			LUFTAR PAJO 52 ROMAK	
KËNGËTARI RAHIMOVSKI				TENISTJA RUMUNE, BADESKU IPSILON					
PASUES I NATYRALIZMIT									
QYTETI I LASHTË NE AZINE E VOGEL				PIANISTJA KOSOVJARE, STATOVCI					

ZGJIDHJET: I, VALA, MALUK, NEFS, DATA, ETËR, RITA, H, AJ, K, SOORI, GARIBALDI, PIROMANIA, SH, CANA, IF, LP, AKI, OTILIA, NATYRALIST, ISI, ARDITA.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

			4	9					6		7	2	4			1
	9	6				1	2			3		9				2
8		5				9		7		9						6
			6							2	3					9
4		7		2		6		8		4			7		5	
	5	8			1	3	4						6			
9		1				2		3			9		7			
	6	3				4	8							1	9	
				1	3					1		8			4	5

Shumë i lehtë: 132749856, 796538124, 845162937, 329684715, 417325698, 658971342, 981456273, 563297481, 274813569. Mesatar: 685724931, 731695482, 492183576, 123548769, 946217853, 578936214, 359471628, 864352197, 217869345.



ADN tregon si jetohet më gjatë

Çdo vit kushtuar dijes dhe edukimit, si mendtor ashtu edhe fizik të zgjat jetën. Një grup shkencëtarësh kanë analizuar ADN e qindra-mijëra personave në përpjekje për të kuptuar se çfarë na zgjat jetën dhe çfarë jo. Instituti Usher, pjesë e Universitetit të Edinbur-

gut ka analizuar ADN e më shumë se 600 mijë personave.

Në eksperimentin masiv janë përfshirë konsumues alkooli, cigareje, persona që bëjnë një jetë të shëndetshme dhe të kujdesshme si dhe persona mbipeshë. Studiuesit analizuan genet e

ADN për të kuptuar se çfarë shkaktonte varësinë ndaj një produkti të dëmshëm për shëndetin tonë dhe çfarë jo.

Sipas tyre, si duhanpirja, konsumi i alkoolit apo konsumi i tepruar i ushqimit janë rezultat i një mutacioni të ADN-së. Shkencëtarët e Institutit

Usher kanë bërë edhe një përlllogaritje. Sipas tyre, çdo kilogramë mbipeshë në trup, shkurton 2 muaj jetë dhe një paketë cigare në ditë, shkurton shtatë vite.

Studimi ka nisur prej disa vitesh në grupmosha të ndryshme dhe është ende në vazhdim.

Bill Gates, më i pasuri në SHBA për të 24-in vit radhazi

Bill Gates është njeriu më i pasur i SHBA-ve për të 24-in vit radhazi. Pasuria është shtuar me 8 miliard në krahasim me 2015-ën, duke shtuar kështu 89 miliardë dollarë. Në vend të dytë ndodhet Jeff Bezos, i cili arrin një pasuri deri në 81.5 miliardë dollarë, 14.5 më shumë se vitin e shkuar. Në vend të tretë sërish Warren Buffett, i ngjitur nga 65.5 në 78 miliardë dollarë. Sipas revistës ekonomike "Forbes", ka qenë një tjetër vit rekord për më të pasurit e SHBA-ve. Pasuria e të 400-it në renditje, ka qenë më e lartë me thuajse 18% në krahasim me 2016-ën, duke u



ngjitur nga 1.7 në 2 miliardë dollarë. Pasuria totale e amerikanëve në renditje është shtuar nga 2.400, në 2.700 miliardë dollarë dhe pasuria mesatare është rritur nga 6 në 6.7 miliardë dollarë. Të gjithë personat në dhjetë vendet e para të

renditjes, janë më të pasur se vitin e shkuar, me të paktën 1 miliard. Mes 400 më të pasurve, ka 22 të reja, mes të cilëve bashkëthemeluesi i Netflix, Reed Hastings, e Rocco Commisso, i lindur në Kalabri, themelues i Mediacom, kompani telekomunikimi dhe pronar i New York Cosmos, skuadra e futbollit të Bruklinit. Mes të 400-ëve në renditje, vetëm 51 kanë një pasuri më të ulët në krahasim me vitin e shkuar: "kolpon" më të madhe e ka pësuar presidenti Donald Trump, ku i janë reduktuar 600 milionë nga 3.1 miliardë dollarët që zotëron.

Gjermanët kundër zyrtarizimit të festave myslimane

Së fundi, një sondazh i porositur nga gazeta "Bild" dhe i realizuar nga instituti INSA tregon se 70.1% të gjermanëve janë kundër lejimit të një feste të tillë. Sipas shefit të INSA-s, Hermann Binkert, rezultati tregon se për shumicën e madhe të gjermanëve, islami nuk i takon Gjermanisë, transmeton albinfo.ch. Më tutje, vetëm çdo i trembëdhjeti i pyetur ose 7.8% shprehet në favor të rregullimit me ligj të festave



islamike në Gjermani. Madje edhe në mesin e Partisë së Gjelbër që kon-

siderohet me qëndrim më liberal ndaj të huajve, vetëm çdo i pesti ose

19.6% pranojnë mundësinë e festave të tilla. Në të gjitha partitë tjera, përqindja e atyre që janë në favor është shumë më e ulët, përcjell albinfo.ch. Sigurisht, më e ulëta është në mesin e partisë së ekstremit të djathtë AFD janë 3.7% të tillë, pastaj në FDP, 4.2% etj. Nga ana tjetër është interesante se Komiteti Qendror i Katolikëve të Gjermanisë (ZdK) është shprehur në favor të lejimit zyrtar të festave myslimane në Gjermani.

KALENDARI HISTORIK 19 TETOR

- 1512 - Martin Luteri bëhet doktor i teologjisë (Doktor i Biblës).
- 1739 - Anglia i shpall luftë Spanjës.
- 1812 - Napoleoni fillon tërheqjen nga Moska.
- 1849 - Elizabeth Blackwell bëhet gruaja e parë në SHBA që merr diplomën për mjekësi.
- 1874 - Mary Walsh dhe Charles Colson janë çifti i parë që martohen në balon.
- 1879 - Thomas Edison demonstroi dritën elektrike.
- 1888 - Moshav Gederah sulmohet nga arabët.
- 1912 - Tripoli (Libi) kalon prej duarve të turqve në atë të italianëve.
- 1914 - Posta amerikane për herë të parë përdorë makinë për të mbledhur dhe dorëzuar letra.
- 1915 - Rusia dhe Italia i shpallin luftë Bullgarisë.
- 1921 - Kryeministri portugez António Granjo dhe disa politikanë të tjerë vriten në Lisbonë si rezultat i një krimi të organizuar.
- 1925 - Armata italiane merr Somalinë.
- 1926 - Politburoja ruse largon Leo Trotsky dhe ihtarët.
- 1943 - Konferenca e Ministrave të jashtëm në Moskë.
- 1944 - Trupat amerikane zbarkojnë në Filipine.
- 1951 - Presidenti Harry S Truman formalisht përfundon gjendjen e luftës me Gjermaninë.
- 1960 - Martin Luther King Jr arrestohet në Atlanta.
- 1962 - Mënjanohet monumenti i Stalinit në Pragë.
- 2003 - Nëna Terezë lumturohet nga Papa Xhon Pali II.

A E DINI SE... ?



Vendi që konsumon më shumë vezë për njeri është Meksika, me një mesatare prej 350 vezë në vit për person, e ndjekur nga Japonia me 330 dhe Kina me 320.

Një re e vetme në qiell mund të peshojë më shumë se 450 ton.



Nga 4 forcat bazë (graviteti, forca elektromagnetike, e fortë bërthamore dhe e dobët bërthamore), graviteti është më e dobëta, më e lehta për t'u vënë re, dhe më pak e kuptuara.

BARSOLETA



MAJMUNËT

Hyp djali në dru dhe po hante banane. Vijnë shokët e i thonë:

- Zbrit ore, majmunët kaheerë kanë zbritur nga druri!

- Po e shoh! - ia kthen djali.

THËNIA E DITËS

Është e kotë që të programosh jetën deri në detajin më të vogël, fati është ai që do e thotë gjithmonë fjalën e fundit!

